



STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E FERIZAJT

PËR PERIUDHËN 2024-2034

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	2
Lista e shkurtesave	4
Lista e figurave	5
Lista e tabelave	5
Grupi punues	6
Fjala hyrëse nga Kryetari i Komunës së Ferizajt	7
Përmbledhja Ekzekutive	8-9
1. Hyrja	10-11
2. Metodologjia	12-13
2.1 Parimet bazë të strategjisë zhvillimore të Komunës së Ferizajt 2024–2034	14
2.2 Misioni dhe vizioni	15
3. Konteksti i përgjithshëm	16
4. Analiza SWOT	28
5. Përmbledhja e analizës së problemeve	31-36
5.1 Analiza e gjendjes aktuale dhe perspektiva e zhvillimit	36
5.2 Përzgjedhja e prioriteteve strategjike	37
6. Ndërlidhja me dokumentet strategjike relevante	38-39
7. OBJEKTIVAT	40
7.1 OBJEKTIVI: ZHVILLIMI I ARSIMIT	41
Objektivat Specifik	42
7.1.1 Sigurimi i cilësisë dhe Infrastruktura fizike	43
7.1.2 TIK-u dhe mjetet e konkretizimit	44
7.2 OBJEKTIVI: ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURES	45
Objektivat Specifik	46
7.2.1 Zhvillimi i transportit të qëndrueshëm	47
7.2.2 Menaxhimi i Integruar i Mbeturinave	48
7.3 OBJEKTIVI: ZHVILLIMI I SHENDETESISE DHE MIREQENIES SOCIALE	49
Objektivat Specifik	
7.3.1 Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjitha moshat	50
7.3.2 Punësim gjithëpërfshirës	51
7.3.3 Zvogëlimi i hendekut të shkathtësive në tregun e punës	52-53
7.4 OBJEKTIVI: ZHVILLIMI EKONOMIK, BUJQESOR DHE RURAL	54
Objektivat Specifik	
7.4.1 Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal	58
7.4.2 Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion	59
7.4.3. Zhvillimi i Industrisë	60
7.4.4. Avancimi i proceseve dhe resurseve në planifikimin e zhvillimit të politikave lokale	62
7.4.5. Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal	63
7.4.6. Zhvillimi bujqësor, rural dhe mjedisor	64-66
7.4.7 Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal	67
7.5 ZHVILLIMI I TURIZMIT DHE TRASHEGIMISE KULTURORE	68
Objektivat Specifik	69
7.5.1 Turizmi natyror	70-74
7.5.2 Trashegimia kulturore	75-76
Objektivat prioritarë për zhvillimin dhe implementimin e strategjisë	77
8.0 Plani i Veprimit	78
8. Zbatimi, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi	113-114

Lista e shkurtesave

KOMUNA FERIZAJ

DZHET - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm

USHAF – Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Kolegji AAB

Kolegji Universum

Kolegji UBT

OHTK - Oda e Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës

MAPL - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MINTA - Agjencioni KIESA

APRK - Entit të Punësimit

OEK - Oda Ekonomike e Kosovës

OEGJK - Oda Ekonomike Gjermane

OAK - Oda e Afarizmit të Kosovës

AKB - Agjencia Kosovare e Biznesit

RCF - Rotary Club Ferizaj.

Lista e figurave

Figura 1. Pozita gjeografike e komunës, qytetit dhe qendrës së qytetit	16
Figura 2. Vlerat e temperaturës në qytetin e Ferizajt	18
Figura 3. Erërat në komunën e Ferizajt	19
Figura 4. Rrugët urbane në komunën e Ferizajt	21
Figura 5. Rrugët dhe stacionet në komunën e Ferizajt	27
Figura 6. Rritja e popullsisë gjatë viteve në Ferizaj	23
Figura 7. Krahësimi i përdorimit të mjeteve motorike me ecje dhe motorbicikel	27
Figura 8. Pjesëmarrja e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore në gjithsej sipërfaqen e komunës, Kosovë, 2014	66
Figura 9. Kyçi hidrografik i Kosovës	72
Figura 10. Peisazh nga agroturizmi a	73
Figura 11. Peisazh nga agroturizmi b	74

Lista e tabelave

Tabela 1. Përbërja etnike e popullsisë në komunën e Ferizajt	15
Tabela 2. Temperatura mesatare e muajit gjatë vitit	17
Tabela 3. Indeksi bazik dhe varkor duke krahasuar Ferizajin dhe Prishtinën	22
Tabela 4. Shtimi natyror i popullsisë në Ferizaj	23
Tabela 5. Rritja e numrit të banorëve në qytetin e Ferizajt	23
Tabela 6. Proporcioni (përqindja) e banorëve vetëm të qytetit të Ferizajt ndaj Kosovës	24
Tabela 7. Zonat gjeneruese dhe tërheqëse të trafikut	27
Tabela 8. Numri i fëmijëve në kopshte	42
Tabela 9. Numri i fëmijëve në klasat parafillore	42
Tabela 10. Numri i nxënësve sipas largësisë së udhëtimit në shkollë	42
Tabela 11. Infrastruktura e shkollave	43
Tabela 12. Shpejtësia mesatare e internetit	50
Tabela 13. Kërkimi, Zhvillimi dhe Inovacioni (RDI)	52
Tabela 14. Infrastruktura shëndetësore e Komunës së Ferizajt	53
Tabela 15. Numri i të punësuarve në komunën e Ferizajt	55
Tabela 16. Përqindja e sektorëve me vlerë të lartë të shtuar të punës në Komunën e Ferizajt	56
Tabela 17. NVM-të aktive sipas sektorëve të ekonomisë në Komunën e Ferizajt	60
Tabela 18. Numri i NVM-ve aktive në Komunën e Ferizajt	61
Tabela 19. Struktura e ndërmarrjeve aktive sipas gjinisë së pronarëve në Komunën e Ferizajt	61
Tabela 20. Regjistrimi i bizneseve në komunën e Ferizajt deri më 30.03.2023	62
Tabela 21. Numri i të punësuarëve sipas sektorëve në komunën e Ferizajt	63
Tabela 22. Panairët lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare sipas sektorëve	63
Tabela 23. Treguesit kryesor bujqësor	66
Tabela 24. Përpunimi i produkteve bujqësore	68
Tabela 25. Ofertat turistike në Ferizaj	70
Tabela 26. Zhvillimi i produkteve dhe destinacioneve turistike	70
Tabela 27. Përfitimet më të dukshme të modelet e reja të biznesit	61

Grupi punues

Balton Derguti – Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

Lulzim Shabani – Kolegji AAB

Filip Ruxho – Kolegji Universum

Bujar Jashari – Universiteti i Shkencave të Aplikuara Ferizaj

Afërdita Hoxha – Oda e Hotelerisë dhe Turizmit për regjionin e Ferizajt

Nora Sadiku Dushi – Kolegji UBT

Naim Gashi – Agjensia e Punësimit në Ferizaj

Nexhat Hasani – Përfaqësues i AKB në Ferizaj

Hysen Sogojeva – Oda e Hotelerisë dhe Turizmit

Asmir Azemi – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Denis Rashiti – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Liridon Jetishi – Avokat

Adnan Hashani – Gjeograf

Lulëzim Azemi – Oda Ekonomike e Kosovës

Endrita Shabani – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik

Fjala hyrëse nga Kryetari i Komunës së Ferizajt

Strategjia për Zhvillimin Ekonomik për Komunën e Ferizajt për periudhën 2024-2034, është një nga dokumentet themelore që identifikon atë se çfarë në të vërtetë është Ferizaj, një qytet simbol i zhvillimit ekonomik, potencial i jashtëzakonshëm i turizmit dhe një mundësi më shumë si për qytetarët anëmbanë vendit, ashtu edhe për vendasit, bashkëqytetarët tanë ferizajas dhe natyrisht, vizitorët dhe bizneset e shumta vendore e të huaja.

Duke qenë kështu, një dokument i tillë, vë pikat e orientimit dhe planifikimit afatgjatë, serioz e të mirëllogaritur për të ardhmen në këto fusha. Shto kësaj faktin, se në një përmasë të tillë, me thellime profesionale të tilla, ky dokument paraqitet për herë të parë. Ferizaj, ka potencial të jashtëzakonshëm të zhvillimit ekonomik, reflektuar kjo në dy pikëpamje. E para që lidhet me zhvillimin industrial, pasuritë natyrore dhe monumentet në mbrojtje në të cilat institucionet lokale kanë ndërmarr veprimet e mundshme për t'i ruajtur e promovuar, kësaj i shtojmë edhe peisazhin e jashtëzakonshëm, vargmalet që qarkojnë një pjesë të konsiderueshme të territorit të Ferizajt, me pikë reference fshatin Jezerc, Neredime, Pleshinë, Burrnik etj. Ferizaj sot është shndërruar në një qendër të rëndësishme të ekonomisë dhe biznesit në Kosovë. Së dyti, pozita e favorshme gjeografike, dinamikat e zhvillimit ekonomik, frekuentimi masiv nga qendra të tjera të afërta brenda dhe jashtë vendit, historia e zhvillimit të qytetit, diversiteti kulturor e etnik, mosha e re e popullatës dhe dallueshmëria mes komunave tjera në fushën e ndërmarrësisë, janë disa nga pikënisjet që reflektojnë potencialin turistik të Komunës së Ferizajt, e që suksesshëm i vihen kornizat në këtë Strategji për Zhvillimin Ekonomik për Komunën e Ferizajt në vitet 2024-2034. Kjo punë, shkruar në këta rreshta, këto planifikime e orientime profesionale, nuk do të ishin të tilla, pa mbështetjen e ekipeve profesionale, ekspertëve të fushës, prirë nga Universiteti i Shkencave të Aplikuar në Ferizaj, Kolegji AAB, Kolegji UBT, Kolegji Universum, Agjensioni KIESA, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Gjermane, Agjencia e Bizneseve të Kosovës, Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës, Rotary Club, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Enti i Punësimit, Oda e Afarizmit të Kosovës, njohës e vullnetmirë të shumtë, të cilëve i shprehim falënderim të veçantë, që me kontributin e tyre profesional, ideor, sollën këtë dokument përmbajtësor e pikë reference për të gjitha planifikimet e ardhshme në fushën e zhvillimit ekonomik në Komunën e Ferizajt.

Me respekt,

Agim Aliu
Kryetar i Komunës së Ferizajt



Përmbledhja Ekzekutive

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik paraqet një dokument strategjik të bazuar në planin e veprimit, që ka për synim hartimin dhe koordinimin e politikave për zhvillim Ekonomik për periudhën kohore 2024-2034.

Ky dokument përcakton mënyrën se si të bëhet realitet vizioni për komunën e Ferizajt me qeverisje efikase, arsim cilësor, mjedis të pastër, shëndet dhe mirëqenie sociale, mjedis të përshtatshëm biznesi dhe bujqësi të zhvilluar në mënyrë që të rritet cilësia e jetës. Strategjia mbështet ngritjen e kapaciteteve qeverisëse, duke përmirësuar zbatimin e ligjit, duke krijuar klimë partneriteti me bizneset, mundësi për aktivitete rinore dhe hapësirë për grupet e marginalizuara, shoqërinë civile dhe qytetarët, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e qeverisjes vendore. Komuna vendos synime dhe objektiva, në të cilat mbështeten në përmbushjen e kërkesave të qytetarëve për një mirëqenie më të mirë dhe natyrisht në përputhje me buxhetin e përcaktuar. Këto synime shprehen përmes objektivave strategjike, si më poshtë:

- **Objektivi Strategjik Nr.1: Arsimi**
- **Objektivi Strategjik Nr.2: Infrastruktura**
- **Objektivi Strategjik Nr.3 Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale**
- **Objektivi strategjik Nr.4: Zhvillimi Ekonomik, Bujqësor dhe Rural**
- **Objektivi strategjik Nr.5: Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore**

Hartimi i strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal është një dokument i ri strategjik për komunën e Ferizajt. Në përgjithësi, komuna ka një strategji për zhvillimin ekonomik lokal. Edhe pse qeverisja vendore është ndërtuar mbi parimin e Kartës Evropiane për Qeverisje Lokale, qëndrueshmëria financiare e komunës ende nuk është arritur. Ende vazhdon të jenë të varur nga niveli qendror ku në shumicën e rasteve deri në 80% e buxhetit vjen nga grantet qeveritare. Vetë qëndrueshmëria financiare është një nga kriteret kyçe për t'u siguruar që niveli lokal që përkatësisht komuna e Ferizajt të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm, për të siguruar mirëqenie për qytetarët e saj.

Strategjia mbështet ngritjen e kapaciteteve qeverisëse duke përmirësuar zbatimin e ligjeve, krijimin e klimës së partneritetit me biznesin, krijimi i mundësive për aktivitete të fushave që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik dhe hapësira për grupet e marginalizuara, shoqërinë civile dhe qytetarët, që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve për zhvillim ekonomik sa më të qëndrueshëm. Komuna shtron para vetes qëllimet dhe objektivat në të cilat mbështeten në realizimin e kërkesave të qytetarëve, vizitorëve dhe bizneseve për një mirëqenie më të mirë dhe padyshim në përputhje me buxhetin e përcaktuar.

Grupi punues ka përgatitur një raport fillimor dhe një plan të punës për Komunën e cila ka integruar përpjekjet e mëparshme për zhvillimin ekonomik. Komuna deri më tani ka organizuar një ekip Profesional të fushave të ndryshme të komunitetit të përbërë nga të gjithë personat kyç të qeverisë lokale, të sektorit publik dhe atij privat dhe veçanërisht të komunitetit të bizneseve pasi që objektivi e komunës është që planifikimi dhe implementimi i zhvillimit ekonomik të bëhet nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit e cila kohëve të fundit ka ndërmarre hapa konkret për zhvillimin ekonomik dhe turizmin, në bashkëpunim me komunitetin e turizmit dhe shoqërinë civile të organizuar në komunë .

Ekipi ka definuar vizionin e komunës, dhe ka identifikuar strategjitë për zhvillim ekonomik dhe të turizmit. Ky proces do të na shpie tek finalizimi i Strategjisë së Zhvillimit të Ekonomik dhe do të lejojë komunën për të përcaktuar detyrat dhe aktivitetet për të kompletuar një plan të implementimit

1. HYRJA

Sfida e krijimit të Strategjisë për zhvillimin ekonomik është e madhe sepse qyteti i Ferizajt ka potenciale të mëdha të cilat ende nuk janë njohur dhe përdorur mjaftueshëm.

Ku dokument gjithëpërfshirës do të parashikojë drejtimet, prioritetet dhe dinamikën e ardhshme të zhvillimit të përgjithshëm ekonomik dhe social. Dokumenti është realist, i zbatueshëm dhe bazohet në parime të përgjithshme shkencore të cilat duhet të shërbejë si bazë për miratimin e programit të zhvillimit ekonomik dhe zhvillimin e të gjitha segmenteve të tjera të qytetit, përfshirë, arsimin, shëndetësinë, infrastrukturën publike etj. Efektet më të rëndësishme ekonomike dhe sociale të cilat do të arrihen nëpërmjet zbatimit të suksesshëm të strategjisë, pritet të jenë: rritja e punësimit, përmirësimi i standardit të jetesës së qytetarëve, zhvillimi më dinamik i qytetit, njohja e avantazheve konkurruese të Ferizajt, rritja e eksporteve dhe rritja e burimeve financiare të disponueshme.

Njohja e aspiratave dhe mundësive zhvillimore të përfshira në dokumentin strategjik nënkuptojnë ekzistencën e një vizioni të qartë për të ardhmen dhe rrjedhimisht një mision që nënkupton domosdoshmërinë dhe detyrimin e të gjithë faktorëve, drejt realizimit të saj.

Procesi i krijimit dhe miratimit të Strategjisë së zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit të Ferizajt nga viti 2024 deri në vitin 2034 do të rezultoi në krijimin e vlerave domethënëse, si:

- **Thellimin e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik, privat dhe shoqërisë civile,**
- **Të intensifikoj pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e miratimit dhe zbatimit të një dokumenti strategjik**
- **Dokumenti strategjik të bëhet pronë e gjithë komunitetit lokal.**

Në përgatitjen e strategjisë janë angazhuar ekspertë, biznesmenë, punonjës publikë. Deri në finalizimin e këtij dokumenti presim mbështetjen e të gjithë qytetarëve të Ferizajt, ndaj pritet që të gjithë ata që do të përfshihen në formulimin e saj, përveç njohurive dhe ekspertizës, do të shpërfaqin dhe investojnë iniciativë dhe entuziazëm për kauzën e tyre të përbashkët të së ardhmes së qytetit.

Qëllimi themelor i strategjisë është zhvillimi i qëndrueshëm, i cili i plotëson nevojat e së tashmes, por nuk vë në dyshim aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre për të ardhmen. Prioritetet kryesore të këtij dokumenti janë zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik bazuar në njohuri dhe inovacion, i cili do të sigurojë konkurrencë dhe rezultate më të mira për ekonominë e Ferizajt, tërheqjen e kapitalit të huaj në ekonominë dhe sipërmarrjen lokale, ngritjen e standardit të jetesës së popullsisë, si dhe krijimi i infrastrukturës së përshtatshme dhe kushteve të tjera që nxisin zhvillimin ekonomik krahas mbrojtjes së mjedisit dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët.

Gjithçka që është simbol i këtij qyteti, çdo gjë që është e bukur dhe vlerë e këtij qyteti, do të shpërfaqet përmes këtij dokumenti.

Ky dokument strategjik është një udhërrëfyes në zhvillimin e qytetit dhe kontribuon në thellimin e përgjithshëm të mirëkuptimit dhe dialogut ndërmjet anëtarëve të gjitha palëve të interesuara.

Pranimi i vizionit, misionit dhe qëllimeve strategjike do të çojë në mënyrë të pashmangshme në ndryshime në strukturën organizative të qeverisjes vendore, në sistemin e komunikimit dhe mënyrën e sjelljes, trajnimit dhe personelit dhe aplikimin e aftësive të reja, me qëllim krijimin e një kulture të përbashkët vlerash të të gjithë pjesëmarrësit për realizimin e këtyre qëllimeve strategjike.

- **Zhvillim i shpejtë ekonomik dhe infrastrukturë cilësore,**
- **Zhvillimi i burimeve njerëzore dhe përmirësimi i cilësisë së jetës,**
- **Nxitja e zhvillimit të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të komunës së Ferizajt me potencialet kryesore në industri, bujqësi dhe turizëm**
- **Mjedis ekologjikisht i avancuar dhe i ndërtuar në përputhje me standardet evropiane**

Strategjia hartohet në përputhje me dokumentet strategjike komunale dhe shtetërore si Planin Strategjik Afat Mesëm Komunal dhe Afat gjatë të Qeverisë, Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal, PZHK (2017-2025+) si dhe Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030.

Komuna e Ferizajt deri më tani ka miratuar disa Strategji për Zhvillim Ekonomik Lokal, të cilat kanë skaduar. Megjithatë çështjet e konsideruara si të rëndësishme nga strategjitë e mëparshme janë bartë tek ky dokument i ri strategjik.

Pjesa në vijim e këtij dokumenti është e strukturuar si në vijim. Seksioni II paraqet shpjegimet metodologjike për hartimin e Strategjisë 2024-2034. Seksioni III tregon kontekstin e përgjithshëm ekonomik të komunës së Ferizajt. Seksioni IV shfaq analizën SWOT, duke treguar përparësitë, mangësitë në njërin anë dhe në anën tjetër mundësitë dhe rreziqet. Seksioni V bën një përmbledhje të analizës së problemeve. Seksioni VI përmbledh ndërlidhjen me dokumentet strategjike relevante. Seksioni VII paraqet vizionin së bashku me objektivat dhe masat orientuese. Në të njëjtin seksion paraqitet edhe tabela e treguesve. Seksioni VIII shpjegon zbatimin, si dhe kornizën monitoruese dhe raportuese. Në fund, Seksioni IX paraqet paraqet projeksionet financiare për zbatim të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2024-2034 të komunës së Ferizajt.

METODOLOGJIA

Strategjia për Zhvillim të Qëndrueshëm Lokal të Qytetit të Ferizajt (në tekstin e mëtejshëm Strategjia) është një plan i përgjithshëm zhvillimor strategjik që duhet të ofrojë udhëzime për zhvillimin e ardhshëm të komunitetit lokal, por edhe të jetë një instrument i dobishëm për zhvillimin ekonomik të qytetit. Afati kohor për zbatimin e Strategjisë është 2024 - 2034, pra 10 vjet.

Strategjia i referohet zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit të Ferizajt, që nënkupton zhvillimin ekonomik racional përmes përdorimit të burimeve natyrore në masën që i lejon ato të rinovohen natyrshëm, por edhe duke arritur standardet regjionale, së pari, e pastaj europiane në fushat e arsimit, kulturës, mbrojtjes sociale, shëndetësisë, sportit dhe të gjitha fushat e tjera të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë së jetesës së komunitetit lokal.

Gjatë përcaktimit të kornizës metodologjike për hartimin e këtij programi janë marrë parasysh: “Udhëzimi Administrativ për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit”, “Manuali për planifikimin, hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit” dhe “Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030”.

Strategjia është hartuar në përputhje me planet dhe dokumentet strategjike kombëtare të zhvillimit, si: Strategjia e zhvillimit ekonomik, strategjia e zhvillimit të bujqësisë së Kosovës, Strategjia e Reformës së Administratës Shtetërore, Strategjia e Zhvillimit Rajonal - Lindje, por më së shumti mbështetet në Strategjinë Kombëtare të Qëndrueshme të zhvillimit me qëllim të përmirësimit të zbatimit të atij plani, por edhe arritjes së qëllimeve të caktuara specifike që lidhen konkretisht me qytetin e Ferizajt. Gjithashtu, Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm të qytetit të Ferizajt bazohet në planin kornizë të “Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit” të OKB-së, si dhe dokumenteve të tjera të rëndësishme ndërkombëtare si: Karta e qyteteve dhe bashkive evropiane për qëndrueshmërinë, miratuar nga pjesëmarrësit e Konferencës Evropiane për Qytetet dhe Komunitatet e Qëndrueshme; Karta e Planetit Tokë etj.

Strategjia është përcaktuar, miratuar dhe zbatuar në nivel qyteti dhe vlen për territorin e qytetit të Ferizajt. Megjithatë, në shumë synime dhe aktivitete, Strategjia nënkupton një qasje të përbashkët të qytetit dhe qyteteve të tjera (sidomos ato fqinje) në zgjidhjen e problemeve dhe sfidave të përbashkëta, kështu që qëllimet dhe aktivitetet e deklaruara nënkuptojnë veprime të koordinuara.

Dokumenti strategjik përmban pjesët e mëposhtme:

- 1. Konteksti – Profili i qytetit të Ferizajt,**
- 2. Sfidat dhe mundësitë - Analiza “SWOT”,**
- 3. Vizionin, prioritetet dhe synimet,**
- 4. Plani lokal i veprimit për periudhën 2024-2034, dhe**
- 5. Sistemi i menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë.**

Përcaktimi i strategjisë së zhvillimit ekonomik të qytetit filloi me një analizë të situatës aktuale dhe të potencialit zhvillimor, i cili përfshinte:

- **Analizë krahasuese e ekonomisë së qytetit me qytete të krahasueshme të regjionit,**
- **Analiza e strategjisë së zhvillimit të BE-së,**
- **Analiza e politikave të kohezionit të BE-së,**
- **Analiza e ekonomisë së qytetit,**
- **Rishikimi i iniciativave zhvillimore ekzistuese - projektet zhvillimore të iniciuara,**
- **Analiza dhe dokumentimi i potencialeve ekonomike të qytetit,**
- **Analiza financiare – analiza e potencialeve buxhetore,**
- **Analiza e infrastrukturës etj.**

Në fazën e dytë, para së gjithash ishte e nevojshme të përcaktohej misioni dhe vizioni kryesor i zhvillimit të qytetit, si komponent bazë e zhvillimit. Vetë programimi i strategjisë së zhvillimit ekonomik përfshinte:

- **Përcaktimin e konceptit bazik strategjik,**
- **Përcaktimin e opsioneve të zhvillimit,**
- **Përcaktimin e synimeve kryesore të zhvillimit dhe treguesve ekonomikë,**

- **Përcaktimi i strategjisë së zhvillimit ekonomik,**
- **Përcaktimin e projekteve kryesore strategjike si shtytëse për zhvillimin ekonomik të qytetit**

Faza e tretë e programimit të strategjisë së zhvillimit të qytetit përfshinte:

- **Katalogimin e projekteve zhvillimore me studime të mëparshme fizibiliteti**
- **Krijimin e Planit të Zbatimit (udhërrëfyesi i zbatimit)**

Gjithashtu, si anekse të këtij dokumenti janë bashkëngjitur pjesë në të cilat janë renditur pjesëmarrësit në krijimin e strategjisë (ekipi strategjik, grupet e punës dhe forumi i partnerëve) si dhe treguesit e qëndrueshmërisë. Përvoja në planifikimin me pjesëmarrje në komuna dhe qytete sapo ka filluar dhe mënyrat e institucionalizimit të pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes të parashikuara në këtë strategji paraqesin një kontribut të ri në zhvillimin e demokracisë lokale. Gjithashtu në strategji theksohet dukshëm edhe sistemi i menaxhimit, i cili është i domosdoshëm për sukses, pastaj zbatimi i dokumenteve strategjike dhe monitorimi i zbatimit, sepse planifikimi dhe menaxhimi strategjik është një proces aktiv, një rrugëtim dhe jo një destinacion përfundimtar.

Strategjia e Zhvillimit të Qëndrueshëm përfshin të gjitha udhëzimet, synimet dhe masat relevante për të gjithë sektorët, duke krijuar kushte për zbatimin ose zhvillimin e planeve të tjera në nivel lokal. Të gjitha planet e tjera sektoriale në nivel vendor synojnë që brenda zonave të tyre të përmbushin dhe zhvillojnë mundësitë e përcaktuara më gjerësisht në Strategji, duke respektuar udhëzimet e përcaktuara nga vizioni, synimet dhe prioritetet, duke ofruar mbështetje operacionale për projektet dhe aktivitetet e parashikuara në planin e veprimit.

Gjatë procesit të krijimit të këtij dokumenti, u krijua bashkëpunim i suksesshëm, si dhe një partneritet i zhvilluar për procese të tjera që ndodhen përpara nesh në të ardhmen. Fillimi i procesit të planifikimit strategjik filloi me formimin e Trupit Koordinues, i cili kishte rol të rëndësishëm në krijimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm të qytetit të Ferizajt, sepse gjatë gjithë procesit përpunonte materialin e mbledhur të krijuar nga pjesëmarrësit. Në procesin e hartimit të strategjisë u përfshinë subjekte të ndryshme, me role dhe funksione të ndryshme kur janë mbledhur së bashku palët e interesuara që jetojnë dhe punojnë në territorin e qytetit. Gjithashtu dokumenti pati mbështetjen profesionale të grupeve tematike të punës dhe ekipit koordinues, si dhe institucioneve të tjera. Në forumin e parë u propozuan prioritetet dhe anëtarët e grupeve të punës. Janë formuar tri grupe punuese: Grupi Punues për Zhvillim Ekonomik, Grupi Punues për Zhvillim Social dhe Grupi Punues për Mbrojtjen e Mjedisit.

Ekipet e punës analizuan situatën (SWOT), dhe më pas përcaktuan vizionin, qëllimet strategjike dhe specifike. Bazuar në qëllimet e përcaktuara, është bërë një plan veprimi që ka për synim përmbushjen e synimeve të përcaktuara. Anëtarët e grupeve të punës kanë pasur një sërë

2.1 Parimet bazë të strategjisë zhvillimore të Komunës së Ferizajt 2024–2034

Strategjia e zhvillimit të komunës së Ferizajt do të bazohet në disa nga parimet e mëposhtme:

- Përmirësimi i mjedisit investues. Tërheqja e një vëllimi më të madh të investimeve të huaja direkte kërkon një ekonomi të hapur dhe një mjedis tregu të shëndetshëm, i cili do të favorizojë investimet e huaja dhe startup-et, kursimet e brendshme dhe krijimin e një mase kritike të NMV-ve që do të absorbojnë fuqi të re punëtore.
- Nxitja e zhvillimit më të shpejtë të sipërmarrjes nëpërmjet promovimit dhe mbështetjes së krijimit të sipërmarrjeve të reja, zhvillimi i burimeve njerëzore, për një sektor konkurrues me forma të ndryshme financimi të NVM-ve, zhvillimin e avantazheve konkurruese të NVM-ve, sidomos në tregjet e eksportit dhe zhvillimin e një mjedisi stimulues për NVM-të, me fokus në punësim më të madh të rinjëve.
- Rritja dhe ristrukturimi i eksporteve. Rritja e eksporteve kërkon ndryshime të rëndësishme strukturore, të cilat tashmë bazohen në produkte primare dhe produkte të fazave më të ulëta të përpunimit.

- Reforma e sistemit arsimor në përputhje me nevojat e ekonomisë. Krijimi i sistemit arsimor që i plotëson nevojat e ekonomisë nuk është i mundur nëse nuk krijohen lidhje të forta në mes punëdhënësëve, institucioneve përgjegjëse për arsim, institucioneve shkencore dhe tregut të punës.
- Bashkëpunim aktiv dhe dinamik ndërmjet shkencës dhe industrisë. Metoda më efikase për rritjen e produktivitetit të industrisë dhe ndryshimeve strukturore është domosdoshmëri. Komuna do të realizoj aktivitetet që do të çojnë në krijimin dhe sigurimin e bashkëpunimit aktiv dhe dinamik ndërmjet organizatave kërkimore dhe universiteteve, nga njëra anë, dhe industrisë, nga ana tjetër, të cilat gradualisht do të çojnë në krijimin e kushteve të favorshme për iniciimin dhe zbatimin e projekteve të rëndësishme ekonomike bazuar në rezultatet e hulumtimit.
- Investime të reja në produkte të reja. Përparësi do t'u jepet aktiviteteve të tilla që ato parashikojnë prodhimin e produkteve të reja, futjen e teknologjive dhe proceseve të reja, që çojnë në përmirësime të rëndësishme të produkteve, proceseve ose shërbimeve ekzistuese.
- Mbrojtja e mjedisit nëpërmjet inkurajimit të prodhimit më të pastër dhe reduktimit të ndotjes dhe presioneve ndaj mjedisit.

2.2 Misioni dhe vizioni

Pas arritjes së objektivave zhvillimore të përcaktuara nga kjo strategji, qyteti do të ketë një ekonomi dinamike, një qendër urbane të zhvilluar dhe zona rurale të zhvilluara.

Qyteti do të ketë një infrastrukturë të zhvilluar dhe do t'u ofroj qytetarëve të tij shërbime publike moderne (e_City, Smart City).

Qyteti do të bëhet tërheqës për komunitetin e biznesit dhe krijuesit, turistët dhe njerëzit që duan të jetojnë dhe punojnë përgjithmonë në zonën e tij.

Arritja e misionit dhe vizionit afatgjatë është planifikuar përmes realizimit të katër komponenteve kryesore të strategjisë së zhvillimit ekonomik:

- Një qytet produktiv - rritja e ekonomisë lokale, e cila do t'u sigurojë banorëve të qytetit një nivel të lartë të standardeve të jetesës.
- Një qytet gjithëpërfshirës - duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë banorët e aftë për punë dhe duke siguruar kujdes adekuat për të moshuarit dhe të personat me nevoja të veçanta.
- Qytet me qeverisje të mirë - zhvillimi i sistemeve moderne të administrimit të qytetit bazuar në parimet e koncepteve të "qytetit të zgjuar" (Smart City) dhe "qytetit të internetit" e_City).
- Një qytet me një ekonomi të qëndrueshme - duke siguruar një ekuilibër midis zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së mjedisit në mënyrë që ta bëjë qytetin një vend të dëshirueshëm për të jetuar

Misioni

Ferizaj do të jetë një vend që ju mundëson të gjithë qytetarëve një jetë premtuese, të begatë dhe të sigurt, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, arsim cilësor dhe me aktivitete të dinjitetshme sociale dhe kulturore. Ferizaj do të jetë një mjedis atraktiv me kushte të mira për zhvillim ekonomik dhe me programe cilësore në arsim, me administratë të digjitalizuar, mbrojtje sociale dhe një vend ekologjikisht i qëndrueshëm. Ferizaj do të ju mundësojë të rinjëve edukim digjital cilësor, specializim të zgjuar dhe investime të qëndrueshme.

Vizioni

Deri në vitin 2034, Ferizaj do të jetë një qytet evropian, ku të gjithë qytetarët do të kenë mundësinë të përparojnë dhe të jenë pjesë e një sistemi digjital, të qëndrueshëm dhe të barabartë, të mundësuar nga arsimi digjital cilësor, specializimi i zgjuar dhe investimet e qëndrueshme. Ferizaj do të jetë destinacion tërheqës dhe ura për vendtakim të njerëzve, ideve, kulturave dhe traditave rajonale

– një qytet evropian me zhvillim ekonomik, tregtar rekreativ e turistik me infrastrukturë të zhvilluar, me shëndetësi dhe politika sociale në rritje që do të sigurojë mirëqenie për të gjithë qytetarët.

3. Konteksti i përgjithshëm

Kosova është në një fazë të rëndësishme të zhvillimit, ku politikat ekonomike duhet të jenë pjesë integrale e programit në të gjitha fushat. Nga përvoja e deritanishme, zhvillimi ekonomik në nivel vendi, veçanërisht në nivel lokal, është përballur me shumë probleme dhe sfida, të cilat duhet të adresohen përmes planeve të veprimit. Në këtë kontekst, qeverisja lokale është përgjegjëse për adresimin e politikave me ndikim në zhvillimin ekonomik për përmirësimin e standardit të jetesës dhe rritjen e mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve. Në përputhje me udhëzimet strategjike kombëtare për zhvillim dhe qëllimet e agjendës evropiane, koncepti i vetëqeverisjes lokale po orientohet drejt një sistemi të decentralizimit funksional, ku me forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare të komunave synohet të krijohen kushte më të favorshme për zhvillimin social-ekonomik lokal.

3.1 Demografia e Komunës së Ferizajt

Sipas regjistrimit të vitit 2011, komuna e Ferizajt ka 108.610 banorë, 51 për qind prej të cilëve jetojnë në 45 fshatra, ndërsa 49 për qind jetojnë në qytet. Nga ky numër, 96 për qind janë shqiptarë, kurse 4 për qind janë ashkanlinjë, romë, boshnjakë, serbë etj. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, gjatë vitit 2013 në komunën e Ferizajt kanë lindur 1.952 fëmijë, kanë vdekur 436 banorë, janë martuar 910 çifte, ndërsa janë shkurorëzuar 83 bashkëshortë.

Tabela 1. Përbërja etnike e popullsisë në komunën e Ferizajt

Përbërja etnike									
Viti/Etnia	Shqiptar	%	Serbë	%	Ashkali / Romë	%	Goran / Boshnjak	%	Totali
1991	81,737	85.9	8,191	8.6	2,081	2.2			95,156
1999	120,267	95.1	26	0.0	4,700	4.8			125,067
2005	200,000	97.4	147	0.1	3,594	2.3	248	0.2	205,242
2011	104,000	100.0	0	0.0	3,200	4.1			108,690
2021	106 686	100	0	0.0	-	-	-	-	106 689

Burimi: Agjencioni i Statistikave të Kosovës

3.2 Historiku

Ferizaj u formua në rrugën e vjetër që lidhë Bosnjën me Maqedoninë për mes hekurudhës e cila u ndërtua në vitin 1873 ku ky vit merret edhe fillimi i krijimit të qytetit. Si fillim vendbanimi ishte zejtar-tregtar, ku në vitin 1924 e fiton planin e parë rregullativ me ç'rast edhe fiton statusin e vendit urban ku shpallet qytet me emrin e ri Ureshevac (Ibrahim Hyseni Ferizaj 1873-1944 rib.2013). Gjatë këtyre viteve Ferizaj ndërton disa objekte sociale dhe rrugë kryesore.

3.3 Pozita gjeografike e Ferizajt

Ferizaj shtrihet në pjesën jugore të rrafshit të Kosovës dhe në pjesën veri-lindore të maleve të Sharrit saktësisht në koordinatat gjeografike 42,36825° Veri, 21,15336° Lindje. Komuna e Ferizajt ka një hapësirë prej 345 km² me 108.690 banor (regjistri i popullsisë 2011) ku gjysma e këtyre banorëve jetojnë në 45 fshatrat e saj. Nga komunitetet tjera jetojnë rreth 3700 banorë, kryesisht Ashkalinjë, Romë, Goranë, në të cilat përbëjnë rreth 3,05 % të popullatës. Komuna e Ferizajt në lindje kufizohet me komunën e Gjilanit dhe të Vitisë, nga të cilat qendra ka distancën rrugore prej 32, përkatësisht 21 km. Në jug kufizohet me komunën e Kaçanikut (16 km), në jugperëndim me Shtërpçën (32 km), në perëndim me Prizrenin (60 km) e Therandën (42 km) dhe në veri me Shtimen (13km) e Lipjanin(17km). Distanca e Ferizajt nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina është 36 km, kurse nga Shkupi 48 km.

Qyteti i Ferizajt ka pozitë qendrore karshi territorit të komunës, ku lartësia mbidetare e qytetit është rreth 580 metra mbi nivelin e detit. Ferizaj është qyteti me i ri në Kosovë i cili ka një pozitë shumë të mirë gjeografike pasi që shtrihet në pjesën ku janë prerë rrugët e vjetra Prizren-Anamoravë dhe rruga tjetër Prishtinë – Shkup, por më së shumti hov dhe zhvillim qytetit i dha shtrirja e hekurudhës Mitrovicë-Ferizaj-Maqedoni e për mes shteteve fqinje edhe me shtete tjera. Këto rrugë të vjetra sot janë arteriet kryesore në Kosovë. Rruga Magjistrale N2/E65 në drejtim të Shkupit, si dhe rruga magjistrale N25-3 e cila lidhë Ferizajn me Gjilanin dhe Bujanocin ku për mes kësaj rruge lidhet me korridorin Evropian. Si dhe rruga magjistrale N25/E752 që lidhë Ferizajn me Prizrenin e bën Ferizajn me një pozitë shumë të favorshme.

Për shkak pozitës së tillë dhe zhvillimit të shpejtë industrial-ekonomik qyteti u rrit dhe u zgjerua shpejt. Migruesit kryesor nuk ishin vetëm prej komunës së Ferizajt por edhe prej komunave tjera, ku këto migrime vazhdojnë edhe sot. Gjithashtu Ferizaj vizitohet shumë edhe nga qytetarët e komunave tjera të Kosovës e gjithashtu edhe nga qytetet e Maqedonisë së Veriut pasi që është qendër rajonale dhe ofron një ofertë shumë të mirë prodhuese tregtare, rekreative e argëtuese.




Figura 1. Pozita gjeografike e komunës, qytetit dhe qendrës së qytetit

3.4 Relievi i komunës së Ferizajt

Qyteti i Ferizajt shtrihet në jug të rrafshit të Kosovës, respektivisht aty ku thyhet pllaka e rrafshit të Kosovës, e ku ndan ujin në dy ujëndarës. Në këtë pikë Lumi Nerodime ndahet në dy degë: Lumi Nerodime gjarpëron ka ujëmbledhësi i detit Egje dhe ka veriu, lumi Sazlika ujëmbledhësi i detit të Zi. Qyteti ka lartësi mbi detare rreth 580 metra mbi nivelin e detit dhe ka një reliev të rrafshët, e po ashtu edhe shumica nga fshatrat e Ferizajt kanë reliev të rrafshët.

Relievi në qytet është shumë i rëndësishëm në zhvillimin e jetës për shkak se nga relievi janë të varura shumë punë infrastrukturore. Veçanërisht është e lidhur me format e transportit, andaj relievi i rrafshët në qytet mundëson një planifikim dhe zhvillim shumë të mirë të infrastrukturës për transport dhe morbiditetit fleksibil të njerëzve, me të gjitha mjetet e transportit, e sidomos tek ata njerëz që përdorin biçikletën dhe ecjen në këmbë, e kjo është edhe njëra ndër përparësitë kryesore që e ka qyteti.

Relievi i rrafshët mundëson mirëmbajtjen më të lehtë gjatë stinëve të dimrit, shpenzime dhe ndotje më të vogël të ajrit nga automjetet, zhvillim të transportit hekurudhor.

3.5 Klima në komunën dhe qytetin e Ferizajt

Ferizaj karakterizohet me klimë kontinentale, si edhe pjesa më e madhe e Fushës së Kosovës. Temperatura vjetore mesatare është 9.9°C. Muajt më të ngrohtë janë korriku dhe gushti, me temperaturë mesatare 18.9°C. Muaji më i ftohtë është janari, me temperaturë mesatare -2.6°C. Temperatura maksimale e ajrit është 32.5°C në korrik, ndërsa ajo minimale -14.0°C. (plani zhvillimor komunal i Ferizajt 2008) por ka pasur ditë në janar ku temperaturat kanë shkuar deri -26°C

Tabela 2. Temperatura mesatare e muajit gjatë vitit

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	mes
-2.6	0.3	4.3	10.1	14.5	18.5	20.6	20.5	16.4	10.6	6.0	1.5	10.2


Burimi: Stacioni hidrometeorologjik i Ferizajt

Muaji me më së shumti orë me diell është gushti, me 264.6 orë, ndërsa dhjetori karakterizohet me kohën më të shkurtër të rrezatimit, mesatarisht me 63.8 orë.

Lagështia më e lartë mesatare sillet prej 85.0 % deri 87.0 %, në muajt dhjetor dhe janar, ndërsa ajo më e ulët në muajt korrik dhe gusht, e cila sillet prej 68.2 % deri 68.4 %. Kohë me vranësi më të lartë ka janari, me 7.3/10 ndërsa vranësi më të ulët ka gushti me 3.8/10.

Mesatarisht, në vit ka 673.3 mm të reshura në Ferizaj. Muajt me më së shumti të reshura janë prill – maji, me 105.6 mm, ndërsa me më së paku gushti, me 42.2 mm. Mesatarisht, toka e Ferizajt është 51.8 ditë e mbuluar me borë. Në janar ka më së shumti borë (17.0 ditë), ndërsa më së paku borë ka prilli (1.0 ditë). (Plani zhvillimor komunal i Ferizajt 2008)


Ferizaj




Figurë 2.2: Vlera mesatare e temperaturës së ajrit në stacionin e Ferizajt, 2020 ndaj periudhës 2010-2019



Figurë 2.3: Vlera mesatare mujore e Tmax në stacionin e Ferizajt, 2020 ndaj periudhës 2010-2019




Figurë 2.4: Vlera mesatare mujore e Tmin në stacionin e Ferizajt, 2020 ndaj periudhës 2010-2019



Figurë 2.11: Sasia totale mujore e reshjeve (mm) në stacionin e Ferizajt, 2020 ndaj periudhës 2010-2019

Figura 2. Vlerat e temperaturës në qytetin e Ferizajt
Burimi: Instituti hidrometeorologjik i Kosovës (vjetari hidrometeorologjik 2020)

Në Ferizaj fryjnë më së shpeshti erërat veriperëndimore (N-248), veriore (N-142) dhe erërat juglindore (SE-147). Më së paku fryjnë erërat lindore (E-22). (Plani zhvillimor komunal i Ferizajt 2008)



z Figura 3. Erërat në komunën e Ferizajt
Burimi: Instituti hidrometeorologjik i Kosovës (vjetari hidrometeorologjik 2020)

3.6 Infrastruktura rrugore në Ferizaj dhe banimi (rrugët, trotualet, parkingjet, shtrirja e ndërtesave dhe shtëpive)

Infrastruktura fizike e mobilitetit në Ferizaj ka një shtrirje të zakonshme sikur në të gjitha qytetet e Kosovës. Përveç rrugëve kryesore pjesën tjetër të rrugëve të pa planifikuara dhe të ndërtuara në bazë të kushteve dhe nevojave të kohës.

Rrugët. Duke shikuar hartën vërejmë se lidhjet dhe rrjeti rrugor në komunën e Ferizajt është mjaft i mirë, po ashtu edhe brenda qytetit kemi një rrjet rrugor shumë mirë të lidhur me qendrën e qytetit që është pozitive, gjithashtu projektet e fundit brenda qytetit kanë lehtësuar komunikacionin. Ferizaj ka lidhje shumë të mirë në arterien kryesore të Kosovës, në drejtimin veri-jug, magjistralla N2/E65, e cila e lidh Prishtinën me Shkupin, si dhe në drejtimin lindje-perëndim, magjistralla N25-3, e cila lidh Ferizajin me Gjilanin dhe Prizrenin. Ferizaj ka gjithashtu lidhje të mira me Shtërpçën – Brezovicën ose Prevallën, Tetovën. Kurse për mes Shtimes lidhet me Prizrenin ose me autostradën Nish-Durrës.

Edhe rrugët rajonale dhe ndër-rajonale kanë një shtrirje mjaft të mirë hapësinore. Të gjitha këto rrugë nuk kanë shtigje për këmbësorë dhe biçikleta, prandaj edhe ekziston rreziku potencial i fatkeqësive në komunikacion. Gjithashtu shpesh herë mungojnë tabelat orientuese.

Të gjitha fshatrat janë të lidhura me rrugë të asfaltuara, por ju mungon lidhjet me çiklizëm e në disa fshatra mungon tretuari për këmbësor.

Rrugët Urbane apo skeleti rrugor urban është mjaft i mirë pasi që është i lidhur mirë me qendrën por pjesa më e madhe e tyre kanë kapacitet të ulët dhe mungesë te infrastrukturës përcjellëse si rrugë te veçantë për çiklist, pa trotuar, pa shenjëzim e sinjalizim, pa ndriçim etj.




Figura 4. Rrugët urbane në komunën e Ferizajt

Rruga kryesore e qendrës “Dëshmoret e Kombit” është rruga e cila i plotëson kushtet e një rruge urbane e sidomos krijimi i sheshit të qendrës i cili i ka dhënë liri te konsiderueshme këmbësorit për t’u shëtitur dhe argëtuar. Rruga tjetër paralel “12 Qershori” është rrugë e ngushtë dy kahore shumë e ngarkuar me komunikacion dhe banim, me trotuare te ngushta. Rruga tjetër paralele “Ahmet Kaçiku” me trotuare të mira por shumë e ngarkuar me trafik. Tri rrugët tjera që lidhin qendrën me pjesën lindore te qytetit (Rr. Regjep Bislimi, Rr. Vëllezrit Gervalla, Rr. e Reçakut dhe Driton Islami) janë rrugë të reja te zgjeruara me kushte te mira urbanistike. Tri rrugët tjera qe lidhin qendrën me pjesën perëndimore te qytetit (Rr. Epopeja e Jezercit, Rr. Ismet Ramadani, Rr Enver topalli) janë rrugë me kushte relativisht të mira urbanistike por të ngushta dhe të ngarkuara. Kurse rruga ne veri të qytetit Rr. Brahim Ademi (Rr. e Prizrenit) dhe Rr. e Varoshit ne jug te qytetit janë rrugë me kushte te mira dhe te zgjeruara.




Figura 5. Rrugët dhe stacionet në komunën e Ferizajt

3.7 Trotuaret

Një ndër çështjet më të rëndësishme në infrastrukturën fizike të mobilitetit janë trotuaret, pasi që në to lëvizin te gjithë njerëzit për aktivitetet e tyre ditore. Pjesa më e madhe e rrugëve kryesore dhe rrugëve të reja kanë trotuar te mjaftueshëm dhe kjo është shumë e rëndësishme për banoret, pasi që ne edhe po synojmë që në te ardhmen të bëjmë politika për te nxitur njerëzit për te ecur. Për ta arritur këtë qëllim natyrisht që përveç hapësirës së mjaftueshme për trotuar, është e rëndësishme standardet tjera teknike urbane siç janë: ndërtimi, dizajni, ndriçimi dhe mirëmbajtja e tyre. Fatkeqësisht një pjesë e këtyre trotuareve nuk i plotëson këto standarde teknike, por ngushëlluese është që ekziston hapësira dhe ne të ardhmen ne bazë te planeve te reja dhe menaxhimit te mirë do të rregullohen. Kjo do të nxiste lirinë e lëvizjes tek banoret rezident dhe tek mysafirët turistët që do të kishte Ferizaj.

3.8 Parkingjet

Sfidat e infrastrukturës rrugore në Ferizaj çdo ditë po shtohen si pasojë e rritjes së pronarëve të automjeteve dhe përdorimit te tyre, ku një rol shumë të rëndësishëm ka sigurimi i parkingjeve për automjete. Parkingjet sot janë një ndër sfidat kryesore në qytet e sidomos ne qendër.

3.9 Popullsia - Shtrirja e ndërtesave dhe shtëpive

Ferizaj është qyteti më i ri në Kosovë, historia e tij lidhet me hekurudhën. Vija hekurudhore ushtroj influencë pozitive për lindjen dhe ngjalljen e procesit shoqëror ekonomik. Sepse ky stacion u ndërtua në një udhëkryq të rëndësishme rrugor si dhe rreth këtij stacioni shtriheshin mjaft fshatra ku ndikoi në nisjen dhe zhvillimin e tregtisë, zejtarisë dhe veprimtarive tjera. Për shkak rëndësisë historike të hekurudhës, stacioni hekurudhor duhet të ruhet të restaurohet si një pikë historike e turistike.

Ky aktivitet ekonomik nxiti shumë migrime ku lokaliteti për pak vite arriti të numëroj rreth 4000 banorë (Ibrahim Hyseni Ferizaj 1873-1944). Ky ritëm i shpejtë i zhvillimit në përgjithësi vazhdoi deri me 1913 ku Kosova u pushtua nga Serbia dhe pas kësaj periudhe qyteti po thuhet se rritej vetëm me kolonitë serbe. Në mes të dy luftërave botërore pushteti i atëhershëm Ferizajn e emëron me emër të ri “Uroshevac”. Në këtë periudhë kohore Ferizaj e fiton një plan rregullativ, ku ky plan zbatohet kryesisht rreth rrugës së qendrës dhe hekurudhës duke bërë disa rrugë të reja, duke ndërtuar disa ndërtesa publike etj.

Pas luftës së dytë botërore në vitin 1961 Ferizaj fitoj planin tjetër të përgjithshëm urbanistik ku në bazë të këtij plani u ndërtuan disa ndërtesa kolektive, lagje me plan, fabrika, infrastruktura sociale dhe rrugë të reja.

Për shkak zhvillimit të shpejtë ekonomik migrimi ishte shumë i madh dhe te gjitha këto përpjekje dhe plane nuk mundën t'i bënin ballë migrimeve te shpejta drejt Ferizajt. Andaj u krijuan lagje banimi pa plan, pa infrastrukturë përcjellëse ku edhe sot ka pasoja, siç janë rrugët e ngushta dhe pa dalje, mirëpo në vitet e fundit janë përmirësuar duke asfaltuar e duke krijuar infrastrukturën përcjellëse.

Tabela 3. Indeksi bazik dhe varkor duke krahasuar Ferizajin dhe Prishtinën

Vitet	Ferizaj			Prishtina		
	Nr. Banor.	I. Bazik	I. Vargor	Nr. Banor.	I. Bazik	I. Vargor
1948	6685	100	100	19613	100	100
1953	8165	122.1	122.1	24081	122.7	122.7
1961	11665	174.4	142.8	38593	196.7	160.2
1971	22239	332.6	190.6	69514	354.4	180.1
1981	37723	564.2	169.6	109208	556.8	157.1

Krahasimi mes indeksit vargor dhe bazik del se Ferizaj ka pasur rritje më të shpejtë se Prishtina. Një plan tjetër Gjeneral Urbanistik, të hartuar në vitet 1987-1989, me afat të vlefshmërisë deri në vitin 2000 ishte një përpjekje tjetër për të menaxhuar migrimin e madh që po ndodhte. Kjo dinamikë e madhe e popullsisë dhe ekonomisë ka bërë që qyteti të ketë një ngarkesë të madhe në komunikacion, pasi që përveç banorëve urban qyteti gjeneron dhe thith shumë banorë nga komuna, rajoni dhe nën rajonet tjera të Kosovës dhe jashtë saj.

Nga migrimet e brendshme në komunat e Kosovës brenda vitit 2008-2011 qytetet që kanë pasur raport pozitiv në migrime janë Ferizaj (+563), Prishtina (+ 3294), Prizreni (+838), Fushë Kosova (+1987), kurse gjitha qytetet tjera kanë raport negativ Gjakovë (-299), Gjilan (-166), Mitrovicë (-302) (Agjencia e statistikave të Kosovës. Vlerësim: Popullsia e Kosovës 2011)

Në vitin 2021 vlerësohet se komuna e Ferizajt ka rreth 107 378 banorë (Agjencia e statistikave të Kosovës)

Qyteti i Ferizajt ishte qyteti me rritjen më të shpejt në Kosovë (Agjenci e Statistikave të Kosovës)

Në Ferizaj jeton dhe punon një numër i madh i qytetarëve jo rezident që janë të regjistruar akoma në vendbanimet e tyre jashtë komunës së Ferizajt e ndërkohë de fakto jetojnë në Ferizaj. Si në të gjithë Kosovën edhe në Ferizaj është trendi i migrimëve në vendet perëndimore dhe duke u referuar Agjencionit të statistikave të Kosovës del se në vitet e fundit

Tabela 4. Shtimi natyror i popullsisë në Ferizaj

Komuna Ferizajt	Nataliteti	Mortaliteti	Shtimi natyror
Vlerësimi i vitit 2021	1892	800	1092 banorë

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Komuna Ferizajt	Emigrimi	Imigrimi	Shtimi mekanik
Vlerësim i vitit 2021	2201	486	-1715

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Ky trend i migrimëve është një tregues i mirë se ne duhet të kemi kujdes me fuqinë punëtore ta ruajmë atë duke i trajtuar me dinjitet ekonomikisht e moralisht.

Tabela 5. Rritja e numrit të banorëve në qytetin e Ferizajt

Viti	1961	1971	1981	1999	2011
Ferizaj (qyteti)					
Nr. banorëve	11655	22239	37655	57421	42628

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës




Figura 6. Rritja e popullsisë gjatë viteve në Ferizaj

Tabela 6. Proporcioni (përqindja) e banorëve vetëm të qytetit të Ferizajt ndaj Kosovës

Vitet	Kosova	Ferizaj	% e popullsisë së Ferizajt ndaj Kosovës
1948	733,034	6,685	0.91%
1953	815,908	8,165	1%
1961	963,988	11,665	1.21%
1971	1,243,693	22,239	1.78%
1981	1,584,558	37,659	2.37%
1991 ²	2,100,000 ²	57,918 ³	2.75%
2011	1,739,825	42,628	2.45%

Ndërsa raporti i përqindjes urbane të Ferizajt ndaj asaj urbane të Kosovës është 6.44%

Nga migrimet e brendshme në komunat e Kosovës brenda vitit 2008-2011 qytetet që kanë pasur raport pozitiv në migrime janë Ferizaj (+563), Prishtina (+ 3294), Prizreni (+838), Fushë Kosova (+1987), kurse gjitha qytetet tjera kanë raport negativ Gjakovë (-299), Gjiilan (-166), Mitrovicë (-302) (Agjencia e statistikave të Kosovës. Vlerësim: Popullsia e Kosovës 2011)

Në vitin 2021 vlersohet se komuna e Ferizajt ka rreth 106286 banorë (Agjencia e Statistikave të Kosovës)

3.10 Karakteristikat e qytetit (primar, sekundar, terciar)

Nëse shikojmë historinë e Ferizajt shohim se krijimi i qytetit është ngushtë i lidhur me aktivitetet e hershme ekonomike.

Kryqëzimi i rrugëve të vjetra Prishtinë-Shkup dhe Anamoravë – Prizren e veçanërisht shtrirja e hekurudhës dhe ndërtimi i stacionit hekurudhor në këtë lokacion kanë qenë faktori kryesor i lindjes së tregtisë prodhimit dhe shërbimeve të ndryshme zejtare ku kanë nxitur krijimin e lokalitetit që shpejtë është krijuar Qytet.

²Nuk ka ndodhur regjistrimi i popullsisë

³Numri i supozuar i banorëve në Kosovë

⁴Numri i supozuar i banorëve të Ferizajt

⁵Banor të ardhur kryesisht prej rrethit të Nishit dhe me gjerë pas vitit 1878

Vlen të ceket se Ferizaj në vitin 1900 kishte 400 shtëpi dhe 200 lokale. Ky numri i madh i lokaleve flet për një dinamikë të madhe ekonomike me një ofertë tregtare jo vetëm për qytetin dhe fshatrat për rreth por ishte një treg ndër rajonal, që fatmirësisht e ka edhe ne ditët e sotme.

3.11 Karakteristikat sociale te qytetit (arsimi, shëndetësia, shërbimet, kultura, feja)

Qyteti i Ferizajt është zgjeruar në disa faza, të cilat janë të lidhura me ngjarje historike dhe ekonomike. Faza e parë konsiderohet faza nga fillimi i krijimi i vendbanimit 1874 deri ne pushtimin serb 1912. Karakteristikë e kësaj faze është se vendbanimi ishte kryesisht i shtrirë rreth hekurudhës dhe disa lagjeve te veçanta si lagjja e Muhagjereve , lagjja e romeve.

Arsimi: Gjate viteve të para të vendbanimit nuk ka pasur shkolla, por rolin e tyre e kanë luajtur mejtepet te cilat kanë qenë aktive dhe primare deri në pushtimin serb të Kosovës në fund të vitit 1912. Pas kësaj periudhe deri ne luftën e dytë botërore kanë qenë disa shkolla fillore ku mësimi zhvillohej në gjuhën serbe. Shpërndarja e këtyre shkollave ka qenë jo vetëm në Ferizaj por edhe ne rrethinë.

Shkolla e parë në gjuhën shqipe në Ferizaj është hapur më 27.XI.1941/42 me iniciativën e z. Shaban Shaqir Vatës që konsiderohet si pishtari i arsimit në Ferizaj (Ibrahim Hyseni Ferizaj 1873-1944). Kontribut të madh në hapjen e shkollave me mësim në gjuhën shqipe kanë dhënë mësuesit e ardhur nga Shqipëria në vitin 1941 dhe ndryshe quhet periudha e Ernest Koliqit, i cili solli mbi 240 mësues për t'i hapur shkollat me mësim në gjuhën shqipe në Kosovë.

Sot Ferizaj me rrethinë numëron 37 shkolla amë fillore dhe 8 shkolla të mesme dhe Fakultetin e Shkencave Aplikative. Kolegji private “Aga Xhite” që tërheqin një numër të madhë të nxënësve dhe studentëve nga komunat tjera jashtë Ferizajt.

Shëndetësia: Shëndetësia publike e Ferizajt organizohet në të tri nivelet shëndetësore: Kujdesi Primar Shëndetësor (Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, Kujdesi Sekondar Shëndetësor (Spitali Regjional dhe Qendra e Shëndetit Mendor në Komunitet), dhe Kujdesi Tretësor Shëndetësor (Instituti Regjional për Shëndet Publik).

Këto qendra shëndetësore disponojnë me punonjës lëmenjsh të ndryshëm të sistemuar nëpër njësitë e tyre punuese. Rrjeti i Institucioneve Shëndetësore në KPSH është i përbërë nga: një(1) Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare(QKMF) e tre (3) Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) brenda qytetit ,kurse në nivel fshatrash janë gjashtë (6) Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe gjashtë (6) Ambulanca të Mjekësisë Familjare AMF

Këto qendra shëndetësore disponojnë me punonjës lëmenjsh të ndryshëm të sistemuar në katër Qendra Kryesore Mjekësisë Familjare (QKMF) dhe 14 punkte shëndetësore në nivel fshatrash. (Udhërrëfyesi komunal). Gjithashtu vlen te ceket se ne Ferizaj ekzistojnë një numër i madh ordinancave dhe laboratorëve privat që ofrojnë shërbime mjekësore.

Organizimi shëndetësor në tri nivele ka bërë që Ferizaj të jetë qendër tërheqëse për komunat që janë ndër nivelin regjional, e te cilët banorë e shtojnë numrin e lëvizjeve në qytet. Sa i përket qendrave kryesore familjare kanë një shpërndarje te mirë në qytet pasi qe gjenden ne pjesët periferike të qytetit, e te cilat qendra mundësojnë qytetareve që të marrin shërbime më të shpejta pa pasur nevojë për të hyrë në qendër.

Shërbimet: Shërbimet në Ferizaj janë të ndryshme dhe të shumta pasi që Ferizaj është qendër regjionale. Shërbimet publike kanë një shtrirje të centralizuar.

Po ashtu edhe shërbimet tjera publike janë te centralizuara në qendër. Vlen te ceket se dy prej kompanive publike qe menaxhojnë me ujin dhe mbeturinat, kanë filluar ta hapin pika te reja në pjesë të ndryshme të qytetit.

Shërbimet e sigurisë siç janë Policia dhe Zjarrfikësit janë te centralizuara dhe shpeshherë nuk mund të kryen shërbim cilësor dhe te shpejtë tek qytetaret.

Kurse kompanitë tjera ekonomike si PTK, IPKO, dhe Bankat kanë një decentralizim të mirë dhe efikasë. Ky do të ishte shembulli më i mirë për të kuptuar se decentralizim do lehtësonte punën e stafit në qendër si edhe do ta lehtësonte komunikacionin në qendër

Kultura: Objektet kulturore në Ferizaj vitet e fundit kanë aktivitete edhe ndërkombëtare që tërheqin vizitorë. Ferizaj ka një Qendër kulture, Teatër, Galerinë e Arteve, Muzeun e Qytetit dhe dy Biblioteka ku të gjitha janë të shtrira për gjatë rrugës së qendrës së qytetit. Vlen të cekën “Festivali i teatrove”, “Festivali i filmit”, “Mural festë” etj që nëse do të ju ipët përkrahje ekonomike e ideore do të rriteshin dhe do të ndërkombtarizoheshin këto aktivitete kulturore.

Objektet e kultit apo fesë: Tërheqin mjaft vizitorë e sidomos Xhamia dhe Kisha Ortodokse në të njëjtin oborr (pavarësisht rrethanave historike të ndërtimit) janë interesant dhe pothuajse unike.

3.12 Shfrytëzimi i mjeteve motorike (kolektive, individuale)

Shfrytëzimi i mjeteve motorike si në të gjithë Botën ashtu edhe në Kosovë respektivisht në Ferizaj është jashtëzakonisht i madh. Natyrisht që transporti e veçanërisht mjetet motorike janë të domosdoshme për zhvillimin e turizmit edhe ekonomisë të një vendi, për shkak se lëvizja e njerëzve për të punuar, studiuar apo për t’u argëtuar është nga karakteristikat themelore të jetës moderne.

Integrimi i tregjeve brenda vendit, rritja e përgjithshme ekonomike dhe të ardhurat më të shumta kanë kontribuar edhe në rritjen e turizmit e që shton nevojën edhe të transportit e që është mjaft sfiduese. Andaj duhet menduar, përmirësuar e menaxhuar mirë transporti dhe parkingjet që të ketë sa më shumë vizitorë.

Në bazë të statistikave dhe hulumtimeve që janë bërë është gjetur se Ferizaj është një zonë e madhe gjeneruese dhe tërheqëse e trafikut krahasim me qytetet tjera.

Tabela 7. Zonat gjeneruese dhe tërheqëse të trafikut

Zonat gjeneruese të trafikut	%	Zonat tërheqëse të trafikut	%
Ferizaj	64	Prishtina	62
Vitia	9	Lipjan	20
Magedonia	8	Fushë Kosova	4
Kaqaniku	6	Ferizaji	4
Lipjani	2	Gjilani	0
Gjilani	2	Vitia	0
Shtërpca	2	Shtërpca	0
Hani i Elezit	2	Kaqaniku	0
Të Tjera	5	Të Tjera	10

Burimi: (N. Kelmendi 2011)

3.13 Shfrytëzimi i mjeteve pa motor (ecje, çiklizëm, etj.)

Rëndësia e qyteteve si hapësirë e jetesës për njerëzit është në rritje. Më shumë se gjysma e popullsisë së botës jeton sot në qytete. Qytetet janë motori i zhvillimit ekonomik dhe social. Ato janë gjithashtu vendet ku sfidat ekologjike dhe shoqërore të shekullit të XXI-të janë të theksuara në veçanti. Pjesë nga këto sfida përveç akseve të lëvizshmërisë motorike, rëndësi të veçantë ka edhe pjesët e lira si trotualet dhe sheshet për këmbësorë. Këto pjesë janë në dispozicion për të gjithë, miqësore për mjedisin dhe frymëmarrje për qytetin.

Të dhënat në disa vende tregojnë se përmirësimi dhe zgjerimi i trotuareve ka nxitur ecjen e udhëtarëve

Sot në Kosovë respektivisht në Ferizaj gjendja e trotuareve nuk është aspak e mirë. Në disa nga rrugët që ka trotuar mungon ndriçimi, një pjesë e tyre shpeshherë janë të bllokuar nga makinat, dhe bizneset e ndryshme, etj. Të gjithë këta faktorë mund të ndikojnë që banorët rezident brenda qytetit më shumë të përdorin mjetet motorike për udhëtim se sa ecjen në këmbë.


Në bazë të anketës dhe analizave që janë bërë, është konstatuar se shfrytëzimi i mjeteve pa motor është jashtëzakonisht i vogël në Ferizaj krahasuar me mjetet motorike.

Si shtesë e kësaj planifikuesit e mobilitetit urban gjithashtu dizajnojnë korridore të veçanta për llojet e buta të transportit ose dhe transport kolektiv (Mobkos)⁶

Kategorizimi i rrugëve na obligon për të menduar dhe shtruar pyetje në lidhje me rrjetin rrugorë. Për kë po e ndërtojmë këtë rrugë? Sa ka trafik? Çfarë lloji i trafikut zhvillohet? Cilat forma të transportit? Prioritetet për shpejtësi? Siguria? Besueshmëria? Transporti Publik? Këmbësorët? Turistët?

3.14. Kufizimet e qasjes në qendër dhe parkingu

Kufizimi i qasjes së automjeteve në qendrën e qytetit të Ferizajt dhe krijimi i sheshit gjatë vitit 2013 është pritur shumë mirë nga qytetarët e Ferizajt. Gjithashtu, kategorizimi i rrugëve të qytetit, jep mundësinë për të bërë kufizimin e shpejtësisë, ndalim qarkullimin për mjetet e rënda, si dhe menaxhimin e parkingut. Krejt këto masa japin një impakt shumë pozitiv në krijimin e një mobiliteti të shëndoshë dhe funksional.



3.15 Transporti hekurudhor

Linja kryesore e hekurudhës në Kosovë kalon nga Shkupi për në Mitrovicë, përmes qytetit të Ferizajt. Në njërin anë, hekurudha dhe stacioni kryesor në qendër të qytetit janë parë si lidhje me pjesën më të madhe të Kosovës dhe si veçori karakteristike për Ferizajn. Në anën tjetër, hekurudha është një barrierë përmes qytetit, e cilangadalë po ndryshon e po përmirësohet.

Linja hekurudhore ekzistuese përmes qytetit është riparuar, udhëkryqet janë përmirësuar. Stacioni kryesor është ende në qendër të qytetit të Ferizajt, e të cilin në të ardhmen mund të shfrytëzohet shumë mirë në lidhjen e qytetit me vendet tjera.

Përfundim

Nga hulumtimet e bëra mund të dalin disa konkluzione, si:

- Qyteti i Ferizajt është rritur dhe vazhdon të rritet shumë në mënyrë fizike e populative.
- Ferizaj gjendet në udhëkryq rajonal në mes Prishtinës – Shkupit dhe Rajonit të Dukagjinit – Ana moravës.
- Për shkak potencialit të madh tregtar e rekreativ që ka, Ferizaj vizitohet nga shumë banorë edhe të komunave tjera, si dhe nga qytetar nga shteti i Maqedonisë së Veriut.
- Trafiku në Ferizaj është i ngarkuar.
- Hekurudha në Ferizaj është një potencial i madh për komunikacionin, njëherit është edhe si pikënisje historike e turistike.
- Vetura mbetet mjeti më i përdorur nga udhëtarët, e prirë nga meshkujt në të gjitha distancat.
- Pjesëmarrja e trafikut me bicikletë është shumë e ulët (1%).
- Potenciali dhe vullneti për çiklizëm është shumë i madh (30%), nëse do të kishte infrastrukturë të përshtatshme.⁹

Duke pasur parasysh të gjithë faktorët, dhe kryesisht qëllimin për funksionim sa më të mirë të trafikut, janë bërë analiza dhe janë dhënë disa rekomandime:⁹

Objektivat afatshkurtëra e afatgjatë 2024/2034

1. Duhet bërë implementimi i infrastrukturës ligjore dhe azhurnimi PZHK dhe PZHU si dhe hartave zonale.
2. Duhet bërë ngritja e kapaciteteve profesionale për menaxhimin e mobilitetit, të cilët do të mbledhnin informata të ndryshme dhe të hollësishme për trendet e zhvillimit të trafikut.
3. Duhet bërë shfrytëzimi i mirë tokës urbane publike si dhe menaxhimi i mirë i tokës urbane private. Duke ruajtur ikonat historike e turistike.
4. Planifikimi dhe krijimi i infrastrukturës fizike të përshtatshme për të gjitha mjetet e transportit dhe këmbësorët.
5. Shtimi i nënkalimeve rrugore nën hekurudhë edhe në dy pika (tek stacioni polior dhe tek rrethi rrugës së Regjep Bislimi), ku do të mundësonte komunikacion dhe trafik dy nivelesh.
6. Nën e mbikalime më të shpeshta të hekurudhës për këmbësor.
7. Planifikimin dhe ndërtimin e disa rrugëve të qytetit sipas profileve të propozuara në PZHU dhe propozimet tona me profile dhe staza të mjeteve pa motor.
8. Ndërtimin e disa rrugëve tranzitore më qëllim anashkalimin e qytetit nga trafiku tranzit.
9. Krijimin e unazave të brendshme dhe të jashtme.
10. Duhet bërë ndryshime në menaxhimin e trafikut, krijimi i shesheve të reja si dhe rregullimi dhe rikonstruktimi i trotuareve për të nxitur ecjen.
11. Organizimi i linjës së autobusit urban.
12. Krijimi i një qendre të transportit multi modal në vendin e sotëm të stacionit të trenit ose stacioni i autobusve, pasi lokacioni i stacionit të autobusve do të ndryshoj, i cili mundësisht do t'i integronte të gjitha format e mobilitetit.
13. Krijimi i shiritave të veçanta rreth rrugëve dhe vend parkingjeve për biçikleta, sidomos rrugët përmbledhëse të qytetit. Po ashtu duhet obligohen institucionet publike dhe ato private që të krijojnë vend ndalesa për biçikleta.
14. Zgjerimi dhe shndërrimi një segmenti rrugor të rrugës - Dëshmorët e Kombit dhe rrugëve tjera në rrugë për këmbësor.
15. Promovimi i politikave për trafik të pastër human.
16. Ndërtimi i rrugës unazore (transitit) jashtë qytetit dhe përmirësimi i rrugëve që ndërlidhen me të.
17. Zgjerimi i rrugës për Jezerc dhe krijimi i linjës për mjete pa motor.

Këto masa do të ndikojnë në mënyrë shumë pozitive që qyteti të jetë human edhe miqësor që të jetë joshës dhe mikpritës për vizitorët.

4. Analiza SWOT

Përparësitë	Dobësitë
- Infrastruktura ligjore - Pozita e favorshme gjeografike për qasje në tregje - Zhvillimi i infrastrukturës rrugore -Autostradat, - Afërsia me aeroportet Prishtinë, Tiranë Shkup, me portin e Durrësit dhe të Selanikut, - Qendrën e skijimit në Brezovicë, Malet e Sharrit etj.) - Rinia e përgaditur profesionalisht në fushën e TIK-ut - Fuqia e re punëtore me potencial për punë - Prezenca e qendrave për aftësim profesional - Përvoja dhe tradita industriale (industria e drurit, metalike, industria ushqimore, veprimtaritë artizanale etj.), - Fryma multi-kulturore,	- Mungesa kapaciteteve profesionale për hartim të politikave të zhvillimit ekonomik lokal - Inkasimi i të hyrave vetanake vjetore nën nivelin e planifikuar - Varësia e madhe buxhetore në grantet qeveritare - Definimi jo i qartë i kompetencave në mes të nivelit lokal dhe qendror - Mungesat e mbështetjes së grave për t'u përfshirë në tregun e punës - Mungesa e infrastrukturës dhe vetëdijesimit për riciklimin dhe ripërdorimin e mbeturinave - Mungesa e planifikimit të përgjegjshëm urban - Mungesa e zonës ekonomike në Komunën e Ferizajt,

- Baza ushtarake amerikane Bondsteel (siguria fizike dhe materiale),
- Tokë pjellore dhe kullota të përshtatshme për zhvillimin e agrobiznesit,
- Remitencat nga diaspora
- Strehim i qëndrueshëm (përqindje e lartë e pronësisë së banimit familjar),
- Pozicioni i shkëlqyer gjeostrategjik,
- Potencialet e fuqisë punëtore të lirë dhe të trajnuar
- Potencialet natyrore të favorshme për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit,
- Potencialet natyrore për zhvillim të turizmit
- Projektet aktuale për bashkëpunim ndërkufitar, sidomos në fushën e turizmit
- Vet-kompetencë për zhvillimin e infrastrukturës publike, e cila plotëson nevojat e qytetarëve dhe bizneseve etj.
- Kushtet e mira agro-klimatike për kultura të veçanta
- Traditë në prodhimin e pemëve, perimeve, si dhe prodhimet blegtorale
- Trend në rritje i zhvillimit të fermave komerciale,
- Kullota të mjaftueshme për shfrytëzim,
- Trend i rritjes së kapaciteteve përpunuese,
- Rritje e kërkesës së konsumatorëve për prodhime vëndore të freskëta
- Zyrtar komunal për ofrim të asistencës për çështje bujqësore
- Lehtësirat ligjore për shfrytëzim të pronës komunale nga investitorët
- Përmirësimi i racor i gjedhit është duke vazhduar
- Zhvillimi i infrastrukturës digjitale për lidhje ndërkombëtare:
- Investimet e huaja dhe lidhjet me diasporën:
- Lidhjet e mira me komunitetin e diasporës, nëpërmjet organizatave të tilla si "Germin" që mund të sigurojë financim dhe ekspertizë për prezantimin e ekspertëve nga diaspora
- Zonat rurale (fshatrat) janë shtëpi për gjysmën e popullsisë, dhe

- Infrastruktura publike (rrjeti i dobët i energjisë elektrike, ujësjellësit dhe kanalizimit),
- Mungesa e kuadrove të kualifikuara në disa fusha specifike për tregun e punës,
- Mungesa e standartizimit të kompanive dhe çertifikimit të produkteve,
- Transformimi - digjitalizimi i ngadalshëm i të NVM dhe shërbimeve komunale,
- Prania e ekonomisë informale,
- Buxheti i limituar,
- Largimi i fuqisë punëtore të re dhe cilësore,
- Niveli i lartë i papunësisë tek të rinjtë,
- Infrastruktura komunale e zhvilluar në mënyrë të pamjaftueshme,
- Mungesa e fondeve (lokale) për zhvillim,
- Niveli i ulët i konkurrencës në ekonominë lokale.
- Inkasimi i ulët i të hyrave komunale,
- Menaxhimi jo racional i buxheteve komunale;
- Centralizimi i të hyrave vetanake;
- Infrastruktura publike lokale nuk i plotëson në mënyrë adekuate nevojat e qytetarëve dhe bizneseve;
- Funksionimi i shërbimeve elektronike brenda komunes për qytetarët dhe bizneset në nivel jo të kënaqshëm;
- Menaxhimi jo adekuat i pronës komunale me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal;
- Pengesat ligjore për mbledhjen e të hyrave nga shfrytëzimi i burimeve natyrore
- Toka bujqësore e fragmentuar në ngastra të vogla,
- Ndërtimet ilegale në toke bujqësore,
- Braktisja e aktivitetëve bujqësore,
- Problem me pronësinë – mos transferim i trashëgimisë,
- Mungesa e njohurive të mjaftueshme të fermerëve për shfrytëzimin e praktikave të mira,
- Mungesa e infrastrukturës bujqësore – sidomos ujitja,
- Mungesë e kapaciteteve përpunuese,
- Njohuritë, informacioni dhe aftësitë e pamjaftueshme për menaxhimin e fermës,
- Papunësia e të rinjve dhe migrimi:
- Mungesa e orientimit në karrierë:
- Ka mungesë të vendeve të punës dhe pagat janë të ulëta:
- Mundësi të ulëta për bizneset që të digjitalizohen dhe të eksportojnë shërbime digjitale shumë fitimprurëse që kërkojnë pak investime:
- Komunitat dhe bizneset nuk janë të pranishme në mënyrë digjitale në platformën kryesore BUSINESS si LinkedIn (1 miliard përdorues)
- Mungesa e Wi-Fi të disponueshëm publikisht për të rritur iniciativën e qyteteve inteligjente

MUNDËSITË	RREZIQET
- Disponueshmëria e fondeve të donatorëve - Grante specifike nga niveli qendror për nivelin komunal - Përdorimi i teknologjisë digjitale moderne - Bashkëpunimi me diasporën për investime të përbashkëta dhe transferim të dijes - Tregjet e përbashkëta ndër-komunale - Ofrimi i mundësive për standartizim të kompanive dhe çertifikim të produkteve, - Zvoglimi i ekonomisë informale, - Rritja e mundësive buxhetore, - Ofrimi i shërbimeve të transportit urban, - Organizimi i panairove vjetore të bizneseve, - Krijimi i tregut ditor, - Qasje në tregjet ndërkombëtare dhe BE-së përmes proceseve të anëtarësimit, - Planifikimi i pavarur i të hyrave vetanake pa ndikim të nivelit qendror; - Rritja e inkasimit të të hyrave vetanake; - Hapja e qendrës së inovacionit të biznesit si përsheptues dhe inkubator që mbështet rritjen e sipërmarrësve, startup-eve dhe SME-ve (d.m.th. ICK & ITP) në fusha specifike si teknologjia, bujqësia, etj. - Të investohet në infrastrukturën bazike midis qytetit dhe zonave rurale - Tu ofrohen lehtësira bizneseve prodhuese me aftësi të larta që të eksportojnë produktet e tyre (e-commerce) - Të motivohen të rinjtë për të kontribuar në industrinë rurale nëpërmjet krijimit të eko-fshatrave të vetë-qëndrueshme (shih shembullin e Skocisë) - Zhvillimi i kalendarit vjetor digjital dhe interaktiv për turizmin e Ferizajt.	- Kërcënimi nga kriza energjetike globale, - Inflacioni i importuar nga vendet e huaja - Situatat e jashtëzakonshme (pandemitë, fatkeqësitë] natyrore, etj.) - Emigrimi i rinisë së shkolluar jashtë vendit (brain drain), - Vendimet e pakoordinuara nga niveli qendror me efekt negativ financiar në komuna - Emigrimi i fuqisë punëtore jashtë vendit, - Digjitalizimi i dobët

5. Përmbledhja e analizës së problemeve

Komunat kanë zvogëluar ndjeshëm ngarkesat administrative që ndërlidhen me themelimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve, duke kontribuar kështu në përmirësimin e gjithmbarshëm të klimës së të bërit biznes. Përkundër këtij progresi, ndërmarrjet ende ballafaqohen me sfida të shumta që ua pamundësojnë realizimin e potencialit të tyre konkurrues. Në anketën e zhvilluar me biznese për nevojat e këtij programi, konkurrenca e pandershme, qasja e kufizuar në financa dhe praktikat korruptive, renditen në mesin e barrierave kryesore që pengojnë zhvillimin ekonomik lokal. Dy të parat figurojnë në mesin e pesë barrierave kryesore edhe në një anketë të zhvilluar rishtazi nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), krahas atyre që kanë të bëjnë me koston e energjisë elektrike dhe qasjen në të. 3 Investimet në nivel komunal janë të kanalizuar kryesisht në projekte të natyrës infrastrukture, sidomos në rrugë. Prona komunale dhe mundësia që ajo të ofrohet për shfrytëzim përbën një mjet të rëndësishëm për komunën për t'i stimuluar investimet. Aktualisht mbi 90% e komunave janë deklaruar ta kenë bërë inventarizimin e pronave të tyre. Pjesa më e madhe, madje, janë të qasshme për publikun. Përkundër inventarizimit të kryer, në shumë raste nuk është bërë klasifikimi për ta qartësuar se cilat pronat janë të lira dhe të gatshme për shfrytëzim. Disa prej komunave nuk kanë fare në dispozicion pronë që mund të jepen, për t'u shfrytëzuar për qëllime investuese. Deri tash, sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), përvojat sa i përket dhënies së pronave në shfrytëzim nuk kanë qenë shumë të mira.⁴ Janë dokumentuar vështirësi në mbledhjen e qirave, konteste gjyqësore dhe kontrata të dëmshme. Sektori privat, duke qenë i dominuar nga mikro-ndërmarrjet në pronësi familjare, ka qenë pak i gatshëm të realizojë investime me efekte të konsiderueshme për zhvillimin ekonomik lokal. Ngjashëm, investimet e huaja në aktivitete ekonomike më vlerë të shtuar dhe me potencial punësimi kanë qenë në nivel jo të kënaqshëm. Zonat ekonomike apo parqet industriale, ndonëse të krijuara në disa komuna kryesore për të thithur investime, deri tash shumë pak kanë arritur t'i shërbejnë këtij qëllimi. Shumica e tyre kanë mbetur me infrastrukturë të papërfunduar dhe për pasojë të nën-populluara. Asnjë nga zonat aktuale, as ato që janë më funksionale, nuk kanë njësi brenda tyre që merret me menaxhimin dhe administrimin e tyre. Në disa raste ka edhe përzjerje të kompetencave sa i takon pronësisë së tyre. Shumica dërrmuese e komunave nuk posedojnë materiale promovuese që ofrojnë informata mbi potencialet dhe mundësitë për të investuar. Për më shumë, vetëm 23% e komunave kanë zyra apo njësi që merren ekskluzivisht me promovim të mundësive për investimeve.⁵ Kësisoj, investitorët potencial shpeshherë nuk kanë qasje në informatat e nevojshme për të ndërmarrë hapa drejt investimit.

Bujqësia është qenësore për zhvillim rural dhe luan një rol mjaft të rëndësishëm në ekonominë lokale. Ndonëse komunat ofrojnë mbështetje për zhvillim të bujqësisë, kjo mbështetje mbetet e pamjaftueshme për t'i adresuar disa nga problemet parësore të këtij sektori, siç janë: fermat e vogla, teknologjia dhe mjetet e vjetruara të punës, kostot e larta të inputeve bujqësore, si dhe integrimi i kufizuar në industri të ushqimit. Turizmi, si sektor tjetër me rëndësi, veçanërisht turizmi rural apo agroturizmi, përkundër potencialit që ka, nuk është zhvilluar sa duhet. Atraksionet turistike, përkatësisht monumentet e trashëgimisë kulturore, pak vihen në funksion të promovimit të ekonomisë kreative. Zejtarët lokalë, si akterë të rëndësishëm identitar të komunave, po ballafaqohen me vështirësi të theksuara në aspekt të qëndrueshmërisë financiare.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), në përgjithësi, kanë nevojë për përkrahje për të ndjekur trendin e vendeve tjera. Ato kanë ngecur sidomos në aspekt të digjitalizimit dhe inovacionit, si në nivel të produkteve ashtu edhe të proceseve. Të dhënat e fundit nga ndërmarrjet prodhuese, për shembull, tregojnë se niveli i digjitalizimit është sa gjysma e nivelit tek ndërmarrjet homologe në Bashkimin Evropian (BE).⁶ Situatë e ngjashme është edhe te inovacioni. Vetëm 36.6% e ndërmarrjeve prodhuese deklarojnë se kanë prezantuar një produkt/shërbim të ri ose një risi në procese.⁷ Kjo përqindje është afërsisht sa gjysma e mesatares në Ballkanin Perëndimor (PB). Në kryeqytet dhe në disa komuna tjera janë hapur qendra të inovacionit (apo "hubs") për t'u shërbyer ndërmarrjeve, sidomos atyre të reja, në jetësimin e ideve inovative. Duke përjashtuar kryeqytetin, ato që operojnë në komunat tjera nuk shquhen për modele të qëndrueshme të financimit dhe kanë vështirësi të shërbejnë si inkubatorë tipik të inovacionit.

Tek sektori privat dhe palët që merren me zhvillim ekonomik lokal ekziston një nivel i ulët i vetëdijes mbi ekonominë qarkore dhe përparësitë që sjellë kjo qasje në aspekt ekonomik dhe në kontekst të rruajtjes së burimeve natyrore dhe përgjithësisht mjedisit. Kur mungojnë informacionet, situata në terren nuk mund të jetë më e mirë. Ndonëse riciklimi konsiderohet element integral i ekonomisë qarkore, në komuna nuk ka infrastrukturë të etabluar mirë për riciklim. Ndarja e mbeturinave, në masë të madhe, bëhet në mënyrë jo formale dhe materiali riciklues kryesisht eksportohet pa u përpunuar. Vlerësohet se një përqindje e vogël ndërmarrjeve shfrytëzojnë material të riciklueshëm. Aspektet e ekonomisë qarkore si ripërdorimi i materialit, mundësitë për riparim dhe përgjithësisht funksionimi në lak të mbyllur kanë zënë shumë pak vend në praktikën biznesore.

Në tregun e punës ekziston një mungesë e theksuar e shkathtësive për t'i përmbushur nevojat e sektorit privat. Përderisa në të kaluarën, ndër sfidat kryesore të bizneseve ka qenë gjetja e fuqisë punëtore të kualifikuar, në vitet e fundit, veç kësaj, bizneset po hasin gjithnjë e më shumë vështirësi në gjetjen e profileve me shkathtësi të ulëta. Shkak kryesor për këtë janë tendencat migruese të kësaj kategorie, qoftë jashtë Kosovës apo nga komunat e vogla drejt komunave të mëdha, kryesisht drejt kryeqytetit. Në hulumtimin e zhvilluar me drejtorë (ose përfaqësues tjerë) të zhvillimit ekonomik në nivel komunal dhe në atë me biznese, kategoria “vështirësitë në gjetjen e punëtorëve”, është renditur si pengesa e parë, respektivisht e dyta më seriozia për zhvillimin ekonomik lokal. Gjithashtu, mbi 85% e të njëjtëve vlerësojnë se migrimi është problem i madh ose shumë i madh për komunat e tyre. Në komuna më të vogla, kjo përqindje është edhe më e lartë. Problemet me tregun e punës konfirmohen edhe në burime tjera hulumtuese. Një hulumtim i OEK, për shembull, tregon se 82.4% e ndërmarrjeve në Kosovë e kanë të vështirë të gjejnë punëtorë të kualifikuar.⁸

Komunat nuk mbledhin të dhëna sistematike për t'i identifikuar profilet që nevojiten në tregun e tyre. Sipas anketës me biznese, disa nga profilet të cilat mungojnë më së shumti janë salduesit, inxhinierët softuerik me përvojë, operatorët e pajisjeve dhe axhustatorët. Bashkëpunimi në mes të sektorit privat dhe shkollave profesionale apo qendrave të akredituara të trajnimit është në nivel të kufizuar. Mungojnë mekanizmat funksionalë që u krijojnë mundësi bizneseve të ofrojnë ndihmën e tyre në hartimin e standardeve të profesionit për shkollim/aftësim profesional. Në anën tjetër, bizneset shumë pak shfaqin interesim për të ofruar mundësi për përvojë praktike në vend të punës. OEK nxjerr në pah se 61.6% e ndërmarrjeve nuk bashkëpunojnë fare me fakultete, shkolla profesionale, qendra trajnuese apo qendra të punësimit.⁹ Për më shumë, firmat rrallë ofrojnë trajnime për punëtorët e tyre. Në sektorin e prodhimit, sipas Bankës Botërore (BB), vetëm 26% të punëtorëve u ofrohet trajnim – pra, trajnimi në punë mungon në shumicën e rasteve.¹⁰ Një problem tjetër është se tek moshat më të vjetra ekziston hendek i theksuar në shkathtësi digjitale. Këto shkathtësi po bëhen të nevojshme çdo here e më shumë.

Në sektorët që janë më të cenueshëm ndaj aksidenteve në punë nuk ofrohet siguri e mjaftueshme. Sipas të dhënave të Inspektoratit të Punës, janë evidentuar 188 aksidente në vend të punës – 9 prej tyre kanë përfunduar me fatalitet.¹¹ Ndërtimtaria mbetet sektori më i rrezikuar në këtë drejtim. Informaliteti në treg të punës mbetet mjaft i lartë. Sipas vlerësimeve të fundit të ASK-së, punësimi joformal është rreth 35%.¹² Një problem tjetër shqetësues është se ekziston një nivel i ulët i integritetit të grave në tregun e punës. Konkretisht, vetëm 20% e tyre marrin pjesë në tregun e punës. ¹³ Ky fenomen është ende më i theksuar në profesione të cilat tradicionalisht u kanë takuar burrave.

Ndonëse një pjesë e madhe e buxhetit të komunave investohet në infrastrukturë, sidomos në infrastrukturë rrugore (rreth 27%), nuk duket që të ketë krijuar ndikim të mjaftueshëm. Sipas një ankete të realizuar me qytetarë, për nevoja të “Studimit gjithëpërfshirës së sistemit të vetëqeverisjes lokale në Kosovë”, përgjithësisht ekzistojnë pakënaqësi në lidhje me furnizimin me ujë dhe pijshëm, menaxhimin e mbeturinave, transportin lokal, infrastrukturën rrugore, kanalizimin dhe trajtimin e ujërave të zeza.¹⁴

Kur vjen puna te financat lokale, komunat i mbulojnë shpenzimet e tyre nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake. Sasia e mjeteve që alokohet tek komunat nga niveli qendror përmes grantit të përgjithshëm dhe granteve tjera përcjellëse, në raport me të hyrat që ka vendi, konsiderohet relativisht e kënaqshme. Megjithatë, mënyra e shpërndarjes përmes granteve, duke e anashkaluar ndërlidhjen e drejtpërdrejtë me të hyrat nga disa lloje të tatimeve (psh. tatimi në të ardhura personale), nuk vlerësohet mënyra më e përshtatshme dhe dallon nga praktikën në vendet e ngjashme në rajon dhe më tej.

Për më tepër, ndarja e granteve qeveritare në formë lineare ka bërë që komunat të mos jenë shumë aktive në realizimin e të hyrave vetanake dhe të mos zhvillojnë një lloj konkurrence ndërmjet veti në këtë drejtim.

Në anën tjetër, kompetencat që u janë lënë komunave për të krijuar të hyra nga burimet vetanake (tatimi në pronë, taksat, tarifat dhe ngarkesat tjera komunale) janë të pamjaftueshme për t'i bërë ato të vetëqëndrueshme financiarisht. Pjesa më e madhe e komunave nuk arrijnë t'i mbulojnë më shumë se 15% apo 20% të shpenzimeve nga të hyrat që i arkëtojnë nga burimet vetanake.¹⁵ Vlen të theksohet se veçanërisht komunat e vogla grumbullojnë pak të hyra vetanake dhe në masë të madhe varen nga grantet e nivelit qendror. Si rezultat, këto komuna nuk kanë mjete të mjaftueshme për investime në projekte dhe ushtrim të mirëfilltë të kompetencave vetanake. Në përgjithësi, varësia në masë të madhe nga niveli qendror, përkatësisht mungesa e qëndrueshmërisë financiare, nënvizohet si një prej problemeve të mëdha të komunave për zhvillim ekonomik lokal.

Një sfidë tjetër e financave lokale janë borxhet apo të arkëtueshmet. Përderisa tek rasti i tarifave qytetarët obligohen të paguajnë në momentin kur e pranojnë shërbimin nga komuna, e njëjta gjë nuk është edhe tek tatimet. Për këtë arsye, vështirësitë më të mëdha janë të mbledhja e tatimit në pronë. Shumë prej borxheve ndaj komunave janë vjetërsuar. Këto borxhe, nuk mund të mblidhen, mirëpo as nuk mund të falen apo shlyhen, meqë komuna nuk e ka atë kompetencë.

Në bazë të ligjit për financat e pushtetit lokal, lartësia e tarifave komunale duhet të jetë në proporcion me shpenzimet e komunës, për ofrim të një shërbimi të caktuar. Komunat nuk zhvillojnë ndonjë analizë, përmes të cilës matin kostot e shërbimeve të tyre. Në mungesë të një procesi të kostimit, komunat i vendosin në mënyrë arbitrare tarifat në shërbimet që i ofrojnë. Si rezultat, ekzistojnë dallime të mëdha në mes të komunave sa i takon nivelit të tarifave.

Caktimi i kufijve për kategoritë e shpenzimeve nga niveli qendror, përkatësisht Ministria e Financave, Punësimit dhe Transfereve (MFPT), kufizon aftësinë e komunave për ta përdorur buxhetin e tyre në mënyrë të lirë. Bazuar në të dhënat nga komunat, ankesat kryesore vijnë sidomos për kufizimet në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe subvencioneve.

Në shpenzim të buxhetit, mangësi konsiderohet mbikëqyrja e punëve që realizohen nga kontraktorët. Për shembull, kontraktohet kryerja e punëve për ndërtimin e një rruge të caktuar, mirëpo në shumë raste, mungon mbikëqyrja nga komuna gjatë kryerjes së punëve nga kontraktori. Kjo rezulton në cilësi të dobët të punëve të kryera.

Tjetër sfidë me mjaft prezencë është numri i madh i kontratave në raport me numrin e vogël të zyrtarëve të prokurimit.

Në përgjithësi, vlerësohet se zhvillimi ekonomik lokal nuk ka qenë ndër prioritet kryesore të komunave. Më pak se gjysma e komunave kanë strategji për zhvillimin ekonomik lokal. Shumica dërrmuese e atyre që kanë strategji (86.7%), raportojnë se e bëjnë monitorimin e strategjive në baza të rregullta. Nga takimi me komuna është kuptuar se, megjithatë, nuk ekziston një kornizë monitoruese uniforme, që e mat realizimin e aktiviteteve dhe ndikimin në objektiva.

Kapacitetet profesionale për zhvillim ekonomik në institucione komunale janë të pamjaftueshme. Sipas UNDP-së, vetëm 21.6% e drejtorëve, shërbyesve civilë dhe asamblistëve vlerësojnë se niveli komunal ka kapacitete të brendshme për hartimin e strategjive për zhvillimin ekonomik lokal. Gjithashtu, kapacitetet janë të kufizuara edhe kur vjen puna të hartimi i projekteve për të tërhequr fonde nga donatorët e huaj. Shumë komuna kanë mungesë të personelit të kualifikuar në shumë departamente dhe kjo ndikon negativisht në mjedisin e biznesit. Nga ana tjetër, disa komuna janë me staf të tepërt, por që nuk menaxhohen si duhet.

Bashkëpunimi në mes të komunave dhe komunitetit të biznesit vlerësohet të jetë në nivel jo të kënaqshëm. Vetëm një përqindje e vogël e komunave, kryesisht ato që janë më të mëdha, kanë shoqata/organizata biznesi funksionale, të cilat përfaqësojnë dhe ndihmojnë sektorin privat duke i artikuluar nevojat e tyre. Probleme ka edhe në mes të nivelit lokal dhe qendror në lidhje me zhvillimin ekonomik. Paqartësia rreth kompetencave në mes të nivelit lokal dhe atij qendror është renditur si barriera më serioze në anketën e zhvilluar me komuna. Bashkëpunimi ndër-komunal, në anën tjetër, është kryesisht në projekte investuese infrastrukturore. Komunat deklarojnë se gjysma e tyre kanë projekte të përbashkëta, ku përfshihen asfaltimi i rrugëve, hapja dhe definimi i shtigjeve për qëllime turistike, rregullimi i shtretërve të lumit dhe të ngjashme.

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, komuna ka kompetenca të plota dhe ekskluzive sa i përket interesit lokal, ku është përcaktuar saktësisht edhe fusha e zhvillimit ekonomik lokal. Duke iu referuar bazës ligjore të lartpërmendur, lirisht mund të themi se për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal duhet të ekzistojë një komunë e fortë e cila ushtron autorizimet publike që ndikojnë në zhvillimin ekonomik lokal. Në këtë kontekst, ndërtimi i politikave në nivel lokal është një parakusht kyç për mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve.

Komuna është përgjegjëse për krijimin e një klime dhe një mjedisi të favorshëm për biznes, me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal. Për të pasur një zhvillim ekonomik lokal, është e nevojshme të kemi një politikë gjithëpërfshirëse dhe të mirëndërtuar ku do të përfshihen programe të ndryshme dhe të qarta, të cilat ndahen sipas fushave përkatëse, duke filluar nga:

- a) *investimi në burime njerëzore,*
- b) *ruajtja dhe avancimi i bizneseve ekzistuese,*
- c) *tërheqja e bizneseve të reja,*
- d) *planifikimi dhe përcaktimi i zonave të investimit dhe zonave ekonomiko-industriale,*
- e) *sigurimi i një mjedisi të përshtatshëm dhe të sigurt për investimet e huaja direkte,*
- f) *adoptimi i teknologjive moderne,*
- g) *administrimi i burimeve dhe i përdorimit të tokës të pashfrytëzuar,*
- h) *si dhe shumë faktorë të tjerë që ndikojnë dhe janë përcaktues në zhvillimin ekonomik vendas.*

Në këtë drejtim, hartimi i politikave të qarta dhe konkrete si dhe procesi i planifikimit strategjik për zhvillimin ekonomik vendor, arrihet përmes një kulture të përbashkët të punës, mes njerëzve dhe formimit të partneriteteve afatgjata. Këta elementë thelbësorë mundësojnë një rritje të qëndrueshme ekonomike, ku përfitimet ekonomike, përmirësimi i kushteve të jetesës si dhe cilësia e jetës së qytetarëve, pa dallim, do të ishin thelbësore dhe të dukshme

Prandaj, në këtë fazë të re të zhvillimit, nevojitet një qasje e re ndaj politikave zhvillimore në nivel lokal. Kjo qasje e re adreson të gjithë faktorët (faktorët e jashtëm dhe të brendshëm) të cilët kufizojnë rritjen ekonomike.

Bazuar në të dhënat ekzistuese, Komuna e Ferizaj përballlet me shumë vështirësi në lidhje me rolin e saj në politikën e zhvillimit ekonomik lokal. Në këtë drejtim kanë ndikuar shumë faktorë si:

- burimet e pamjaftueshme financiare,
- zhvillimi i ulët ekonomik në nivel vendi,
- mungesa e kapaciteteve profesionale,
- dëmtimet në ekonominë e pasluftës,
- problemet pronësore,
- mungesa e shërbimeve të nevojshme jetësore si uji, kanalizimi, rrugë, objekte shkollore dhe rekreative etj.

Të gjitha këto kanë shkaktuar pengesa dhe kufizojnë mundësitë e komunës për të realizuar projekte zhvillimore duke u përballur me një stagnim në ekonominë lokale si dhe thellim të papunësisë në vend. Duke marrë parasysh shkallën e lartë të papunësisë në Kosovë, e cila gjeneron varfëri dhe ndikon në cilësinë e dobët të jetës, nevojitet krijimi i platformave të reja për të ripërcaktuar rolin e komunës në këtë drejtim. Të dhënat statistikore mbi treguesit e punësimit dhe papunësisë sipas moshës, gjinisë, statusit të punësimit, aktiviteteve ekonomike, profesioneve dhe fushave të tjera të tregut të punës tregojnë që shkalla e papunësisë në Komunën e Ferizaj është rreth 30.6% me shume se mesatarja kombëtare 25.7%. Tregtia, prodhimi, ndërtimi dhe arsimit vazhdojnë të punësojnë pothuajse gjysmën e të punësuarve. Në këtë periudhë, numri i grave që i përkasin fuqisë punëtore është rreth 34.30% dhe i meshkujve 65.7%, ndërsa shkalla e papunësisë tek të rinjtë është rreth 27.9%.

Duke marrë parasysh këtë normë të lartë të shprehur, Strategjia për Zhvillimin Ekonomik Lokal synon të

adresoje zgjidhje, me qëllim përmirësimin e politikave për zhvillimin ekonomik lokal duke rritur kapacitetet ligjore dhe funksionale të Komunës për të dhënë rezultate në rritjen ekonomike në nivel vendor.

Kjo Strategji e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2024-2034 - nxjerr në pah një sërë masash të lidhura ngushtë me kompetencat e Komunës që duhet të ndërmerren për të siguruar një sistem më të qëndrueshëm të politikëbërjes dhe zbatim më efektiv në:

- *kompletimi i kornizës së dokumenteve hapësinore në nivel lokal,*
- *menaxhim me efikas të shërbimeve publike,*
- *planifikimin më të mirë të politikave,*
- *përgatitje të kapitalit njerëzor,*
- *promovim të shkollave profesionale dhe rëndësia e arsimit me tregun e punës,*
- *shpenzimi i drejtë i parasë publike,*
- *promovimi i tregut të tokës dhe burimeve të tjera që mundësojnë rritjen ekonomike.*

Janë disa nga qasjet që kërkojnë adresimin në një periudhë të ardhshme veprimi. Prandaj, është e rëndësishme të vendoset një qasje koherente ndërmjet qëllimeve afatgjata me strategjitë afatmesme, përmes të cilave mund të vendosen objektiva specifike për rregullimin e një politike të caktuar, siç është zhvillimi ekonomik lokal.

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2024-2030 parasheh masa shumësektoriale për forcimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale, duke përfshirë alternativat për rritjen e autorizimeve të komunës në fushën e zhvillimit ekonomik lokal. Me miratimin e kësaj strategjie dhe planit të veprimit, do të jepen orientime programore afatgjata në nivel lokal për të rikonfirmuar rëndësinë e qeverisjes vendore si një mekanizëm i pazëvendësueshëm për zgjidhjen e problemeve praktike të qytetarëve. Nëpërmjet objektivit të zhvillimit ekonomik lokal, synohet krijimi i politikave efektive në favor të zhvillimit ekonomik gjatë viteve në vijim, dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare e Komunës. Strategjia identifikon problemet të cilat janë shoqëruar ndër vite dhe parashtron nevojën e hartimit të politikave zhvillimore për financimin komunal, përqendrimin në projektet zhvillimore të koordinuara me prioritetet strategjike në nivel lokal:

- a. për investime në kompletimin e infrastrukturës rrugore dhe zgjerimin e rrjetit të transportit lokal,
- b. fuqizimin e kapitalit njerëzor dhe ndërlidhjen e fuqisë punëtore me tregun e punës si dhe forma të tjera të mbështetjes së bizneseve.

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së - Duhet theksuar se Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilitizimit Asociimit ndërmjet BE-së dhe Kosovës, i ka hapur rrugën reformave institucionale si dhe krijimit të një ekonomie funksionale të tregut. Ndër masat afatshkurtra të përcaktuara në këtë dokument politikash, ndër të tjera parashikohen:

- *sigurimi i përmirësimit të veprimtarisë së autoritetit vendor në përmbushjen e mandatit ligjor,*
- *sigurimi i zbatimit të ligjshmërisë me rastin e veprimtarisë normative,*
- *forcimi i transparencës komunale,*
- *zbatimi efikas i projekteve kapitale,*
- *nxitja e zhvillimit përmes programeve të bashkëpunimit ndërkomunal, ndërkufitar dhe transnacional,*
- *fuqizimi i kapaciteteve të administratës lokale, etj.*

Të gjitha këto janë në fokus të kësaj strategjie dhe adresojnë masat e duhura të veprimit në mënyrë që Komuna të ketë rolin e saj të rëndësishëm për një mjedis të favorshëm për zhvillimin e biznesit dhe për investime të reja.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) - është një dokument që shqyrtohet dhe miratohet çdo vit nga Kuvendi Komunal. Ky dokument ofron një analizë të detajuar të të hyrave dhe shpenzimeve komunale. Shpenzimet duhet dhe do të planifikohen për të reflektuar prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të Komunës. KABK ofron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e

identifikuara në dokumentet strategjike komunale mund të integrohen më mirë në procesin buxhetor. Strategjitë e veprimit në nivel lokal – Duke marrë parasysh specifikat dhe kapacitetet zhvillimore, komuna ka hartuar strategjitë për zhvillim ekonomik lokal që synon përpjekjet të cilat:

- a) përmirësojnë dhe rrisin cilësinë e jetës së qytetarëve përmes përbushjes së angazhimeve të saj periodike,
- b) duke ofruar mundësi të reja të operimit të biznesit,
- c) duke promovuar sektorin e prodhimit dhe veçanërisht atë të bujqësisë (që gjeneron punësim sezonal),
- d) kushte për qarkullim më të mirë të mallrave dhe njerëzve,
- e) përmirësim të standardit të jetesës,
- f) mbështetje për kategori të caktuara sociale dhe forma të tjera të mbështetjes për aktivitetet ekonomike dhe sociale.

5.1 Analiza e gjendjes aktuale dhe perspektiva e zhvillimit

Në horizontin strategjik në kuadër të kësaj strategjie parashikohen dy grupe kryesore të shtytësve të zhvillimit ekonomik të qytetit:

Zhvillimi i ekonomisë dhe ndërmarrësisë

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme do të jenë nxitësit kryesorë të zhvillimit ekonomik në horizontin e planifikimit strategjik. Kjo strategji thekson veçanërisht zhvillimin e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme në fushën e teknologjive të reja dhe zhvillimin e mikrondërmarrjeve në sektorët e aktiviteteve krijuese.

Fusha e prodhimit bujqësor “të zgjuar” dhe agroturizmit parashikohet gjithashtu si një nga shtytësit e zhvillimit ekonomik të qytetit. Qyteti do të inkurajojë edhe rrjetëzimin e prodhuesve bujqësorë me qëllim krijimin e ekonomive bujqësore konkurruese dhe të orientuara nga tregu, me synim tregun ndërkombëtar. Në këtë kuadër, qyteti me kapitalin e tij do të investojë në ndërtimin e infrastrukturës së përshtatshme, pra në projektet e zhvillimit të infrastrukturës bujqësore që do të aplikojnë për bashkë-financim nga Fondet e BE-së për zhvillimin rural.

Për stimulimin financiar të sipërmarrjes dhe përmirësimin e kulturës së sipërmarrjes dhe klimës sipërmarrëse, Komuna do të formojë një fond të posaçëm zhvillimi që do të financohet nga buxheti i qytetit, fondet e zhvillimit rajonal dhe rural të BE-së dhe burime të tjera financiare.

Zhvillimi i aktiviteteve arsimore, kulturore, rinore dhe turistike


Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve kulturore dhe arsimore janë planifikuar zhvillime dhe investime publiko-private (Qyteti dhe sipërmarrësit privatë).

Ndërtimi i infrastrukturës për tërheqjen e organizatave dhe institucioneve kërkimore vendase dhe ndërkombëtare nga fusha e arsimit në zonën e qytetit, është vendosur si një nga prioritetet strategjike të kësaj strategjie.

Krahas infrastrukturës arsimore, kjo strategji parashikon zhvillimin e infrastrukturës për aktivitete kulturore, krijuese dhe sportive, si shtytëse të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve cilësore të punës. Kjo strategji parashikon edhe zhvillimin e ofertave turistike.

5.2 Përzgjedhja e prioriteteve strategjike

Duke pasur parasysh sfidat e shumta me të cilat ballafaqohen komunat, është e domosdoshme t'i jepet përparësi atyre bazuar në urgjencën dhe pasojat e mundshme negative të mosveprimit.



- Papunësia e të rinjve (dhe migrimi) më e lartë se mesatarja
- Komunat dhe bizneset nuk janë të digjitalizuara dhe nuk eksportojnë shërbime digjitale shumë fitimprurëse që kërkojnë pak investime
- Mungesa e ekosistemit të biznesit dhe investimeve

Duke vazhduar me imperativin strategjik të rritjes dinamike ekonomike të qytetit, u identifikuan tri prioritete zhvillimore:

- “Qyteti i të Rinjve Digjital” – Tu jepet prioritet investimeve në iniciativat e zhvillimit të punësimit digjital të të rinjve që u mundësojnë të rinjve të fillojnë biznese në çdo fushë në më pak se një javë (përsheptuesi i vetëpunësimit AI). Të fuqizohen platformat digjitale të udhëzimit të karrierës që ndihmojnë të rinjtë të identifikojnë dhe të ndjekin karriera digjitale në Kosovë me potencial më të lartë fitimesh përmes distancës. Tu ofrohen të rinjve punë dhe partneritete që u japin sipërmarrësve të rinj qasje në qendrat e inovacionit të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si Techpark Prishtina etj..
- “Specializimi dhe digjitalizimi i zgjuar” – Prioritet strategjik për të ndërtuar një ekonomi digjitale duke u fokusuar në biznese shumë fitimprurëse që mund të eksportohen lehtësisht në mënyrë digjitale. Këto biznese, të tilla si IA, TI, zhvillues softueri, web dizajnues, marketingu digjital dhe tregtia elektronike, mund të ndihmojnë në rritjen e shpejtë të ekonomisë së vendit. Gjithashtu, qyteti duhet të investojë në ndërtimin e ekosistemeve të inovacionit, si katalizator, inkubatorët dhe hapësirat e bashkëpunimit, për ti inkurajuar këto biznese dhe për t'i ndihmuar ato të kenë sukses.
- “Qytete më të zgjuara të gjelbra dhe investime të qëndrueshme” Prioritet strategjik për të transformuar qytetin në një qytet të gjelbër të lidhur digjitalisht, por të qëndrueshëm, duke tërhequr investime të huaja për t'i transformuar strukturat urbane dhe komunale.

6. Ndërlidhja me dokumentet strategjike relevante

Strategjia dhe plani kombëtar për zhvillim (SKZH dhe PKZH 2030) është dokumenti kryesor strategjik i vendit në perspektivë afatgjatë. Duke qenë se është në krye të hierarkisë së dokumenteve strategjike, të gjitha dokumentet tjera të kësaj natyre, përfshirë edhe këtë program, duhet të jenë të ankoruara në të.

SKZH dhe PKZH 2030 organizohet në katër shtylla, të cilat janë: (I) Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik; (II) Zhvillimi i barabartë njerëzor; (III) Siguria dhe sundimi i ligjit; dhe (IV) Qeverisja e mirë. Shtylla e parë, siç tregon edhe emri, është ajo në të cilën kryesisht është bazuar Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030. Te kjo shtyllë, synohen të arrihen tri qëllime kryesore. Qëllimi i parë ka të bëjë me krijimin e një ekonomie digjitale, qarkore dhe konkurruese. Për ta arritur këtë qëllim, parashihet përmirësimi i mjedisit biznesor dhe transformimi i ekonomisë drejt aktiviteteve me vlerë të shtuar, me fokus në digjitalizim e inovacion. Qëllimi i dytë është që infrastruktura të jetë cilësore, e qëndrueshme dhe e integruar. Në këtë kuadër, parashihet që të përmirësohet infrastruktura dhe shërbimet e transportit, sidomos transportit hekurudhor; të ketë furnizim të qëndrueshëm dhe të përballueshëm me energji; dhe të avancohet infrastruktura e komunikimit, që është qenësore për digjitalizim. Qëllimi i fundit në këtë shtyllë, por jo më pak i rëndësishmi, është që mjedisi të jetë i pastër, pra të parandalohet ndotja e tokës, ujit dhe ajrit, dhe të mbrohet biodiversiteti në përgjithësi, ndërkohë që burimet natyrore të shfrytëzohen në mënyre efikase.

Shtylla e dytë, përkatësisht qëllimi i parë i kësaj shtylle – krijimi i një tregu gjithëpërfshirës të punës me punësim të lartë dhe të denjë, lidhet me fushëveprimin e Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030. Ky qëllim parashihet të arrihet përmes zhvillimit të shkathtësive dhe kompetencave, si dhe ngushtimit të hendekut në tregun e punës; rritjes së pjesëmarrjes së grave në tregun e punës; dhe përmirësimit të kushteve të punës.

Përpos shtyllave me qëllime dhe objektiva përkatëse, në SKZH dhe PKZH 2030, gjithashtu janë të përcaktuara agjendat horizontale, si çështjet apo fushat që kërkojnë koordinim midis shumë sektorëve. Agjenda digjitale, gjithëpërfshirja, agjenda e gjelbër, migrimi dhe diaspora përbëjnë agjendat horizontale të SKZH dhe PKZH 2030. Të gjitha këto janë dimensione shtesë, të cilat janë marrë parasysh në Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030.

Strategjia për vetëqeverisjen lokale (2016-2026) është dokument që përcakton kornizën strategjike bazë për avancimin e vetëqeverisjes lokale. Kjo strategji shërben si instrument kryesor për udhëzimin e zhvillimit të politikave, strategjive dhe planeve zhvillimore socio-ekonomike në nivel lokal, dhe njëkohësisht bën ndërlidhjen me kornizën strategjike të nivelit qendror të përcaktuar me dokumentet strategjike të asaj kohe. Objektivi i parë e kësaj strategjie, rritja e qëndrueshmërisë ekonomike dhe sociale të komunave, ka qenë më relevantja për nevojat e këtij programi. Për ta përmbushur objektivin në fjalë është paraparë që, mes tjerash, të bëhet ndryshimi i bazës ligjore për financimin e komunave; të përmirësohet infrastruktura e rrugëve lokale dhe rrjetit të transportit ndër-urban; të aftësohen të rinjtë dhe të përgatiten për treg të punës; të mbështeten bizneset; dhe të zhvillohet sektori i bujqësisë. Dy objektiva tjera të strategjisë, të cilat gjithashtu ndërlidhen me fushëveprimin e këtij programi, por në formë më të përgjithshme, janë: (a) forcimi i kapaciteteve profesionale dhe institucionale të komunave dhe (b) forcimi i partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve. Në të parën nga këto dy objektiva parashihet krijimi i një sistemi të avancuar për edukim të vazhdueshëm profesional për zyrtarët komunalë, ndryshimi i sjelljes së punëtorëve përmes vlerësimit të performancës, zhvillimi i kapaciteteve lokale për monitorim të punëve që dalin nga partneriteti me bizneset dhe masa të tjera të ngjashme. Ndërkaq, për ta përmbushur objektivin tjetër, si masa që lidhen me programin janë iniciimi i programeve të praktikës për nxënësit e shkollave të mesme dhe bashkëpunimi për të mbështetur ndërmarrësit e rinj.

Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030 është dokumenti strategjik, që përcakton rrugën për zhvillim ekonomik lokal të komunave. Fushëveprimi i këtij dokumenti, ndonëse vetëm te pjesa e analizës, shkon përtej kuptimit tipik të konceptit të zhvillimit ekonomik, duke trajtuar edhe fusha tjera (si p.sh. shëndetësinë), që vetëm tërthorazi lidhen me temën. Kjo strategji përmban pesë objektiva strategjike: rritja e qëndrueshmërisë financiare të komunave; tërheqja e investimeve të huaja; fuqizimi

i ekonomisë lokale përmes investimit në kapitalin njerëzor; shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Për ta përmbushur rritjen e qëndrueshmërisë financiare, është paraparë që të zvogëlohet varësia buxhetore e komunave nga niveli qendror, krijimi i mekanizmit të veçantë për koordinimin e procesit të financimit të investimeve nga niveli qendror në nivelin lokal dhe krijimi i mundësisë për huamarrje. Të gjitha këto, përkundër faktit që janë shumë të rëndësishme për qëndrueshmërinë e financave lokale, realizimi i tyre më shumë lidhet me kompetencat e nivelit qendror. Sidoqoftë, raporti i fundit monitorues për zbatimin e kësaj strategjie tregon se janë bërë përpjekje të vazhdueshme për ta përmirësuar qëndrueshmërinë e komunave dhe politikat që nxisin zhvillimin e mëtejshëm. Sipas këtij raporti, deri në të 2022-ën, 38.5% e aktiviteteve që ndërlidhen me qëndrueshmërinë financiare janë zbatuar plotësisht, ndërsa 38.5% të tjera janë zbatuar vetëm pjesërisht.

Objektivi strategjik për tërheqje të investimeve të huaja është paraparë të arrihet duke krijuar kushte të favorshme për investitorët, duke funksionalizuar plotësisht zonat e lira ekonomike dhe duke rritur transparencën për investime të huaja. Tërheqja e investimeve është gjithashtu objektivi i SKZH-së dhe PKZH-së, ndonëse në atë rast, investimet nuk reduktohet vetëm në investime të huaja direkte, por trajtohen pa dallim me investimet vendore. Në këtë rast, janë përmbushur më shumë aktivitete krahasuar me objektivin e qëndrueshmërisë financiare. Konkretisht, 43% e aktiviteteve janë përmbushur plotësisht, ndërsa 42.8 pjesërisht.

Fuqizimi i ekonomisë lokale përmes kapitalit njerëzor është paraparë të arrihet duke e zhvilluar arsimin profesional. Ky është një aspekt i rëndësishëm për adresimin e mungesës së shkathtësive të duhura në tregun e punës. Fokusi është vendosur tek ky dimension i adresimit të çështjes, duke qenë se komunat kanë më shumë kompetenca në këtë drejtim. Kjo vërehet edhe në raportin e fundit të monitorimit, ku 53.4% e aktiviteteve janë zbatuar plotësisht dhe 32.2% pjesërisht.

Shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit ekonomik, si objektivi strategjik, është paraparë të arrihet përmes përmirësimit të kushteve për zhvillim të turizmit, krijimit të bazës ligjore për subvencionim të kamatave dhe përmirësimit të infrastrukturës në funksion të bizneseve. Edhe pse të gjitha objektivat specifike janë të rëndësishme, ato nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejt me objektivin strategjik. Për më shumë, aktivitetet e planifikuara janë zbatuar më së paku krahasuar me aktivitetet e objektivave tjera. Më saktësisht, vetëm 34.4% e aktiviteteve janë zbatuar plotësisht. Ndërsa, shumica (55.4%) janë zbatuar pjesërisht.

Duke marrë parasysh orientimet strategjike zhvillimore, komuna e Ferizaj do të bëjë përpjekje që përmes zhvillimit ekonomik lokal të përmirësojnë dhe rrisi cilësinë e jetës së qytetarëve duke krijuar mundësi të reja për mirëqenie ekonomike dhe sociale. Kjo strategji trajton aspekte të zhvillimit ekonomik vendor që janë të orientuara drejt partneritetit me të gjithë akterët, duke synuar rritjen e punësimit, uljen e varfërisë dhe rritjen e cilësisë së jetesës. Zhvillimi ekonomik mund të arrihet vetëm kur komuna të tregojë qeverisje të mirë dhe të ofrojë shërbimet e nevojshme për publikun përmes përmirësimit dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale në fushën e ekonomisë. Për arritjen e këtyre synimeve, komuna duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës lokale, krijimit të kushteve të përshtatshme zhvillimi, promovimit të bizneseve të vogla dhe të mesme vendore, zhvillimit të sektorit bujqësor, promovimit të turizmit dhe të trashëgimisë kulturore si dhe krijimin e vendeve të reja të punës përmes investimeve të reja nga investitor vendor dhe të huaj.

Strategjia është e nderlidhur me një sërë dokumentesh strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si:

- Strategjia për Vetëqeverisjen Lokale 2016-2026 (SVL);
- Strategjia dhe Plani Kombëtar Për Zhvillim 2030;
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2016, e të tjera.

Zhvillimi ekonomik i një vendi kërkon një sistem në të cilin të drejtat e pronës respektohen plotësisht, dhe ku prona është komerciale ose e tregtueshme. Sot, Komuna e Ferizaj, po përballet me sfida mbi të drejtat e pronësisë për arsye të zhvillimit të ulët të tregut të pronave që ndikon negativisht në shumë

sektorë të ekonomisë dhe të biznesit, përfshirë bujqësinë, dhe ku duhet të inkurajohet konsolidimi i tokës dhe ekonomitë përkatëse të shkallës për të rritur konkurrencën. Të drejtat pronësore të pagzjidhura janë gjithashtu thelbësore për aksesin në financa, pasi pronat mund të përdoren për kolateral.

7. OBJEKTIVAT

7.1 ZHVILLIMI I ARSIMIT

“Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë”

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) përcakton kornizën e bashkëpunimit të Kosovës me BE-në, për të rritur cilësinë e arsimit në të gjitha nivelet, duke synuar përmirësimin e aftësive, punësimit, përfshirjes sociale dhe promovimit të zhvillimit ekonomik. MSA i kushton vëmendje të veçantë bashkëpunimit për arritjen e përfshirjes dhe barazisë në arsim, me theks të veçantë në: gjininë, përkatësinë etnike dhe fetare, si dhe personat me aftësi të veçanta. Pritet që bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe Kosovës të marrë formën e asistencës teknike për zbatimin e masave të caktuara të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (SPEK). Sistemi arsimor duhet t’u përshtatet kërkesave të tregut vendor dhe evropian të punës, duke u fokusuar në rritjen e cilësisë në mënyrë që të diplomuarit të përmbushin standardet e punëdhënësit.

Synimi ynë është arsimimi për të gjithë, për të eliminuar pabarazinë gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm në të gjitha nivelet e arsimit. Prandaj dhe do të adresojmë nevojën për të integruar zhvillimin e qëndrueshëm në arsimin formal në të gjitha nivelet, si dhe përmes mundësive të arsimit joformal duke marrë parasysh që ka një njohje ndërkombëtare në rritje të Arsimit për Zhvillim të Qëndrueshëm si një element integral i arsimit cilësor dhe një mundësi kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm.

Arsimi gjithëpërfshirës është një dimension tjetër i arsimit cilësor bazuar në të drejtat që thekson barazi në qasje dhe pjesëmarrje, dhe i përgjigjet pozitivisht nevojave individuale për nxënje dhe kompetencave të të gjithë fëmijëve.

Arsimi gjithëpërfshirës ka në qendër fëmijun dhe vendos përgjegjësinë e adaptimit të sistemit arsimor në bazë të nevojave të fëmijut. Së bashku me sektorë të tjerë dhe me komunitet më të gjerë, arsimi gjithëpërfshirës funksionon në mënyrë aktive për t’i siguruar çdo fëmijë, pavarësisht gjinisë, gjuhës, aftësisë, fesë, kombësisë ose karakteristikave të tjera, mbështetje për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplotë, të mësojë së bashku me shokët dhe shoqet e tij/saj, si dhe të zhvillojë potencialin e tij/saj të plotë. Arsimi gjithëpërfshirës keqkuptohet si koncept që aplikohet vetëm tek fëmijët me nevoja të veçanta, dhe ky fakt pikërisht na vendos pengesa në arritjen e arsimit gjithëpërfshirës.

Tabela 8. Numri i fëmijëve në kopshte

Grupmosha	Numri i grupeve	Gjithsej		
		M	F	Gj
06 muaj – 2 vjeç	3	15	22	37
1 vjeç – 2 vjeç	2	11	13	24
2 vjeç – 3 vjeç	4	37	44	81
3 vjeç – 4 vjeç	5	50	62	112
4 vjeç – 5 vjeç	4	47	49	96
5 vjeç – 6 vjeç	4	59	58	117
Gjithsej	24	219	248	467

Në një kohë kur papunësia në vend është shumë e lartë, paradoksi është se shumë ndërmarrje kanë probleme në gjetjen e kornizës së deficitit. Një nga arsyt kryesore qëndron në sistemin arsimor, përkatësisht në përfshirjen e ulët të fëmijëve në programet parashkollore (25-30% e fëmijëve janë të përfshirë dhe dallimet janë të mëdha nga zonat urbane në ato rurale) si dhe në cilësinë e mësimdhënies.

Parafillorët	Numri i paraleleve	Gjithsej numri i fëmijëve		
		M	F	Gj
5 – 6 vjeç	76	738	733	1471

Një problem tjetër është mungesa e përputhshmërisë së aftësive dhe aftësive të fituara me kërkesat e tregut të punës, pasi nuk ka lidhje trekëndore mes shkollave, bizneseve dhe komuniteteve. Komuna duhet të fokusohen në përmirësimin e kushteve për zhvillimin e arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm, rregullimin e infrastrukturës së nevojshme shkollore, hapjen e shkollave profesionale, përmirësimin e cilësisë në arsim, monitorimin e procesit arsimor, përzgjedhjen meritorë të stafit arsimor dhe menaxherial, si dhe përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve të vazhdueshme të stafit arsimor. Gjithashtu, fokusi i Komunës duhet të orientohet në “trajnimin e të rinjve si fuqi punëtore, përmes formave të edukimit alternativ, hapjes së qendrave rinore inovative, programeve të trajnimit dhe inovacionit, qendrave të karrierës.

Tabela 10. Numri i nxënësve sipas largësisë së udhëtimit në shkollë	
Largësia (km)	Numri i nxënësve
1-2 km	7138
2-5 km	6016
6 -10 km	4118
10-15 km	2725
Mbi 15 km	352
Gjithsej	20349

Tabela 8. Numri i fëmijëve në kopshte

Infrastruktura e shkollave	
Ujë	Të gjitha shkollat kanë furnizim me ujë të pijshëm
Ngrohje	Të gjitha shkollat e kanë të instaluar ngrohjen qendrore, përveç një paralele e ndarë fizike e cila është në projekt këtë vit.
Qasja në kanalizim	Të gjitha shkollat kanë qasje në kanalizim.
Gjendja e objektit	Jo të gjitha shkollat janë në një gjendje të mirë teknike. Janë 2 objekte shkollore ku mësojnë nxënësit e shkollave të mesme të larta, si dhe 9 objekte tjera ku mësojnë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta, gjendja e të cilave nuk është e mirë.
Gjenda e inventarit	Mbi gjysma e shkollave kanë nevojë për inventar të ri. Kërkesat e tyre bazohen kryesisht në furnizim me banka dhe karriga.
Numri i klasave	413 klasa .
Kabinetet	16 shkolla kanë kabinete shkencore.
Salla të kulturës fizike	10 shkolla.
Biblioteka	22 shkolla kanë bibliotekë
Sistemi i sigurisë	Të gjitha shkollat janë të pajisura me kamera të sigurisë. Të gjitha shkollat e qytetit kanë sigurimin fizik.
Rrethoja	Të gjitha objektet shkollore kanë rrethojë metalike.

UNESCO nisi Dekadën e Kombeve të Bashkuara të Arsimit për Zhvillim të Qëndrueshëm, e cila ripohoi rolin kyç të arsimit në formësimin e vlerave që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm dhe në konsolidimin e shoqërive të qëndrueshme. Në këtë aspekt edhe komuna e Ferizajt strategjitë zhvillimore të arsimit do t'i përshtati me objektivat globale me rëndësi të vecantë në targetet si:

Targeti 4.1 i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Arsimi fillor dhe i mesëm falas. Strategjia zhvillimore e komunës duhet të sigurojmë që të gjitha vajzat dhe djemtë të përfundojnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, të barabartë dhe cilësor, duke arritur rezultate mësimore përkatëse dhe efektive.

Targeti 4.2 i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Qasje e barabartë në arsim cilësor para fillor. Do sigurojmë që të gjitha vajzat dhe djemtë të kenë akses në zhvillimin cilësor të fëmijërisë së hershme, kujdesin dhe arsimin para fillor, në mënyrë që të jenë gati për arsimin fillor.

Targeti 4.4 i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Rritja e numrit të njerëzve me aftësi përkatëse për sukses financiar. Nëpërmjet këtij targeti synojmë të rrisim ndjeshëm numrin e të rinjve dhe të rriturve që kanë aftësi përkatëse, duke përfshirë aftësitë teknike dhe profesionale, për punësim, punë të denjë dhe sipërmarrje me aftësi të veçanta në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Do synojmë mbështetjen e të rinjve dhe të rriturve me aftësi të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, sipas llojit të aftësive. Këtu do të matet përqindja e të rinjve dhe të rriturve (mosha 15-24 vjeç) me aftësi në krijimin e prezantimeve elektronike me softuer prezantimi etj.

Targeti 4. i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Eliminimi i çdo diskriminimi në arsim. Synojmë të eliminojmë pabarazitë gjinore në arsim dhe sigurojmë qasje të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe formimit profesional për shtresat vulnerabël, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, dhe fëmijët në situata të cënueshme.

Targeti 4.7 i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe qytetari globale. Strategjia synon të sigurojmë që të gjithë nxënësit të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë, ndër të tjera, nëpërmjet edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe stileve të qëndrueshme të jetesës, të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, promovimit të një kulture paqeje dhe jo-dhuna, qytetaria globale dhe vlerësimi i diversitetit kulturor dhe i kontributit të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm.

Targeti 4.A i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Ndërtimi dhe përmirësimi i shkollave gjithëpërfshirëse dhe të sigurta. Ndërtoni dhe përmirësoni objektet arsimore që janë të ndjeshme ndaj fëmijëve, aftësisë së kufizuar dhe gjinisë dhe ofrojnë mjedise të sigurta, jo të dhunshme, përfshirëse dhe efektive për të gjithë. Të gjitha shkollat të kenë pjerrtësinë dhe ashensorin për çasje të sigurt për nxënësit me nevoja të veçanta.

Targeti 4.B i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Zgjerimi i bursave të arsimit të lartë për maturantët me rezultate të larta duke synuar të zgjerohet ndjeshëm ofrimin e bursave të disponueshme, për regjistrim në arsimin e lartë, duke përfshirë regjistrim në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, tekniko-inxhinierinë, biznes dhe ekonomi si dhe në programe shkencore dhe sociale. Rritja e fondit për bursa jo vetëm për student të rregullt bachelor, por edhe për studentët master dhe kandidatët për doktoraturë.

Targeti 4.C i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Nëpërmjet këtij targeti synojmë që deri në 2030 të rritet ndjeshëm oferta e mësuesve të kualifikuar, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar për trajnimin e mësuesve dhe rekrutime të reja.

Objektivat Specifike të Zhvillimit të Arsimit

7.1.1 Objektivi Specifik: Sigurimi i cilësisë dhe infrastruktura fizike

Sigurimi i cilësisë në shkollë lidhet me vendosjen e mekanizmave efektivë për sigurim të cilësisë, funksionimin e departamenteve/aktiveve profesionale, koordinimin e aktiviteteve që lidhen me cilësinë, mbështetjen nga komuna, vlerësimin e brendshëm të shkollës dhe planifikimin zhvillimor, monitorimin e mësimdhënësve dhe vlerësimin e performancës së tyre. Objektivi dhe masat për sigurimin e cilësisë së arsimit në shkollat e komunës së Ferizajt janë në harmoni me masat e PSAK-ut 2017-2021, përkatësisht me objektivin strategjik 3: Sigurimi i cilësisë, si dhe objektivat dhe masat e Strategjisë për Sigurimin e Cilësisë 2016-2020.

Hapësirat e mjaftueshme shkollore dhe funksionale, bëjnë që nxënësit dhe personeli arsimor të ndërveprojnë në mënyrë aktive në zhvillimin e procesit mësimor. Për të arritur këtë, komuna e Mitrovicës është përcaktuar në arritjen e këtij objektivi duke vendosur masa dhe aktivitete, që në fokus kanë përmirësimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor në të gjitha shkollat e komunës, sigurinë në shkollë, menaxhimin dhe mirëmbajtjen adekuate të hapësirave e objekteve shkollore, etj.

Aktivitetet:

- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm dhe qytetari globale. Strategjia synon të sigurojmë që të gjithë nxënësit të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, duke përfshirë, ndër të tjera, nëpërmjet edukimit për zhvillim të qëndrueshëm dhe stileve të qëndrueshme të jetesës, të drejtave të njeriut, barazisë gjinore, promovimit të një kulture paqeje dhe jo-dhuna, qytetaria globale dhe vlerësimi i diversitetit kulturor dhe i kontributit të kulturës në zhvillimin e qëndrueshëm.
- Qasje e barabartë në arsim cilësor parafillor. Do sigurojmë që të gjitha vajzat dhe djemtë të kenë akses në zhvillimin cilësor të fëmijërisë së hershme, kujdesin dhe arsimin parafillor, në mënyrë që të jenë gati për arsimin fillor.
- Eliminimi i çdo diskriminimi në arsim. Synojmë të eliminojmë pabarazitë gjinore në arsim dhe sigurojmë akses të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit dhe formimit profesional për shtresat vulnerabël, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe fëmijët në situata të cënueshme.
- Nëpërmjet këtij targeti synojmë që deri në 2030 të rritet ndjeshëm oferta e mësuesve të kualifikuar, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar për trajnimin e mësuesve dhe rekrutime të reja.
- Krijimi i mundësive të aftësimi profesional të nxënësve me partneritete publike-private me ambiente moderne, aty ku i përgjigjen kërkesave të nevojshme të profileve të caktuara mësimore, për shembull : profile në sektorët shëndetësorë, ekonomik, bujqësor dhe teknik.
- Hapja e profilit arsimor për mbrojtje të mjedisit ose ekologji.
- Ndërtimi dhe përmirësimi i shkollave gjithëpërfshirëse dhe të sigurta. Ndërtoni dhe përmirësoni objektet arsimore që janë të ndjeshme ndaj fëmijëve, aftësisë së kufizuar dhe gjinisë dhe ofrojnë mjedis të sigurta, jo të dhunshme, përfshirëse dhe efektive për të gjithë. Të gjitha shkollat të kenë pjerërtësinë dhe ashensorin për çasje të sigurt për nxënësit me nevoja të veçanta.
- Ndërtimi dhe përmirësimi i shkollave gjithëpërfshirëse dhe të sigurta
- Sigurimi i transportit për të gjithë fëmijët në zona rurale që udhëtojnë këmbë në shkollë.

7.1.2 Objektivi Specifik: TIK-u dhe mjetet e konkretizimit

Përdorimi i TIK-ut ndërlidhet me pajisjen e shkollave me kompjuterë, qasja në internet, shfrytëzimin e burimeve online, sigurimin e mbështetjes teknike dhe mirëmbajtja e pajisjeve dhe përgatitjen e mësimdhënësve për shfrytëzimin e TIK. Këto aspekte adresohen në masat e vendosura për arritjen e këtij objekti strategjik. Objektivi ndërlidhet me objektivin për zbatim të kurrikulës së re, Planin Strategjik për Arsim 2017-2021 dhe me prioritetet e komunës së Ferizajt për të siguruar përdorim të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve.

Aktivitetet:

- Rritja e numrit të njerëzve me aftësi përkatëse për sukses financiar. Nëpërmjet këtij targeti synojmë të rrisim ndjeshëm numrin e të rinjve dhe të rriturve që kanë aftësi përkatëse, duke përfshirë aftësitë teknike dhe profesionale, për punësim, punë të denjë dhe sipërmarrje me aftësi të veçanta në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Do synojmë mbështetjen e të rinjve dhe të rriturve me aftësi të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, sipas llojit të aftësive. Këtu do të matet përqindja e të rinjve dhe të rriturve (mosha 15-24 vjeç) me aftësi në krijimin e prezantimeve elektronike me softuer prezantimi etj.
- Zgjerimi i bursave të arsimit të lartë për maturantët me rezultate të larta duke synuar të zgjerohet ndjeshëm ofrimin e bursave të disponueshme, për regjistrim në arsimin e lartë, duke përfshirë regjistrim në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, tekniko-inxhinierinë, biznes dhe ekonomi si dhe në programe shkencore dhe sociale.
- Rritja e fondit për bursa jo vetëm për student të rregullt bachelor, por edhe për studentët master dhe kandidatët për doktoraturë.

Infrastruktura e nevojshme në DA

Përgatitja teknike e lokaleve shkollore gëlqerosja, dezinfektimi, vendosja e xhamave të dëmtuar, riparimi i inventarit ekzistues dhe pajisja me inventar të ri;

Kontrollimi i sistemit të ngrohjeve nëpër shkolla;

Riparimi i nyjeve të ujësllësve dhe përmirësimi i furnizimit të shkollave të cilat kanë probleme me ujë të pijshëm;

Furnizimi i shkollave me mjete mësimore didaktike në salla të kabinetëve;

Mirëmbajtja (rregullimi) i shkollave dhe oborreve shkollore;

Mirëmbajtja (rregullimi) i terreneve sportive;

Furnizimi i shkollave me material për administratën e shkollave;

Furnizimi i shkollave me karburante për gjeneratorët;

Rregullimi i dokumentacionit për pronat e shkollave sipas sipërfaqes kadastrale;

Sigurimi i një ambienti të shëndetshëm për shkollën dhe rregullimi i këndeve të gjelbërta shkollore;

Përmirësimi i infrastrukturës, transportit dhe sigurisë në shkolla.

7.2 ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS

Qytet gjithëpërfshirës, i sigurtë, elastik dhe i qëndrueshëm

Zhvillimi i infrastrukturës lokale, përpos ndikimit në përmirësim të jetës së qytetarëve, luan një rol qenësor edhe në rritje ekonomike, duke e krijuar një mjedis më të lehtë për operim të ndërmarrjeve dhe akterëve tjerë të tregut. Përgjatë viteve, komunat kanë shpenzuar një pjesë të konsiderueshme të buxhetit të tyre për të investuar në projekte infrastrukturore. Si rezultat, janë shënuar përmirësime të dukshme në këtë fushë. Përkundër progresit, infrastruktura e transportit përgjithësisht mbetet e pakompletuar dhe shërbimet nuk janë në nivel optimal. Për më tepër, ekzistojnë sfida në lidhje me infrastrukturën përcjellëse, si për shembull në lidhje me rrjetin e kanalizimit. Menaxhimi i integruar i mbeturinave është i dobët dhe investimet në efikasitet janë të mangëta. Për ta përmirësuar infrastrukturën lokale, PNZHEL 2030 synon që ta përmirësojë infrastrukturën për transport lokal dhe shërbime, të sigurojë qasje në infrastrukturën përcjellëse, të menaxhojë mbeturinat në mënyrë të integruar dhe të përmirësojë efikasitetin e energjisë.

Ky objektivi lidhet drejtpërdrejt me Qëllimin II të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon të krijojë infrastrukturë cilësore, të integruar dhe të qëndrueshme. Gjithashtu, lidhet me Strategjinë për transportin multimodal, Strategjinë për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, Strategjinë e energjisë, Strategjinë për menaxhimin e integruar të mbeturinave.

Synojmë që qyteti jonë Ferizaj të jetë një qendër e ideve, tregtisë, kulturës, shkencës, produktivitetit, zhvillimit social, njerëzor dhe ekonomik. Prandaj, planifikimi urban, sistemet e transportit, uji, kanalizimi, menaxhimi i mbetjeve, reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë, aksesimi në informacion, arsimi dhe ngritja e kapaciteteve janë të gjitha çështje të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm urban të komunës tonë.

Duke marrë parasysh që deri në vitin 2050, pritet që dy të tretat e popullsisë botërore të jetojnë në zonat urbane, vlerësohet se zonat urbane do të përbëjnë mbi 70 për qind të prodhimit të brendshëm bruto botëror dhe për këtë arsye qendrat urbane kanë gjeneruar dhe gjenerojnë një rritje ekonomike dhe prosperitet për shumë njerëz.

Rezultatet nga kjo lëvizje kërkojnë që “t’i bëjnë qytetet dhe vendbanimet, njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme”. Agjenda e Re Urbane, synon të ofrojë udhëzime kombëtare dhe lokale për rritjen dhe zhvillimin e qyteteve deri në vitin 2036.

Zhvillimi i qëndrueshëm duhet të “Promovojë zhvillimin e qëndrueshëm të vendbanimeve njerëzore” i cili kërkon:

- 1) *sigurimin e strehimit të përshtatshëm për të gjithë,*
- 2) *përmirësimi i menaxhimit të vendbanimeve njerëzore,*
- 3) *promovimi i planifikimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të përdorimit të tokës,*
- 4) *promovimi i ofrit të integruar të infrastrukturës mjedisore: menaxhimi i ujit, kanalizimeve, kullimit dhe mbeturinave të ngurta*
- 5) *promovimi i sistemeve të qëndrueshme të energjisë dhe transportit në vendbanimet njerëzore,*
- 6) *promovimi i planifikimit dhe menaxhimit të vendbanimeve njerëzore në zonat e rrezikuara nga fatkeqësitë*
- 7) *promovimi i aktiviteteve të qëndrueshme të industrisë së ndërtimit, dhe*
- 8) *promovimi i zhvillimit të burimeve njerëzore dhe ngritjes së kapaciteteve për zhvillimin e vendbanimeve njerëzore.*

Arritja e këtyre politikave synon përfshirjen grupeve kryesore dhe palëve të tjera të interesuara, përfshirë autoritetet lokale, për të kontribuar në zbatimin nëpërmjet mobilizimit të një game më të gjerë palësh të interesuara për lehtësimin e proceseve “nga poshtë-lartë” dhe gjithëpërfshirës si dhe formimin e partneritete me shumë palë të interesuara në arritjen e qëndrueshmërisë.

7.2.1 Objektivi Specifik: Zhvillimi i transportit të qëndrueshëm

Roli i transportit në zhvillimin e qëndrueshëm u njoh për herë të parë si një sektor dinamik në Samitin e Kombeve të Bashkuara që vuri në dukje më tej se, gjatë njëzet viteve të ardhshme, transporti do të pritet të jetë forca kryesore lëvizëse pas një kërkesë në rritje botërore për energji. Më tej, u theksua rëndësia e tij mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm, në kontekstin e infrastrukturës, sistemeve të transportit publik, rrjeteve të shpërndarjes së mallrave, përballueshmërisë, efikasitetit dhe komoditetit të transportit, si dhe përmirësimin e cilësisë dhe shëndetit të ajrit urban dhe reduktimin e emetimeve të gazeve serrë.

Transporti i qëndrueshëm arrin një integrim më të mirë të ekonomisë duke respektuar mjedisin, përmirësimin e barazisë sociale, shëndetit, qëndrueshmërisë së qyteteve, lidhjeve urbane-rurale dhe produktivitetit të zonave rurale.

Si pjesë e strategjisë sonë të veprimit pesë-vjeçar, e identifikoi transportin si një komponent kryesor të zhvillimit të qëndrueshëm prandaj dhe do të zhvillojmë të gjitha llojet e transportit, duke përfshirë ofruesit e transportit publik rrugor, hekurudhor dhe urban.

Përmirësimi infrastrukturës së transportit lokal dhe shërbimeve

Infrastruktura dhe shërbimet e transportit janë esenciale për lëvizje të mallrave dhe njerëzve në ekonomi. Investimet në infrastrukturë të transportit stimulojnë ekonominë lokale duke reduktuar kostot e lëvizjes për bizneset dhe qytetarët, si dhe përgjithësisht duke përmirësuar pjesëmarrjen e tyre në treg. Për arritjen e këtij objekti, duhet të vazhdojë ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruktimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale.

Paralel me këtë, duhet të përmirësohet infrastruktura sinjalistike në komunikacion dhe të krijohen hapësira të reja të parkingut. Njëkohësisht, është e nevojshme që të investohet në zhvillim të transportit alternativ dhe miqësor për mjedisin. Shërbimet e stacioneve të autobusëve duhet të digjitalizohen dhe të organizohet transport publik lokal në komuna më të mëdha.

Ky objektivi specifik lidhet me tri objektiva të SKZH-së dhe PKZH-së: Objektivin 2.3, që synon përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit; Objektivin 2.5, që synon rritjen e sigurisë së transportit; dhe Objektivin 3.6, që ka për qëllim promovimin e mobilitetit digjital dhe të qëndrueshëm. Gjithashtu nderlidhet edhe objektivat globale të zhvillimit të qëndrueshëm dhe konkretisht duke u referuar targeteve me të rëndësishme mbi të cilat do të bazohet strategjia e Komunes së Ferizaj si me poshtë:

Targeti 11.2 i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Sisteme transporti të përballueshme dhe të qëndrueshme të aksesueshme për të gjithë, duke përmirësuar sigurinë rrugore, veçanërisht duke zgjeruar transportin publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të atyre në situata vulnerabël për gratë, fëmijët, personat me aftësi të veçanta dhe personat e moshuar.

Targeti 11.6 i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Ulja e ndikimeve negative mjedisore të qytetit, duke përfshirë dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë cilësisë së ajrit dhe menaxhimit të mbetjeve komunale dhe të tjera nëpërmjet investimeve adekuate për këtë synim.

Targeti 11.7 i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Sigurimi i aksesit në hapësirat e gjelbra dhe publike të sigurta dhe gjithëpërfshirëse, të aksesueshme, të gjelbra dhe publike, veçanërisht për gratë dhe fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

Targeti 11.C i objektivave globale të zhvillimit të qëndrueshëm: Zhvillimin e ndërtimit të qëndrueshëm dhe elastik. Rritjen e ndihmës financiare dhe teknike, në ndërtimin e ndërtesave të qëndrueshme dhe elastike duke përdorur materiale vendase.

Krijimi i mjedisit për zhvillim të sigurt, cilësor dhe funksional të sistemeve të infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore për ofrimin e shërbimeve cilësore, ndikon në mjedisin e pastër ekologjik dhe rritjen ekonomike. Komuna duhet të jetë dhe është e përkushtuar për krijimin e një sistemi transporti plotë-

sisht të integruar për të gjithë qytetarët, i cili do t'u mundësojë atyre të zgjedhin transportin më efikas dhe me kosto efektive që plotëson nevojat e tyre, i cili garanton ruajtjen e mjedisit.

Komuna është gjithashtu përgjegjëse për mirëmbajtjen, organizimin, funksionimin dhe zhvillimin e rrjetit të saj rrugor.

“Investimet në infrastrukturë” – transport, ujë, energji dhe teknologji informacioni dhe komunikimi – janë thelbësore për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm dhe fuqizimin e komuniteteve në shumë vende. Prej kohësh është pranuar se rritja e produktivitetit dhe e të ardhurave, si dhe përmirësimet në rezultatet e shëndetësisë dhe arsimit kërkojnë investime në infrastrukturë. Prandaj edhe Komuna e Ferizaj duke marrë parasysh rëndësinë e të lartepërmendurave synon që nepermjet strategjise zhvillimore, deri në vitin 2030 të zhvillojë infrastrukturën sipas udhëzuesve kryesorë të objektivave të zhvillimi të qëndrueshëm duke u fokusuar si më poshtë:

Zhvillimi i infrastrukturës së qëndrueshme, elastike dhe gjithëpërfshirëse, cilësore, të besueshme, të qëndrueshme, duke përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien njerëzore, me fokus në aksesin e përballueshëm dhe të barabartë për të gjithë duke përfshirë aksesin në rrugë për popullsinë rurale.

Sigurimi i aksesit universal në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit duke rritur ndjeshëm aksesin në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit me sigurimin e aksesit universal dhe të përballueshëm në shërbimet e internet-it për të mbështetur reformën e digjitalizimit.

Tabela 12: Shpejtësia mesatare e internetit

Qytetet me 100.000 ose më shumë banorë në BE	Qytetet me 100.000 ose më shumë banorë global	Qytetet me 100.000 ose më shumë banorë në Kosovë.
Median fixed internet connection speed: 64 Mbps	Median fixed internet connection speed: 58 Mbps	Median fixed internet connection speed: 44 Mbps
Median mobile internet connection speed via cellular networks: 54 Mbps.	Median mobile internet connection speed via cellular networks: 34 Mbps.	Median mobile internet connection speed via cellular networks: 27 Mbps.

Burimi: Digital world report 2022

Shpejtësia e lidhjes së internetit në Kosovë në vitin 2022 tregojnë se përdoruesit e internetit në Kosovë kanë pritur shpejtësitë e mësipërme të lidhjes së internetit të cilat faktojnë se qëndrojnë larg mesatareve globale dhe të bashkimit evropian në të cilin Kosova synon të anëtaresohet. Bazuar në këtë tabelë na faktohet rëndësia e investimit në krijimin e infrastrukturës digjitale e cila do të sigurojë shërbimet e nevojshme të internetit si infrastrukturë bazë për zhvillimin gjithëpërfshirës sektorial.

Aktivitetet:

- Sisteme transporti të përballueshme dhe të qëndrueshme, të qasshem për të gjithë, duke përmirësuar sigurinë rrugore, veçanërisht duke zgjeruar transportin publik, me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të atyre në situata vulnerabël për gratë, fëmijët, personat me aftësi të veçanta dhe personat e moshuar.
- Ndërtimi, mirëmbajtja, rekonstruktimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale
- Përmirësimi i infrastrukturës sinjalistike në komunikacion
- Krijimi i hapësirave të reja të parkingut publik
- Digjitalizimi i shërbimeve në stacionet e autobusëve
- Përkrahja e investimeve në transport alternativ
- Organizimi i transportit publik lokal në komunë (aty ku mungon)

7.2.2 Objektivi Specifik: Menaxhimi i integruar i mbeturinave

Menaxhimi i mbeturinave kërkon një qasje të integruar, e cila mundëson reduktimin e tyre, përmirësimin e mbledhjes, riciklimin dhe deponimin e duhur të mbetjeve të gjenerura nga qytetarët, institucionet, bizneset dhe industria. Menaxhimi i integruar i mbeturinave kontribuon drejt një ekonomie qarkore që sjell përfitime ekonomike, duke mbrojtur ambientin dhe shoqërinë. Investimet infrastrukturore që kërkojnë për të themeluar një sistem funksional për menaxhim të integruar të mbeturinave janë të larta. Kjo paraqet një mundësi për bashkëpunim ndër-komunal në përpunime me ekonominë e shkallës. Për t'u arritur kjo objektivi specifik, do të ketë përkrahje nga niveli qendror për ngritjen e kapaciteteve për menaxhim dhe operim të duhur të ndërmarrjeve publike rajonale për menaxhim të mbeturinave. Për të siguruar një planifikim të mirëfillt të sistemit që i përmbush nevojat e komunave dhe është në përpunime me parimet e ekonomisë qarkore duhet të hartohen planet ndërkomunale për menaxhim të integruar të mbeturinave. Si pjesë e këtyre planeve dhe në përpunime me Strategjinë për menaxhim të integruar të mbeturinave, duhet të zhvillohet infrastruktura e ndarjes dhe grumbullimit të mbeturinave, rrjetet e stacioneve të transferimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave përmes iniciativave dhe bashkëpunimit ndërkomunale. Në këtë drejtim, është e nevojshme që të krijohen qendra të riciklimit dhe kompozimit të mbeturinave, si dhe paralel me këtë, të rritet vetëdija për dobritë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave. Përveç këtyre, është e domosdoshme të ofrohen grante për inovacion që promovojnë parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave, me fokus të veçantë në gjetjen e alternativave ndaj ambalazhit dhe produkteve plastike. Për fund, duhet promovohet bashkëpunimi ndërmjet sektorit privat dhe komunave në trajtim, riciklim dhe ripërdorim të fraksioneve të caktuara të mbeturinave.

Ky objektivi specifik lidhet ngushtë me Objektivin 3.1 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon menaxhimin e integruar të mbeturinave dhe rritjen e qarkullimit të resurseve.

Aktivitetet:

- Zhvillimi i planeve ndërkomunale për menaxhim të integruar të mbeturinave
- Zhvillimi i rrjetit të stacioneve të transferimit, trajtimit dhe deponimit të mbeturinave përmes iniciativave ndër-komunale
- Rritja e vetëdijes për dobritë e menaxhimit dhe riciklimit të mbeturinave
- Ofrimi i granteve për inovacion që e promovojnë parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave, me fokus të veçantë në gjetjen e alternativave ndaj ambalazhit dhe produkteve plastike
- Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe komunave në trajtim, riciklim dhe ripërdorim të fraksioneve të caktuara të mbeturinave.



7.3 ZHVILLIMI I SHËNDETËSISË DHE MIREQENIES SOCIALE

7.3.1 Objektivi Specifik: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat

Një analizë e gjendjes aktuale të sistemit shëndetësor ka paraqitur nevojën e ndryshimeve dhe zbatimit të reformës në sistemin shëndetësor, qoftë në aspektin e riorganizimit të sistemit aktual dhe institucioneve përkatëse dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të sistemit. Karakteristikat demografike të popullsisë e orientojnë zhvillimin e sistemit shëndetësor drejt ruajtjes së shëndetit të popullatës, duke fuqizuar kujdesin parësor si shtyllë të sistemit shëndetësor, në veçanti duke promovuar stile të shëndetshme jetese.

Komuna e Ferizaj ashtu si edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në listën e projekteve prioritare ka inkorporuar edhe projektin për fuqizimin e infrastrukturës së kujdesit parësor. Aktiviteti i Kujdesit Parësor Shëndetësor përfshin promovimin e shëndetit, parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin, trajtimin dhe rehabilitimin e lidhur me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet, duke përfshirë kujdesin dentar dhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike, bazuar në konceptin e mjekësisë familjare. Rrjeti publik i KSHP-së përbëhet nga gjithsej 20 institucione komunale me njësitë e saj të përbëra: Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF), Ambulanca të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe njësi tjera shëndetësore.

Tabela 14. Infrastruktura shëndetësore e Komunës së Ferizajt

Infrastruktura shendetesore	Numri total i objekteve
Qender Kryesore e Mjekesise Familjare (QKMF)	1 Objekt
Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) brenda qytetit urbane	3 Objekte
Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) në nivel fshatrash rurale	6 Objekte
Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF).	6 Objekte
Qendra e Emergjencës Primare	1 Objekt
Dispanseri Antituberkular	1 Objekt
Qendra e vaksinimit	1 Objekt
Barnatorja Qëndrore	1 Objekt
Totali:	20 Objekte

Burimi: Drejtoria e Shendetesise, Komuna e Ferizaj

Rrjeti i Institucioneve Shëndetësore në KPSH është i përbërë nga: një(1) Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare(QKMF), e tre (3) Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) brenda qytetit, kurse në nivel fshatrash janë gjashtë (6) Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe gjashtë (6) Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF).

Si vision të shëndetësisë për vitet e ardhshme përpos ndërtimit të objekteve të reja me Investime Kapitale Komunale, do të jetë edhe renovimi i objekteve tjera ekzistuese, rritja e cilësisë së shërbimeve mjekësore duke bërë trajnimin e stafit (Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional), paisjen e tyre me pajisje mjekësore të nevojshme, si dhe fuqizimin e ekipeve për Edukimin dhe Promovimin Shëndetësor në komunitet për ngritjen e vetëdijes shëndetësore të tyre.

Të gjithë këta indikatorë do të ndikojnë në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve dhe rritjen e jetëgjatësisë së tyre.

Synimi i strategjisë zhvillimore të Komunës së Ferizaj është të “sigurojë jetë të shëndetshme dhe të promovojë mirëqenien për të gjithë në të gjitha moshat”. Bazuar në të dhënat e OKB-së, janë bërë hapa të rëndësishëm në rritjen e jetëgjatësisë dhe në reduktimin e disa prej vrasësve të zakonshëm përgjegjës për vdekshmërinë e fëmijëve dhe nënave. Progres i madh është bërë gjithashtu në rritjen e aksesit në ujë të pastër dhe kanalizime, në reduktimin e malaries, tuberkulozit, poliomielitit dhe

përhapjes së sëmundjeve ngjitëse. Megjithatë, nevojiten shumë më tepër përpjekje për të kontrolluar një gamë të gjerë sëmundjesh dhe për të adresuar shumë çështje të ndryshme shëndetësore për reduktimin e vdekshmërisë amtare, për t'i dhënë fund vdekjeve të parandalueshme të të porsalindurve dhe fëmijëve, t'i jepet fund epidemive, tuberkulozit, malaries dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse, të ulet vdekshmëria nga sëmundjet jo të transmetueshme, të forcojmë parandalimin dhe trajtimin e abuzimit me substancat, të përgjysmojmë numrin e vdekjeve dhe të lëndimeve nga aksidentet në trafikun rrugor, të sigurojmë akses për të gjithë në shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe riprodhues si dhe të zvogëlojmë numrin e vdekjeve dhe sëmundjeve nga kimikatet e rrezikshme dhe ndotja.

Duke i kushtuar rëndësi “Mbrotjes dhe Promovimit të Shëndetit të Njeriut”, pranojmë se shëndeti dhe zhvillimi janë të ndërlidhura ngushtë dhe na thërret se në pikat e veprimit duhet të adresojmë nevojat shëndetësore parësore të popullsisë, pasi ato janë integrale për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe kujdesit parësor mjedisor gjithashtu.

Bazuar në targetin 3.C i zhvillimit të qëndrueshëm : Synojmë të rrisim financimin në infrastrukturën shëndetësore dhe mbështetjen e resurseve shëndetësore nëpërmjet rekrutimit, zhvillimit, trajnimit dhe mbajtjes së tyre.

Referuar targetit 3.5 i zhvillimit të qëndrueshëm : Parandalimi dhe trajtimi i abuzimit me substancat duke synuar forcimin e politikave të parandalimit dhe trajtimin e abuzimit me substancat, përfshirë parandalimin me abuzimin me drogat narkotike dhe përdorimin e dëmshëm të alkoolit.

Ketu duhet që të përfshihen Qendra ditore psikosociale për trajtimin e përdoruesve të narkotikëve, ku do të mund të sigurohen trajnime dhe ligjerata vetdijesuese për përdoruesit, dhe të miturit në menyrë që t'i parandalojmë të rinjët të inkuadrohen në këto rrugë të rrezikshme dhe të dëmshme për shëndetin e tyre dhe të rrethit ku jetojnë. Po ashtu të krijojmë qendra këshilluese për personat e rritur përdorues ose vartës nga alkooli.

Edhe për kategorinë Femijë në situatë rruge ose fëmijë me sjellje asocial të krijohet Qendra të kujdesit ditor, këto qendra mund të përmbajnë përveç shërbimeve Psikosociale, edhe përgatitjen për kurse dhe zanate të ndryshme, në menyrë që t'i largojmë dhe t'i parandalojmë nga dukuritë negative të cilat mund të hasen në rrugë. Parandalimi do të jete me i lehtë se sa trajtimi!

Gjithashtu të krijojmë vende rekreative për të moshuarit që të kalojnë kohën e lirë, duke përfshirë, parqet e mëdha gjerberuese, salla për lojëra të ndryshme për të moshuarit siç është Shahu, Domino etj.

Nëpërmjet targetit 3.6 i zhvillimit të qëndrueshëm: Synojmë reduktimin e lëndimeve dhe vdekjeve në rrugë. Do të hartojmë politika që në fazë të parë të përgjysmojmë numrin e vdekjeve dhe lëndimeve nga aksidentet e trafikut rrugor.

Targeti 3.7 i zhvillimit të qëndrueshëm: Sigurimi i çasjes në kujdesin seksual dhe riprodhues, në planifikimin familjar dhe edukimin. Politikat tona synojnë të sigurojnë akses në shërbimet e kujdesit shëndetësor riprodhues, duke përfshirë planifikimin familjar, informacionin dhe edukimin dhe integrimin e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet kombëtare.

Targeti 3.9 i zhvillimit të qëndrueshëm: Reduktimi i sëmundjeve dhe vdekjeve nga kimikatet e rrezikshme dhe ndotja. Komuna jonë nëpërmjet politikave do të punojë për të reduktuar ndjeshëm numrin e vdekjeve dhe sëmundjeve që shkaktohen nga kimikatet e rrezikshme dhe nga ndotja e ajrit, ujit dhe tokës.

Aktivitetet:

- Rritja e financimit në infrastrukturën shëndetësore dhe mbështetjen e resurseve shëndetësore nëpërmjet rekrutimit, zhvillimit, trajnimit dhe mbajtjes së tyre.
- Sigurimi i aksesit në shërbimet e kujdesit shëndetësor riprodhues, duke përfshirë planifikimin familjar, informacionin dhe edukimin dhe integrimin e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet lokale.
- Formimi i Qendrës së thirrjes Urgjente (112) me ndërlidhje të përbashkët të ekipit mjekësor të emergjencës primare, policisë dhe zjarrëfikësve
- Ndërtimi i QMF-së në rrugën Kadri Zeka
- Ndërtimi i objektit të ri të Qendrës për Punë Sociale
- Ndërtimi i një strehimore ditore për të moshuarit

7.3.2 Objektivi Specifik: Punësim gjithëpërfshirës

Rritja e punësimit dhe krijimi i kushteve për punë dinjitoze për të gjithë janë aspekte të rëndësishme zhvillimore. Punësimi cilësor ndikon në krijim të mirëqenies dhe zvogëlim të pabarazive në shoqëri. Për më tepër, punësimi është shumë i rëndësishëm për t'i parandaluar tendencat për migrim, sidomos në komuna të vogla. Përkundër faktit që në vitet e fundit është shënuar rritje në punësim, prapëseprapë norma e përgjithshme e punësimit mbetet ende mjaftë e ulët, sidomos tek gratë dhe të rinjtë. Përpos problemeve strukturore ekonomike që ndikojnë në punësim, një problem i vazhdueshëm mbetet hendeku i theksuar në mes të ofertës dhe kërkesës në tregun e punës. Për ta adresuar çështjen e punësimit, PNZHEL 2030 synon të zvogëlojë hendekun e shkathtësive në tregun e punës dhe të rrisë punësimin e dinjitetshëm për gra, të rinj dhe grupe të cënueshme.

Ky objektivi lidhet me Qëllimin 5 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon të krijojë një treg gjithëpërfshirës të punës, të lartë dhe të denjë, me Strategjinë për punësim dhe treg të punës, dhe me Strategjinë për arsim. Ky objektivi ka më së shumti kontribut në arritjen e SDG 8 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike).

Nuk është sekret se punësimi është një komponent kyç i rritjes ekonomike. Kur njerëzit kanë punë, ata kanë te ardhura për të shpenzuar në mallra dhe shërbime, gjë që ndihmon bizneset të rriten dhe të krijojnë më shumë vende pune. Vendet me nivele të ulëta papunësie do të jenë gjithmonë më të qëndrueshme ekonomikisht se ato me norma të larta papunësie. Duke pasur parasysh rëndësinë e punësimit për rritjen ekonomike dhe mirëqenien e qytetarëve, komuna do të fokusohet në krijimin e vendeve të punës përmes një sërë politikash si investimi në infrastrukturë, ofrimi i lehtësirave tatimore për bizneset ose rritja e aksesit në financa. Ajo që është thelbësore është që synojmë të krijojmë një mjedis ku bizneset mund të lulëzojnë dhe të krijojnë vende pune. Vetëm atëherë ekonomia do të jetë në gjendje të rritet dhe të sigurojë prosperitet për të gjithë.

Tabela 15. Numri i të punësuarve në komunën e Ferizajt

Sektoret sipas profilit ligjor	Numri i te punesuarve
Biznese Individuale	4,284
Biznese Juridike-SH.P.K.	8,674
Shoqëri akcionare	183
OJQ	151
Kompani te Huaja	100
Bashkësi Fetare	118
Ortakëria e përgjithshme	62
Total	13,573

Burimi: ATK 2023

Aktivitetet:

- Fuqizimi i zyrave të punësimit
- Mbështetja e trajnimeve në vend të punës ose formave tjera të trajnimeve
- Krijimi i këshilleve komunale për artikulum të nevojave të sektorit privat

7.3.3 Objektivi Specifik: Zvogëlimi i hendekut të shkathtësive në tregun e punës

Ndonëse norma e papunësisë është mjaft e lartë, punëdhënësit vazhdimisht ankohen se hasin në vështirësi në gjetjen e profileve të duhura për përmbushje të nevojave të tyre. Në këtë kontekst, përgatitja e fuqisë punëtore që t'i përshtaten kërkesave të tregut është tejet e rëndësishme për krijim të vendeve të reja të punës. Për t'u arritur kjo, është e nevojshme që fillimisht të krijohen këshille komunale apo platforma të ngjashme, të cilat mundësojnë identifikimin dhe artikulin e nevojave të sektorit privat në lidhje me shkathtësitë që mungojnë në treg të punës. Gjithashtu, zyrat e punësimit, të cilat janë prezente nëpër komuna, duhet të fuqizohen. Më tutje, programet dhe kurrikulat në shkolla profesionale dhe qendra të aftësimit profesional do të përshtaten me nevojat e tregut. Në anën tjetër, komunat duhet të dizajnojnë forma të përkrahjes së trajnimeve në vend të punës ose formave tjera të trajnimeve.

Bazuar ne targetin 8.5 i zhvillimit të qëndrueshëm: Politikat e strategjisë tonë zhvillimore synojnë që deri në vitin 2030, ne komunën e Ferizaj të arrihet punësim produktiv dhe punë e denjë për të gjitha gratë dhe burrat, duke përfshirë të rinjtë dhe personat me aftësi të kufizuara.

Bazuar ne targetin 8.6 i zhvillimit të qëndrueshëm: Do të promovojmë rëndësinë e punësimit, arsimimit dhe trajnimit të të rinjve duke synuar të zvogëlojmë ndjeshëm përqindjen e të rinjve që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim. Punësimi, arsimimi dhe trajnimi i të rinjve. Me target te veçantë për të rinjtë (të moshës 15–24 vjeç) që nuk janë në arsim, punësim ose trajnim.

Referuar targetit 8.8 i zhvillimit të qëndrueshëm: Politika zhvillimore synon te mbrojtë të drejta e punës dhe promovimin e mjediseve të sigurta të punës për të gjithë punëtorët, veçanërisht gratë dhe ato në punësim të pasigurt.

Tabela 16. Përqindja e sektorëve me vlerë të lartë të shtuar dhe intensive të punës në Komunën e Ferizajt

Aktivitetet sipas sektorit ekonomik	Ndermarrje Aktive 30/03/2023	Te Punesuar	Kontributi %
G - Tregtia me Shumice dhe Pakice Riparimi i Mjeteve Motorike	2,618	4,555	33.54
C - Industria Perpunuese Prodhimtaria	965	1,680	12.37
I - Hoteleria dhe Akomodimi	801	1,393	10.26
H - Transporti dhe Magazinimi	744	1,296	9.54
F - Ndertimtaria	598	1,040	7.66
S - Aktivitetet Tjera Sherbyese	438	762	5.61
M - Aktivitetet Profesionale Shkencore dhe Teknike	313	545	4.01
N - Aktivitetet Sherbyese dhe te Perkrahes	213	371	2.73
A - Bujqesia Pylltaria dhe Peshkimi	189	329	2.42
J - Informimi dhe Komunikimi	180	314	2.31
R - Artet Argetimi dhe Rekreacioni	148	257	1.89
O - Administrimi Publik dhe I Mbrojtjes Sigurimi i Detyruar Social	121	211	1.55
P - Arsimi	72	125	0.92
L - Aktivitetet e Patundshmerise	37	65	0.48
E - Ujesjellesi Kanalizimi Menaxhimi i Mbeturinave dhe Aktivitetet e Riparimit	32	57	0.42
K - Aktivitetet Financiare dhe te Sigurimit	29	50	0.37
B - Xeheroret dhe Gurethyesit	17	30	0.22
Q - Aktivitetet e Shendetit Njerezor dhe te Punes Sociale	12	20	0.15
D - Furnizimi me Rryme Gaz Avull dhe Klimatizim	12	20	0.15
T - Aktivitetet e Ekonomive Shtepiake si Punedhenes	-	-	-
U - Aktivitetet e Organizatave dhe Organeve te Huaja	-	-	-
Të tjera	266	462	3.41
Totali	7,805	13,581	100

Ky objektiv specifik lidhet me Objektivin 5.1 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon zhvillimin e shkathtë-sive dhe ngushtimin e hendekut në tregun e punës.

Integrimi dhe rritja e punësimit cilësor të gratë, të rinjtë dhe kategoritë e cenueshme, përveçse krijon mirëqenie për ta, i kontribuon edhe zhvillimit të gjithmbarshëm ekonomik. Për t'i kontribuar këtij objektivi specifik, është e nevojshme që gratë, të rinjtë dhe grupet e cenueshme të priorizohen në mundësitë që ofrohen përmes Masave Aktive të Tregut të Punës (MATP). Diaspora mund të luajë rol shumë qenësor në bartje të dijes dhe rrjedhimisht në përmirësim të mundësive të punësimit. Në këtë drejtim, mund të parashihen programe mentoruese, ku diaspora angazhohet për aftësim të kategorive të sipërpërmendura.

Gjithashtu, në mënyrë që të adresohet hendeku në informacion, duhet të organizohen panairë dhe ngjarje të ngjashme promovuese që i sjellin bashkë punëdhënësit dhe punëkërkuessit, në këtë rast gratë, të rinjtë dhe kategoritë e cenueshme. Duke qenë se gratë mbesin jashtë tregut të punës kryesisht për shkak të obligimeve familjare, është e nevojshme që të përmirësohet qasja e konvencionale në kujdes ditor për fëmijë dhe të moshuar, për të rritur pjesëmarrjen e tyre në treg të punës.

Ky objektiv specifik lidhet pjesërisht me Objektivin 5.2 të SKZH-së dhe PKZH-së, që ka për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës. Dy kategoritë tjera, përkatësisht të rinjtë dhe grupet e cenueshme, lidhen me agjendën horizontale të SKZH-së dhe PKZH-së.

Aktivitetet:

- Mentorimi i të rinjve dhe grave të papuna nga diaspora, për t'iu përmirësuar mundësitë për vetëpunësim
- Prioritizimi i grave dhe të rinjve në përkrahjen për punësim
- Krijimi i panairëve të punës me fokus punësimin e grave dhe të rinjve
- Ofrimi i qasjes së konvencionale në kujdes ditor për fëmijë dhe të moshuar, për të mundësuar qasjen e grave në treg të punës



7.4 OBJEKTIVI 4: ZHVILLIMI EKONOMIK, BUJQESOR DHE RURAL

Zhvillimi Ekonomik i Qendrueshëm- Ekonomi lokale konkurruese

Krijimi i një ekonomie lokale konkurruese përbën një aspekt qenësor të zhvillimit. Mjedisi konkurrues inkurajon investime të reja në sektorë produktivë dhe nxit krijimin e vendeve cilësore të punës. Ndonëse përgjatë viteve, ekonomitë lokale kanë shënuar progres në përmirësimin e konkurrueshmërisë së tyre, ato ende ballafaqohen me mungesë të investimeve në veprimtari ekonomike me vlerë të shtuar, kanë produktivitet relativisht të ulët dhe kanë ngelur prapa sa i përket trendeve globale të digjitalizimit dhe inovacionit. Për ta krijuar një ekonomi lokale konkurruese, PNZHEL 2030 parasheh që të rriten investimet në fushat me potencial për zhvillim ekonomik, të rritet produktiviteti në bujqësi dhe të promovohet turizmi lokal, si dhe të përkrahet ndërmarrësia.

Ky objektiv ndërlidhet me Qëllimin I të SKZH-së dhe PKZH-së për të krijuar një ekonomi digjitale, qarkore dhe konkurruese. Gjithashtu, ky objektiv lidhet me Strategjinë për zhvillimin e industrisë dhe mbështetjen e bizneseve, Strategjinë për ndërmarrësi dhe inovacion, si dhe me Strategjinë për bujqësi dhe zhvillim rural. Përbushja e këtij objektivi do të ndikojë drejtpërdrejt në arritjen e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (SDG), përkatësisht Objektivin 8 (Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike), Objektivin 9 (Industri, inovacion dhe infrastrukturë) dhe Objektivin 12 (Konsum dhe prodhim i përgjithshëm).

Duke marrë parasysh që Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal hartohet për periudhën 2024-2034, grupi i punës vendosi që kjo strategji të zhvillohet duke marrë parasysh objektivat globale të qëndrueshmërisë së përcaktuara nga kombet e bashkuara për dekadën 2020-2034. Veprimi në nivel lokal është thelbësor për të arritur 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe 169 targetet deri në vitin e synuar 2030. Strategjia fokusohet në katër shtylla kryesore – Zhvillim Ekonomik, Zhvillim Social, Zhvillim Mjedisor dhe Zhvillim e Promovim Kulturor të cilat mbështesin procesin tonë strategjik në harmoni me objektivat nacionale e globale të qëndrueshmërisë.



Për të mbështetur aktivitetet e integruara që përfshijnë perspektiva ekonomike, sociale dhe mjedisore, Komuna e Ferizaj do të zhvillojë edhe Agjenden Lokale 2030 sipas SDG-të në përputhje me kushtet dhe rrethanat përkatëse lokale. Do të përpilojmë shembuj të politikave të tilla të të menduarit dhe të vepruarit nga qeverisja vendore për të gjithë komunitetin. Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal po zhvillohet brenda kornizave të disa prej objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Zhvillimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe te Mesme – NVM

Ndërmarrjet e vogla dhe te mesme janë shtylla kurrizore e ekonomisë së çdo vendi, sepse ato priren të krijojnë më shumë mundësi për komunitetet lokale dhe të gjenerojnë më shumë të ardhura për vendasit sesa bizneset e mëdha, të cilat në fakt mund të ushtrojnë presion mbi komunitetet lokale pasi një pjesë e madhe e të ardhurave shkon për jo-pronarët e bizneseve vendase.

Ndikimi i bizneseve të vogla dhe te mesme në ekonomi zakonisht minohet, por ne do të theksojmë disa nga mënyrat me të cilat bizneset e vogla ndihmojnë ekonominë lokale.

Krijimi i Vendeve të Punës: Mënyra e parë me të cilën bizneset e vogla dhe të mesëm ndihmojnë ekonominë lokale është krijimi i vendeve të punës. Bizneset e vogla ndihmojnë rritjen ekonomike lokale duke ofruar mundësi punësimi për njerëzit që mund të mos jenë të punësuar nga organizata të mëdha dhe kompani të mëdha. Bizneset e vogla dhe të mesme ofrojnë punë për vendasit vetëm në vend që të punësojnë njerëz nga gjetkë, duke ndihmuar njerëzit të bëjnë jetesën për veten e tyre. Bizneset e mëdha janë gjithashtu të varura nga bizneset lokale për kryerjen e detyrave të ndryshme. Sjellin Inovacion dhe risi: Bizneset e vogla duhet të dallohen prirjen të jenë shumë inovative dhe unike në mënyrë që të bëjnë emër për veten e tyre.

Mbajne paranë në qarkullim të ekonomisë lokale:

Siç u tha më herët, qarkullimi i parave është i mirë për ekonominë dhe kur klientët blejnë diçka nga një biznes lokal, shumica e atyre parave do të përfundojnë duke qarkulluar në komunitetin lokal. Arsyeja pas kësaj është se pronarët e bizneseve të vogla zakonisht i kryejnë lëndët e para ose detyrat e tyre nga komuniteti lokal.

Kontribut për Pushtetin Vendor: Edhe bizneset vendase i ndihmojnë qeveritë në formën e taksave të ndryshme. Kur një konsumator blen diçka nga një biznes lokal, ai po i kthen para komunitetit lokal dhe ky qarkullim i parave është i rëndësishëm në rritjen e një ekonomie lokale.

Duke marrë parasysh analizën e lartepërmendur dhe për nga rëndësia që ka, në tabelat e mëposhtme pasqyrohen numri i NVM-se sipas sektorëve të ekonomisë dhe kontributet e tyre si një bazë për analizën dhe strategjinë zhvillimore me fokus të vecante në sektorë me kontribute të larta.

Tabela. 17 NVM-të aktive sipas sektorëve të ekonomisë në Komunën e Ferizajt

Aktivitetet e NVM-e sipas sektorit ekonomik	NVM Aktive 30/03/2023	NVM të Regjistruara 01/01/2000- 30/03/2023	Kontributi %
G - Tregtia me Shumice dhe Pakice Riparimi i Mjeteve Motorike dhe Motocikleta	2,618	5,899	33.54
C - Industria Perpunuese Prodhimtaria	965	2,145	12.37
I - Hoteleria dhe Akomodimi	801	1,780	10.26
H - Transporti dhe Magazinimi	744	1,654	9.54
F - Ndertimtaria	598	1,329	7.66
S - Aktivitetet Tjera Sherbyese	438	973	5.61
M - Aktivitetet Profesionale Shkencore dhe Teknike	313	696	4.01
N - Aktivitetet Sherbyese dhe të Perkrahejes	213	474	2.73
A - Bujqesia Pylltaria dhe Peshkimi	189	420	2.42
J - Informimi dhe Komunikimi	180	400	2.31
R - Artet Argetimi dhe Rekreacioni	147	327	1.89
O - Administrimi Publik dhe i Mbrojtjes Sigurimi i Detyruar Social	121	268	1.55
P - Arsimi	72	160	0.92
L - Aktivitetet e Patundshmerise	37	83	0.48
E - Ujesjellesi Kanalizimi Menaxhimi i Mbeturinave dhe Aktivitetet e Riparimit	32	72	0.42
K - Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit	29	64	0.37
B - Xehoret dhe Gurethyesit	17	38	0.22
Q - Aktivitetet e Shendetit Njerezor dhe të Punës Sociale	12	26	0.15
D - Furnizimi me Rryme Gaz Avull dhe Klimatizim	12	26	0.15
T - Aktivitetet e Ekonomive Shtepiake si Punedhenes	-	-	0.00
U - Aktivitetet e Organizatave dhe Organeve të Huaja	-	-	0.00
Të tjera	266	591	3.41
Totali	7,805	17,425	100.00

Ne tabelën 2 po prezantohen numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sipas sektorëve të ekonomisë dhe kontributet e tyre në total të ekonomisë vendore duke vërejtur kontributin e lartë të sektorit të tregtisë dhe duke iu referuar targetit 8.5 të zhvillimit të qëndrueshëm, sugjerohet rritja e ndihmës dhe mbështetje të tregtisë nepermjet angazhimeve dhe disbursimet ose subvecioneve tregtare.

Tabela 18. Numri i NVM-ve aktive në Komunën e Ferizajt

Klasifikimi	Numri i të Punësuarve	Numri i Bizneseve	Perqindja %
Mikro Ndermarrje	1 - 9	7.273	93%
Ndermarrje të Vogla	10 - 49	398	5%
Ndermarrje të Mesme	50-249	119	1.5%
Ndermarrje të Medha	250 e mbi	15	0.5%
Gjithsej		7.805	100%

Burimi: ARBK 2023

Duke marrë parasysh rëndësinë e grave sipërmarrëse në komunitetin lokal dhe objektivin global të barazisë gjinore, në tabelën e mëposhtëm pasqyrohet struktura e ndërmarrjeve sipas gjinisë së pronësisë.

Tabela 19. Struktura e ndërmarrjeve aktive sipas gjinisë së pronarëve në Komunën e Ferizajt

Gjithsej	Ndermarrje me Pronesi Meshkuj		Ndermarrje me Pronesi Femer		Ndermarrje me Pronesi të përzier (Meshkuj & Femer)	
7.805	6.322	81%	1.248	16%	235	3%

Burimi: ARBK 2023

Në tabelën 4 prezantohen ndërmarrje me pronarë meshkuj 81%, ndërmarrje me pronarë femra 16% dhe ndërmarrje me pronarë të përzier (meshkuj & femër) 3%.

Në kuptimin ekonomik Ferizaj funksionon si një treg i madh ku përveç banorëve komunal kemi edhe shumë udhëtar ndër rajonal e besa edhe nga qytetet jashtë Kosovës, që vinë dhe marrin shërbime të ndryshme ekonomike.

Agjensioni statistikor i Kosovës Ferizajn e rendit si komuna e dytë me zhvillim ekonomik në Kosovë, pas Prishtinës. Ky zhvillim ekonomik është fal pozitës së mirë gjeografike dhe faktoreve tjerë. Zhvillimi i tillë ekonomik e bën Ferizajn një vend atraktiv për biznese e njëherit shumë dinamik me një mobilitet të madh të njerëzve.

Numri i bizneseve të regjistruara në Ferizaj është shumë i madh. Në sektorin primar rajoni i Ferizajt nuk është i njohur si prodhues bujqësor e blegtoral krahasuar me komunat tjera edhe pse vitet e fundit me vet iniciativë dhe ndihmën nga qeveria, komuna dhe organizata ndërkombëtare ka filluar mjaft mirë zhvillimin bujqësorë. Kjo do të ndihmonte edhe turizmin agrar në të ardhmen.

Sektori i dytë industria në vitet e më hershme në Ferizaj ishte shumë e zhvilluar, e cila tërhoqi edhe shumë migrues për të jetuar në qytet. Kjo industri në vazhdim të privatizimit e humbi primatin që kishte. Sot Industria është e organizuar në sektorin privat ku kemi një numër të madh ndërmarrjesh përpunuese, sidomos në sektorin e përpunimit të drurit.

Sektori më i rëndësishëm për Kosovën e veçanërisht për Ferizajn pa dyshim është sektori i tretë për shkak mungesës së alternativës prodhuese qytetarët detyrimisht janë orientuar në shërbime dhe tregti, rekreacion e gastronomi.

Komuniteti i biznesit përbëhet nga ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ekonomitë familjare kryesisht në lëmin e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë, bujqësisë, ndërtimtarisë dhe të zejeve të tjera. - Biznese prodhuese 11 % +

- Biznese tregtare 45 %

- Biznese shërbyese 44 % (PZHU)

Tabela 20. Regjistrimi i bizneseve në komunën e Ferizajt deri më 30.03.2023

Nr.	Aktivitetet e sipas sektorit ekonomik	Regjistrimet 01/01/2000 30/03/2023	%
1	A - Bujqësia Pylltaria dhe Peshkimi	420	3.23
2	B - Xehoret dhe Gurethyesit	38	0.29
3	C - Industria Perpunuese Prodhimtaria	2145	16.51
4	F - Nderimtaria	1329	10.23
5	H - Transporti dhe Magazini	1654	12.73
6	G - Tregtia me Shumice dhe Pakice Riparimi i Mjeteve Motorike dhe Motocikletave	5899	45.40
7	S - Aktivitetet Tjera Sherbyese	973	7.49
8	O - Administrimi Publik dhe I Mbrojtjes Sigurimi i Detyruar Social	268	2.06
9	N - Aktivitetet Sherbyese dhe te Perkrahes	474	3.65
10	J - Informimi dhe Komunikimi	400	3.08
11	I - Hoteleria dhe Akomodimi	1780	13.70
12	M - Aktivitetet Profesionale Shkencore dhe Teknike	696	5.36
13	R - Artet Argetimi dhe Rekreacioni	327	2.52
14	P - Arsimi	160	1.23
15	Q - Aktivitetet e Shendetit Njerezor dhe te Punes Sociale	26	0.20
16	D - Furnizimi me Rryme Gaz Avull dhe Klimatizim	26	0.20
17	E - Ujesjellesi Kanalizimi Menaxhimi i Mbeturinave dhe Aktivitetet e Riparimit	72	0.55
18	K - Aktivitetet Financiare dhe te Sigurimit	64	0.49
19	L - Aktivitetet e Patundshmerise	83	0.64
20	T - Aktivitetet e Ekonomive Shtepiake si Punedhenes	0	0.00
21	U - Aktivitetet e Organizatave dhe Organeve te Huaja	0	0.00
23	Të tjera	591	4.55

Burimi: ARBK

Nga 17425 biznese të regjistruara 7805 janë aktive. Nga bizneset e regjistruara 11918 janë pronar meshkuj kurse 2466 janë pronar femra kurse bashkëpronar janë 142 biznese, Punëtorë të deklaruar në ARBK 16834

Tabela 21. Numri i te punesuaresh sipas sektoreve ne komunën e Ferizajt

Ndermarrjet ligjore	Klasifikimi i Ndermarrjeve	Numri i Punonjesve
Ndermarrje Juridike SH.P.K.	Mikro	8,674
Ndermarrje Individuale	Vogla dhe Mesme	4,284
Shoqëri Aksionare	Medha	183
OJQ	Jo fitimprures	151
Kompani e Huaj	Te huaja	100
Bashkesi Fetare	Bashkesi	118
Ortakëria e përgjithshme	Ortakëri	62
Total		13,573

Burimi: ATK 2023

Promovimi i NVM dhe asistimi në hapjen e tregjeve të reja nëpërmjet B2B takime, pjesëmarrje në Panire Ndërkombëtare etj.

Tabela 22. Panairët lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare sipas sektorëve

Panairi	Organizimi
Panairi i prodhimeve vendore	Një herë në vit
Panairi i Agrobiznesit, Turizmit, Kultures dhe Artit	Një herë në vit
Teknologji & Inovacionit ICT, Punes dhe i Karrieres	Një herë në vit

7.4.1 Objektivi Specifik: Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal

Mobilizimi i investimeve, goftë vendore apo të huaja, është i rëndësishëm për rritjen e nivelit të konkurrueshmërisë së komunave. Investimet e balancuara gjeografikisht i kontribuojnë qasjes gjithëpërfshirëse të zhvillimit dhe bëjnë që asnjë komunë të mos ngelet prapa. Për të rritur investimet në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal, PNZHEL 2030 parasheh që komunat të angazhohen në promovim të investimeve, duke hartuar profile ekonomike dhe materiale tjera promovuese, ku shfaqen potencialet për investime konform karakteristikave të zonave. Përpos kësaj, është e domosdoshme që të ketë ngritje të resurseve njerëzore brenda komunave për të siguruar promovim sistematik të investimeve, si dhe për të përmirësuar qasjen në fonde zhvillimore. Lirimi nga tatimi në pronë do të mund të shfrytëzohet si një instrument fiskal për t'i stimuluar investimet e natyrës më strategjike. Fjala është për investime të cilat kanë vlerë më të lartë dhe potencial për të krijuar më shumë vende të punës. Pronat të cilat janë në pronësi të komunës, do të klasifikohen më mirë, që të dihet se cilat nga ato mund të shfrytëzohen për të përkrahur investimet. Gjithashtu, ekzistojnë prona nën menaxhimin e AKP-së, të cilat mund të kalojnë nën menaxhim të komunave dhe të shfrytëzohen për nxitje të investimeve, porse është e nevojshme që të thjeshtohen procedurat për bartje të menaxhimit nga AKP-ja te komunat. Komunave do t'u sigurohet mundësi që të ofrojnë garanci kreditore për ndërmarrjet, ashtu që ta përmirësojnë qasjen e tyre në financa. Krijimi i parqeve industriale të specializuara me veçori miqësore për mjedisin, gjithashtu duhet të jetë në mesin e prioritetëve të komunave për nxitje të investimeve. Ky objektivi specifik lidhet me Objektivin 1.6 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon rritjen e investimeve të orientuara në eksport.

Aktivitetet:

- Ngritja e resurseve njerëzore brenda komunës për t'i promovuar investimet
- Hartimi i profilit ekonomik dhe materialeve të tjera promovuese të komunës së Ferizajt ku tregohen potencialet për investime
- Ngritja e kapaciteteve komunale për qasje në fondeve zhvillimore
- Lehtësira të tatimi në pronë për stimulim të investimeve të natyrës më strategjike
- Klasifikimi më i mirë i pronës komunale për dhënie në shfrytëzim
- Krijimi i parqeve industriale të specializuara me veçori miqësore për mjedisin
- Krijimi i zonave ekonomike, inkubatoreve të bizneseve dhe parqet e bizneseve
- Krijimi i inkubatorëve të biznesit(për bizneset e reja dhe grupmoshat e reja) për formën e funksionimit të tyre të bashkëpunohet me agjencionin Kiesa
- Aftësimi për punë të rinjëve dhe grupmoshave tjera
- Aprovimi i rregullores për subvencionimin e bizneseve dhe personave fizik
- Përkrahja e komuniteteve(minoriteteve) në biznes
- Organizimi i takimeve B2B për bizneset vendore dhe ndërkombëtare
- Organizimi i takimeve me biznese nga diaspora



7.4.2 Objektivi specifik: Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion

Në kohët e sotme, shtytësit kryesorë të rritjes dhe zhvillimit të NVM-ve dhe krijimit të startup bizneseve janë digjitalizimi dhe inovacioni. Përsheptimi i tranzicionit me fokus në digjitalizim dhe inovacion është parakusht për krijimin e një ekonomie lokale konkurruese. Për t'u arritur ky objektivi specifik, është e nevojshme të ofrohet mbështetje për themelimin e qendrave të inovacionit të specializuara në veprimtari të zonës. Gjithashtu, nevojitet përkrahje për trajnime rreth përparësive të digjitalizimit të proceseve dhe dobisë së ekonomisë qarkore, mbështetje direkte për inovacion, si dhe organizim ngjarjesh ku promovohen dhe shpërblehen ndërmarrjet lokale inovative.

Ky objektivi specifik ndërlidhet me Objektivin 1.3 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon përsheptimin i transformimit digjital dhe inovacionit tek NVM-të dhe startup bizneset.

Një nga përfitimet kryesore të inovacionit është kontributi i tij në rritjen ekonomike. E thënë thjesht, inovacioni mund të gjenerojë produktivitet më të lartë, që do të thotë se i njëjti input gjeneron një prodhim më të madh. Ndërsa produktiviteti rritet, prodhohen më shumë mallra dhe shërbime – me fjalë të tjera, ekonomia rritet. Inovacioni dhe rritja e produktivitetit sjellin përfitime të mëdha për konsumatorët dhe bizneset. Ndërsa produktiviteti rritet, pagat e punëtorëve rriten. Ata kanë më shumë të ardhura në xhepat e tyre dhe kështu mund të blejnë më shumë mallra dhe shërbime. Në të njëjtën kohë, bizneset bëhen më fitimprurëse, gjë që u mundëson atyre të investojnë dhe të punësojnë më shumë punonjës. Referuar rëndësisë së lartëpërmendur strategjia zhvillimore e Komunës së Ferizaj do bazohet në udhëzimet e objektivave globale në zhvillimin e inovacionit si me poshtë:

- Përmirësimi i kërkimit dhe përmirësimi i teknologjive industriale nëpërmjet kërkimit shkencor dhe përmirësimit të aftësive teknologjike të sektorëve industrialë të ekonomisë vendore do të inkurajojmë rritjen e konsiderueshme të numrit të punonjësve të kërkimit dhe zhvillimit si dhe rritjen e shpenzimeve për kërkim publik dhe privat për zhvillim e inovacionit.

Tabela 13. Kërkimi, zhvillimi dhe inovacioni (RDI)

Shpenzimet për Kërkim, Zhvillim dhe Inovacion (RDI) si përqindje e PBB-së. Bashkimit Evropian	Shpenzimet për Kërkim, Zhvillim dhe Inovacion (RDI) si përqindje e PBB-së. Kosove
2.27% e PBB-së.	> 0.2% e PBB-së.
3.670 studiues per 1 milion banorë	156 studies shkencor per 1 milion banorë

Bazuar në këtë tabelë na faktohet rëndësia e investimit në krijimin e infrastruktures për zhvillimin e inovacionit sipas strategjive të lartëpërmendura.

Përkrahja e ndërmarrësisë me fokus në digjitalizim dhe inovacion

Në kohët e sotme, shtytësit kryesorë të rritjes dhe zhvillimit të NVM-ve dhe krijimit të startup bizneseve janë digjitalizimi dhe inovacioni. Përsheptimi i tranzicionit me fokus në digjitalizim dhe inovacion është parakusht për krijimin e një ekonomie lokale konkurruese. Për t'u arritur ky objektivi specifik, është e nevojshme të ofrohet mbështetje për themelimin e qendrave të inovacionit të specializuara në veprimtari të zonës. Gjithashtu, nevojitet përkrahje për trajnime rreth përparësive të digjitalizimit të proceseve dhe dobisë së ekonomisë qarkore, mbështetje direkte për inovacion, si dhe organizim ngjarjesh ku promovohen dhe shpërblehen ndërmarrjet lokale inovative.

Ky objektivi specifik ndërlidhet me Objektivin 1.3 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon përsheptimin e transformimit digjital dhe inovacionit tek NVM-të dhe startup bizneset.

Aktivitetet:

- Mbështetja e trajnimeve për përparësitë e digjitalizimit të proceseve dhe dobisë ekonomike qarkore
- Ofrimi i granteve për ndërmarrje të reja inovative (ndërmarrjeve në pronësi të grave t'u jepet përparësi)
- Ofrimi i shpërblimeve vjetore për ndërmarrjet lokale më inovative



7.4.3 Objektivi specifik: Zhvillimi i Industrisë

Synojmë të ndërtojmë një infrastrukturë elastike duke promovuar industrializimin gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm me nxitjen e inovacionit.

Industria prodhuese është thelbësore për progresin social dhe ekonomik sepse ofron vende pune në sektorin dytësor dhe terciar dhe kontribon në modernizimin e bujqësisë dhe në eliminimin e varësisë së madhe nëpërmjet të ardhurave bujqësore që krijon për qytetarët. Referuar objektivit të nëntë të zhvillimit të qëndrueshëm, komuna e Ferizajt synon që deri me 2030 të arrijnë:

- **Promovimin e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm** dhe të rrisim ndjeshëm kontributin e industrisë në punësimin dhe produktin e brendshëm bruto, në përputhje me rrethanat kombëtare duke synuar një rritje të konsiderueshme vjetore.
- **Rritja e aksesit në shërbimet dhe financimet**, ku ndërmarrjet industriale dhe të tjera në shkallë me të vogël, t'u krijohen lehtësira për akses në shërbimet financiare për përthithje të kredive të përballueshme dhe integrimin e tyre në zinxhirët e vlerës dhe të tregjeve.
- **Rritja e aksesit të ndërmarrjeve industriale të shkallës së vogël** në shërbimet financiare, për përthithje të një kredie ose linjë kredie të përballueshme.
- **Përmirësimi i të gjitha industrive dhe infrastrukturave për qëndrueshmëri** nëpërmjet rritjes së efikasitetit të përdorimit të burimeve dhe adoptimin më të madh të teknologjive dhe proceseve industriale të pastra dhe të shëndosha mjedisore, me ndërmarrjen e veprime në përputhje me aftësitë tona përkatëse kombëtare dhe lokale duke zvogëluar sasinë e emetimeve të dioksidit të karbonit CO₂ të gjeneruar për njësi të vlerës ekonomike.
- **Mbështetja e zhvillimit të teknologjisë vendase dhe diversifikimit industrial** nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë vendase (p. sh. industria e drurit e etj.), duke përfshirë sigurimin e një mjedisi të favorshëm politikash për, dhe ndër të tjera diversifikimin industrial dhe shtimin e vlerës së mallrave.
- **Sipas targetit 8.2 i zhvillimit të qëndrueshëm** : Synojmë diversifikimin, inovimin dhe përmirësimin e produktivitetit ekonomik për të arritur niveleve më të larta të produktivitetit ekonomik përmes diversifikimit, përmirësimit teknologjik dhe inovacionit, duke përfshirë fokusimin në sektorët me vlerë të lartë të shtuar dhe me intensitet të punës.
- **Sipas targetit 8.3 i zhvillimit të qëndrueshëm** : Synojmë të promovojmë politika për të mbështetur krijimin e vendeve të punës në ndërmarrjet në rritje që mbështesin aktivitetet prodhuese duke inkurajuar sipërmarrjen, kreativitetin dhe inovacionin.
- **Do të inkurajojnë formalizimin dhe rritjen e ndërmarrjeve (NVM) mikro**, të vogla dhe të mesme, duke përfshirë në aksesin për shërbime financiare me rritje të financimeve.

Aktivitetet:

- Rritja e aksesit të ndërmarrjeve industriale të shkallës së vogël në shërbimet financiare, për përthithje të një kredie ose linjë kredie të përballueshme
- Mbështetja e zhvillimit të teknologjisë vendase dhe diversifikimit industrial nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë vendase (p. sh. industria e drurit e etj.)
- Konsulencë për kompanitë e orientuara në eksport
- Mbështetja e investimeve të huaja në prodhimtari dhe përpunim
- Zhvillimi i industrisë së përpunimit të drurit, metalike dhe asaj ushqimore
- Zhvillimi i eksportit

Partneritete me shumë palë

“Një agjendë e suksesshme e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm kërkon partneritete ndër qeveritare, me sektorin privat dhe shoqërinë civile. Në nivel lokal synojmë partneritete gjithëpërfshirëse të ndërtuara mbi parime, vlera dhe një vizion me qëllime të përbashkëta që vendos qytetarët dhe ambientin në qendër”.

Arritja e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Qëndrueshëm kërkon që të gjithë të jemi të vendosur. Për realizimin e saj do të synojmë që sektorë dhe aktorë të ndryshëm të punojnë së bashku në mënyrë të integruar duke bashkuar burimet financiare, njohuritë dhe ekspertizën. Në epokën tonë të re të zhvillimit, si një plan për arritjen e të ardhmes së qëndrueshme që dëshirojmë, partneritetet ndërsektoriale dhe inovative me shumë palë do të luajnë një rol vendimtar për të na çuar atje ku kemi nevojë në vitin 2030.

Partneritetet për zhvillim të qëndrueshëm do të jetë një nismë me shumë palë, e ndërmarrë vullnetarisht nga qeveria vendore në bashkëpunim me organizatat ndërqeveritare, grupet kryesore dhe palët e tjera të interesuara si përpjekje për të kontribuar në zbatimin e synimeve dhe angazhimeve të miratuara.

Për realizimin e strategjisë, partneritetet me shumë palë do të konsiderohen si mjet i rëndësishëm për mobilizimin dhe shkëmbimin e njohurive, ekspertizës, teknologjive dhe burimeve financiare për të mbështetur arritjen e objektivave zhvillimore të qëndrueshme. Në këtë aspekt do të inkurajojmë më tej dhe promovojmë partneritete efektive publike, publike-private dhe të shoqërisë civile, duke u mbështetur në përvojën dhe strategjitë e burimeve të partneriteteve.

Partneritetet zhvillimore në strategjinë e komunës së Ferizaj do të përqendrohen sipas:

Targeti 17.1 i zhvillimit të qëndrueshëm : Mobilizimin e burimeve për të përmirësuar mbledhjen e të ardhurave të brendshme, për të përmirësuar kapacitetin e brendshëm për mbledhjen e taksave dhe të ardhurave të tjera.

Targeti 17.11 i zhvillimit të qëndrueshëm : Rritja e ndjeshme e eksporteve, veçanërisht me synimin për të dyfishuar pjesën e eksporteve deri në vitin 2030.

Targeti 17.16 i zhvillimit të qëndrueshëm: Rritja dhe përmirësimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm, i plotësuar nga partneritete me shumë aktorë që mobilizojnë dhe ndajnë njohuritë, ekspertizën, teknologjinë dhe burimet financiare, për të mbështetur arritjen e strategjive zhvillimore të Komunës.

Targeti 17.17 i zhvillimit të qëndrueshëm : Inkurajojmë partneritete efektive me promovimin e partneriteteve efektive publike, publike-private dhe të shoqërisë civile, duke u mbështetur në përvojën dhe strategjitë e burimeve të partneriteteve

Qeverisje ekonomike efektive dhe bashkëpunuese

Qeverisja efektive dhe bashkëpunimi janë parakushte për zhvillim ekonomik lokal të qëndrueshëm. Në vitet e fundit janë vërejtur përmirësime në parametra të qeverisjes së mirë. Pavarësisht kësaj, ka hapësirë për progres të mëtutjeshëm në adresimin e çështjeve që lidhen me financat lokale, resurset planifikuese, shërbimet publike, dhe nivelin e bashkëpunimit. Për të ta përmbushur këtë objektiv, PNZHEL parasheh që financat lokale të bëhen të qëndrueshme dhe efektive, të avancohen proceset dhe resurset në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale, të përmirësohen shërbimi dhe përgjegjëshmëria lokale dhe të rritet partneriteti për zhvillim ekonomik lokal.

Ky objektiv lidhet në masë të madhe me Qëllimin X të SKZH-së dhe PKZH-së, për të krijuar qeveri efektive dhe llogaridhënëse. Gjithashtu, ky objektiv lidhet me Strategjinë për reformën e menaxhimit të financave publike, Strategjinë për reformën e administratës publike dhe Strategjinë për vetëqeverisje lokale.



7.4.4 Objektiv Specifik: Avancimi i proceseve dhe resurseve në planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale

Konsolidimi i proceseve dhe krijimi i resurseve të mjaftueshme për planifikimin dhe zhvillimin e politikave lokale kontribuon në përmirësimin e qeverisjes ekonomike. Në këtë drejtim, është e nevojshme që komunat të kenë njësi për planifikim dhe zhvillim të politikave, si dhe të ngritën kapacitetet profesionale. Procesi i hartimit të dokumenteve strategjike me rëndësi për ekonominë lokale kërkon që hisedarët të përfshihen që nga fillimi i procesit të hartimit deri në fund, jo vetëm për “validim” të analizës dhe objektivave. Pjesëmarrja e grave dhe të rinjve duhet të inkurajohet. Gjithashtu, është e nevojshme që të krijohet një kornizë standarde për monitorimin e zbatueshmërisë së dokumenteve strategjike, sidomos për ato që lidhen me ekonominë. Për më tepër, strategjitë aktuale që dallojnë konsiderueshëm nga korniza strategjike nacionale, duhet të rishikohen, ashtu që të jenë në përputhje me dokumentet strategjike të nivelit qendror. Për të krijuar mundësi të revidimit, do të krijohet mundësia që të rishikohen Planet Zhvillimore Komunale (për shembull: përmes votimit me shumicë të kualifikuar). Për fund, por jo me më pak rëndësi, do të intensifikohet puna për finalizimin e hartave zonale komunale. Nuk ka ndonjë objektiv specifik në SKZH-së dhe PKZH-së që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë objektiv; e njëjta vlen edhe për SDG.

Aktivitetet:

- Fuqizimi i kapaciteteve për planifikim dhe zhvillim të politikave
- Ngritja e kapaciteteve profesionale brenda komunave për hartimin e dokumenteve strategjike
- Krijimi i kornizës standarde për monitorimin e zbatueshmërisë së dokumenteve strategjike dhe ndikimit të tyre
- Përfshirja e hisedarëve në hartimin e dokumenteve strategjike që nga fillimi i procesit
- Krijimi i mundësisë që të rishikohen Planet Zhvillimore Komunale
- Finalizimi i hartave zonale komunale
- Harmonizimi i strategjive komunale me strategjitë nacionale
- Ferizaj si qytet inteligjent(Smartcity).

7.4.5 Objektivi Specifik: Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal

Dialogu me komunitetin e biznesit, bashkëpunimi me nivelin qendror, si dhe krijimi i aleancave komunale përtëj kufijve janë të rëndësishme për adresim më të mirë të sfidave ekonomike dhe krijim të mundësive të përbashkëta për zhvillim. Për ta përmirësuar dialogun publiko-privat, është e nevojshme që të stimulohet krijimi i shoqatave lokale për përfaqësim të sektorit privat dhe të krijohen mekanizma për bashkëpunim sistematik me shoqatat e krijuara. Gjithashtu, duhet të krijohen politikat stimuluese për anëtarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, ashtu që të angazhohen më shumë në artikulimin e sfidave dhe nevojave për zhvillim të ekonomisë lokale. Për bashkëpunim ndërkomunal, duhet që të identifikohen fushat e përbashkëta me potencial zhvillimor dhe të përkrahet zhvillimi i tyre. Ngjashëm edhe tek rasti i bashkëpunimit komunal ndërkufitar. Tek bashkëpunimi me nivelin qendror, do të krijohet mekanizmi i veçantë për koordinimin e procesit të financimit të investimeve nga niveli qendror në nivelin lokal. Në terma të gjerë, ky objektivi specifik lidhet me Objektivin 10.3 të SKZH-së dhe PKZH-së, që ka për synim përmirësimin e performancës së komunave, si dhe përmbush SDG 17 (Partneritetet për qëllimet).

Aktivitetet:

- Identifikimi i fushave të përbashkëta me potencial zhvillimor në kuadër të bashkëpunimit ndërkomunal
- Stimulimi i krijimit të shoqatave lokale për përfaqësim të sektorit privat dhe krijimi i mekanizmave për bashkëpunim sistematik me shoqatat e krijuara
- Krijimi i politikave stimuluese për anëtarët e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane
- Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar.



7.4.6 Objektivi Specifik: Zhvillimi bujqësor, rural dhe mjedisor

Si një sektor me rëndësi të veçantë ku merr pjesë më shumë se 50% të ekonomisë së popullsisë, që jeton në zonat rurale dhe kontribuon në forma të ndryshme të rritjes ekonomike dhe të punësimit. Bujqësia, si një formë e veçantë me potencial për zhvillimi ekonomik vendor, gjen hapësirë të veçantë për realizimin e objektivave në këtë strategji, kur dihet se në nivelin e prodhimit të brendshëm bruto (PBB) bujqësia merr pjesë me 8%. Mbështetja e sektorit të bujqësisë nga niveli qendror dhe lokal bëhet përmes pagesave direkte dhe granteve nga sektori i bujqësisë për fermerët. Bujqësia ka arritur të ketë një zhvillim më të madh, pasi masat e zhvillimit rural kanë kontribuar në vetëpunësimin, njëkohësisht në rritjen e mirëqenies dhe cilësisë së jetës. Ndër sfidat kryesore me të cilat përballlet sektori i bujqësisë janë: sipërfaqet e vogla të prodhimit, përditësimi i rregullt i regjistrit të fermave, numri i madh i fermerëve me sipërfaqe të vogël parcelash, pronësia e tokave bujqësore, sistemet e ujitjes, ruajtja e përdorimit të tokës bujqësore dhe konsolidimi i tokës për nevojat e zhvillimit të bujqësisë, si dhe një pjesë e madhe e sipërfaqes së punueshme bujqësore të pa shfrytëzuar, përfshirë atë blegtorare.




Figura 8. Pjesëmarrja e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore në gjithsej sipërfaqen e komunës, Kosovë, 2014

Referuar hartës, pjesëmarrja e sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore në komunën e Ferizaj varion nga 50.1 – 60.0 % të total sipërfaqes së punueshme

Tabela 23. Treguesit kryesor bujqësor

Tokë Bujqësore /ha	16870 ha
Grurë	4800 ha
Misër	3400 ha
Pemë	520 ha
Perime	450 ha
Bimë foraxhere	2500 ha
Livadhe	4160 ha
Kullosa	590 ha
Djerrina	450 ha

Burimi: Drejtoria e Bujqësisë

Mbrojtja e Tokës bujqësore

Komuna ka zhvilluar objektivat në vazhdim për të përkrahur zhvillimin bujqësor:

- Aplikimi i ligjit mbi mbrojtjen e tokës bujqësore. Ndryshimi në shndërrimin nga toka bujqësore në tokë ndërtimore mund të bëhet vetëm duke e aplikuar ligjet e aplikueshme.
- Shfrytëzimi i drejtë i tokës bujqësore. Planet e Komunës për të rritur numrin e sipërfaqeve me vreshtari, pemë, dhe pyje, etj.
 - Pyllëzimi është prioritet për të mbrojtur sipërfaqet që janë të kanosur nga erozioni si dhe t'i pyllëzoj ato sipërfaqe që kanë pasur prerje masive të drunjëve.

Aplikimi i Teknologjisë Moderne

Komuna do të vazhdojë të hulumtojë për kushtet të volitshme të kredive që janë të përshtatshme për fermerët. Teknologjitë moderne bujqësore, sikurse serrat, do të rrisin prodhimtarinë, do të ruanin strukturën e tokës, do të zvogëlojnë shpenzimet, rrisin efikasitetin, dhe sigurojnë një furnizim të vazhdueshëm të tregut me prodhime vendore.

Përfshirja e varieteteve të reja të perimeve dhe përmirësimi racor në blegtori

- Ministria e Bujqësisë ka financuar fusha eksperimentale për mbjelljen e drithërave, grurit, sojës, pemëve dhe perimeve. Analizimi i këtyre fushave ka rritur prodhimtarinë. Andaj, Komuna do të inkurajoj fermerët për të vazhduar me këto varietete të farërave dhe do të përfshijë këto varietete në listën Kombëtare të farërave.
- DBP-se ka zhvilluar aktivitete të vazhdueshme duke furnizuar fermerët me lopë të racës simental si njëra ndër racat më të përshtatshme në klimën e rajonit të Ferizajt.

Sistemi i ujitjes

Aktualisht ujitjen 4% të tokës punuese respektivisht 630 ha. Ujitja bëhet përmes pompave dhe sistemit të ujitjes pikë-pikë, burimet e ujit kryesisht janë lumenjtë dhe pusët.

- Sistemi vadites/ujitës (menaxhimi i ujërave) i tokave bujqësore është si garantues i zhvillimit të bujqësisë.

Strategjia e ndërlidhur me objektivat globale të zhvillimit të qëndrueshëm për bujqësinë

Bazuar në targetin 2.3: Deri në vitin 2030 synojmë të dyfishojmë produktivitetin bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve të ushqimit në shkallë të vogël, veçanërisht grave, fermerëve familjarë dhe blegtorëve, duke përfshirë aksesin e sigurt dhe të barabartë në tokë, burime dhe inpute të tjera prodhuese, njohuri, shërbime financiare.

Sipas targetit 2.4: Deri në vitin 2030 synojmë të sigurojmë sisteme të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe të zbatohen praktika elastike bujqësore që rrisin produktivitetin dhe prodhimin, që ndihmojnë në ruajtjen e ekosistemeve, që forcojnë kapacitetin për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike, motit ekstrem, thatësirës, përmytjeve dhe fatkeqësive të tjera dhe që përmirësojnë në mënyrë progresive tokën dhe cilësinë e saj.

Rreferuar targetit 2.A: Synojmë të rrisim investimet, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar të zgjeruar, në infrastrukturën rurale, kërkimin bujqësor dhe shërbimet e ekstensionit, zhvillimin e teknologjisë dhe bankat e gjeneve të bimëve dhe blegtorisë me qëllim rritjen e kapacitetit prodhues bujqësor në komunën e Ferizaj.

Krijimi i hapësirave të reja për investime

-Zona Agro-Industriale dhe Linjave të përpunimit të produktit bujqësorë

Do të krijojmë Zonën Agroindustriale për bujqësi, blegtori dhe pemtari duke stimuluar dhe mundësuar që këta sektorë të zhvillohen më shumë. Në këto zona synojmë të krijojmë edhe linja përpunuese të produkteve bujqësore me qëllim që të zvogëlohet humbja e produktit bujqësor gjatë zinxhirit të furnizimit që tejkalon masën e mbi 30% për arsye të mungesës së infrastrukturës përpunuese

Tabela 24. Përpunimi i produkteve bujqësore

Përqindja e produkteve bujqësore që përfundojnë në mbeturina (kalben)	<30%
Përqindja e produkteve bujqësore që nënshtrohen përpunimit të metejshëm industrial	<50%

Aktivitetet:

- Krijimi i infrastrukturës rurale, zhvillimin e kërkimit bujqësor dhe shërbimet e ekstensionit, zhvillimin e teknologjisë dhe bankat e gjeneve të bimëve dhe blegtorisë me qëllim rritjen e kapacitetit prodhues bujqësor në komunën e Ferizaj
- Deri në vitin 2030 do të dyfishojmë produktivitetin bujqësor dhe të ardhurat e prodhuesve të ushqimit në shkallë të vogël, veçanërisht grave, fermerëve familjarë dhe blegtorëve, duke përfshirë aksesin e sigurt dhe të barabartë në tokë, burime dhe inpute të tjera prodhuese, njohuri, shërbime financiare.
- Sigurimi i infrastrukturës dhe sistemeve vadtëse si garantues për zhvillimin e bujqësisë
- Projekti për ekofshatërat
- Zhvillimi i mini fermave pas një studimi të fleksibilitetit
- Ngritja e qendrës së agrobiznesit
- Përkrahja me mekanizma bujqësor
- Rritja e sipërfaqeve për kultivimin e pemëve.



7.4.7 Objektivi specifik: Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal

Bujqësia dhe turizmi janë sektorë me interes vital për zhvillim lokal të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës. Të dy këta sektorë ndihmojnë ndjeshëm në krijimin e të ardhurave dhe vendeve të reja të punës, sidomos tek shtresat shoqërore më të cenueshme. Për të kontribuar në përmirësim të produktivitetit në bujqësi, është e nevojshme të rritet përkrahja përmes granteve për blerje të pajisjeve moderne. Duke qenë se paralizimi i tokave paraqet problem për ta ushtruar veprimtarinë në mënyrë të leverdishme, të njëjtat grante mund të përmbajnë kushte që e inkurajojnë bashkimin e parcelave. Krahë granteve, është e nevojshme të rritet edhe përkrahja në formë të subvencioneve, si dhe të punohet në thjeshtim të procedurave për aplikim. Si të grantet ashtu dhe të subvencionet, përkrahjes së grave duhet t'u kushtohet vëmendje të veçantë. Për më shumë, është e nevojshme të mbështetet formimi i kooperativave bujqësore moderne, duke u dhënë përparësi grave pronare. Zyrat këshilluese brenda komunave, duhet të fuqizohen për t'i ndihmuar më shumë fermerët lidhur me proceset e aplikimit për grante. Më tutje, është e nevojshme të ofrohen trajnime për fermerët që t'u ngritën aftësitë për kultivim më efikas të prodhimeve bujqësore. Njëkohësisht, avancimi i zinxhirëve të vlerës përmes pikave grumbulluese dhe formave bashkëpunuese duhet të jetë në mesin e prioritetëve të bujqësisë. Për ta promovuar turizmin, komunat duhet të punojnë në zhvillim të brendit të tyre turistik, ku përfshihet logoja, slogani, identiteti vizual dhe në përgjithësi narracioni turistik. Në këtë drejtim, themelimi dhe funksionalizimi i qendrave informative është gjithashtu i rëndësishëm për komunikim të ofertës turistike. Infrastruktura turistike, si për shembull qasja në destinacione, sinjalistika dhe të ngjashmet kanë nevojë për rregullim. Shumë hapësira të trashëgimisë kulturore nën menaxhim lokal kanë nevojë të restaurohen dhe rimodelohen, ashtu që, veç tjerash, t'i shërbejnë ekonomisë kreative. Në fund, por jo me më pak rëndësi, nevojitet përkrahje për zhvillimin e produkteve që promovojnë agroturizmin. Ky objektivi specifik lidhet me Objektivin 1.7 të SKZH-së dhe PKZH-së, që synon përmirësimin e produktivitetit dhe qëndrueshmërisë në bujqësi. Turizmi nuk trajtohet si objektivi i veçantë të SKZH-jë dhe PKZH-jë, por hyn në kuadër të Objektivit 1.3, që synon të krijojë produkte dhe shërbime me vlerë të shtuar.

Aktivitetet:

- Ofrimi i granteve për pajisje në bujqësi me kusht bashkimin e parcelave
- Rritja e subvencionimit direkt në bujqësi me procedura më të thjeshtuara
- Ofrimi i mbështetjes për formimin e kooperativave bujqësore moderne me fokus të veçantë për gratë pronare
- Fuqizimi i zyrave këshilluese për t'i ndihmuar fermerët në proces të aplikimit për grante
- Trajnime për fermerët për ngritje të aftësive për kultivim më efikas të prodhimeve bujqësore
- Përmirësimi i zinxhirit të vlerës në bujqësi përmes përkrahjes së pikave grumbulluese
- Brendimi turistik i komunave (logoja, slogani, identiteti vizual dhe narracioni turistik në përgjithësi)
- Trajnim i prodhuesëve të rinjë bujqësor
- Rritja e sipërfaqeve për kultivimin e kulturave bujqësore në ambiente të mbrojtura-serra
- Ngritja profesionale e fermerëve për zhvillimin e një bujqësie sa më intensive
- Përkrahja në ngritjen e kapaciteteve për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore.



7.5 OBJEKTIVI 5: ZHVILLIMI I TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

Turizmi është një nga industritë me rritje më të shpejtë në botë dhe një burim i rëndësishëm i këmbimit valutor dhe i punësimit, ndërsa është i lidhur ngushtë me mirëqenien sociale, ekonomike dhe mjedisore veçanërisht të vendeve në zhvillim siç është Kosova dhe komuna jonë. Organizata Botërore e Turizmit e përkufizon turizmin e qëndrueshëm si “turizëm që merr parasysh plotësisht ndikimet e tij aktuale dhe të ardhshme ekonomike, sociale dhe mjedisore, duke adresuar nevojat e vizitorëve, industrisë, mjedisit dhe komuniteteve pritëse”.

Strategjia zhvillimore e komunës së Ferizaj synon zhvillimin e Turizmit të Qëndrueshëm në harmoni me agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm duke iu referuar dhe siguruar:

Targetin 8.9 i zhvillimit të qëndrueshëm: Nëpërmjet të cilit synojmë të hartojmë dhe zbatojmë politika për të promovuar turizmin e qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën dhe produktet lokale.

Turizmi identifikohet gjithashtu si një nga sektorët e mundësive për të rritur përfitimet ekonomike për vendet dhe komunitetet e vogla në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara që i takojmë edhe neve si komunë. Turizmi i qëndrueshëm përkufizohet si një kontribues i rëndësishëm falë lidhjeve të tij të ngushta me sektorë të tjerë dhe aftësisë së tij për të krijuar vende pune të denja dhe për të gjeneruar tregti. Prandaj, neve si komunë njohin nevojën për të mbështetur aktivitetet e turizmit të qëndrueshëm dhe ngritjen e kapaciteteve përkatëse që promovojnë:

- ndërgjegjësimin mjedisor,
- ruajnë dhe mbrojnë mjedisin,
- respektojnë jetën e egër, florën, biodiversitetin, ekosistemet
- promovojnë diversitetin kulturor, si dhe
- përmirësojnë mirëqenien dhe jetesën e komuniteteve lokale duke mbështetur ekonominë e tyre lokale dhe mjedisin njerëzor dhe natyror të komunës në tërësi.

Në këtë aspekt do të bëjnë thirrje gjithashtu për mbështetje të shtuar për aktivitetet e turizmit të qëndrueshëm dhe ndërtimin e kapaciteteve përkatëse, në mënyrë që të kontribuojnë në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm.

Nëpërmjet strategjisë tonë zhvillimore do të “inkurajojnë nxitjen e investimeve në turizmin e qëndrueshëm, duke përfshirë eko-turizmin dhe turizmin kulturor, i cili mund të përfshijë krijimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe lehtësimin e aksesit në financa, duke përfshirë iniciativat mikrokredie për popullsinë e varfër vendase (si një forcë për zbutjen e varfërisë) dhe komuniteteve lokale në zonat me potencial të lartë eko-turizmi”. Në këtë drejtim, do të “theksojnë rëndësinë e krijimit, aty ku është e nevojshme, të udhëzimeve dhe rregulloreve të përshtatshme në përputhje me prioritetet kombëtare dhe legjislacionin për promovimin dhe mbështetjen e turizmit të qëndrueshëm”.

Tabela 25. Ofertat turistike në Ferizaj

Natyror	Antropogjen
Turizmi malorë	Tregtar
Dukuri natyrore (bifurkacioni, trifurkacioni)	Gastronomia
Ekoturizmi	Jeta e natës
Agroturizmi	Kulturor

Tabela 26. Zhvillimi i produkteve dhe destinacioneve turistike

Infrastruktura ligjore	Infrastruktura e fortë	Zhvillimi i produkteve dhe destinacioneve turistike	Marketingu	Menaxhimi
Bashkëpunimi me ministrin e ambientit duke u bazuar në ligjin për mbrojtjen e natyrës, për shpalljen apo kategorizimin e zonave me statuse të veçanta (bifurkacioni, Trifurkacionin “Monument natyre”). Orientimi i investimeve publike. Mbështetja e politikave bujqësore që nxisin dhe gjallërojnë bujqësinë e legjorinë	Nxitja e investimeve të infrastrukturës nëntokësore e mbitokësore	Përcaktimi i zonave për investime. Mbështetja e fermerëve aktual dhe zhvillimi i tyre. Nxitja e investimeve publike nga drejtoritë përkatëse. Lejimi dhe nxitja e investimeve private. Mbështetja e fermerëve aktual dhe gjetja e fermerëve të ri Trajnime profesionale	Promovimi për mes internetit, broshurave, emisioneve edukative, argëtuese. Lobimi në shkolla të ndryshme sifenomene natyrore Krijimi i ofertave në agjencitë e shteteve për rreth e sidomos të shtetit shqiptarë	Kompetencat e menaxhimit. Kujdesi për mbrojtjen e ambientit. Inkuadrimi i grupeve të ndryshme të interesit. Trajnime për stafin e menaxhimit



7.5.1 Objektivi Specifik: Turizmi natyror

Turizmi malor – Zonat natyrore dhe rurale në komunën e Ferizajt dhe rajonit përreth ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit rural, malor, ekoturizmit, agroturizmit dhe veprimtarive në natyrë (çiklizmi malor, peshkimi, ngjitjet alpine, ecja në natyrë–hiking, pika shqimi, shëtitja me kuaj, lëshime ne sajle –zip line, teleferik, turret e nxënësve e studimore etj). Disa prej këtyre veprimtarive janë motivi kryesor i vizitave nga vizitorët vendor të huaj në zonat natyrore.

Këto zona janë malet për rreth Ferizajt e regjionit. Vargmalet nga Caraleva, Dramijaku, Jezerci, Pleshina Kashtanjeve përveç motivit natyror ka edhe motive historike e antropogjenë. (hapja e shtigjeve dhe promovimi i tyre me shenjëzime për hiking, lufta e UÇK-s).

Malet lindore kanë një pasuri të Florës e Faunës ku gjithashtu kanë filluar të vizitohen fal infrastrukturës rrugore dhe fillimi i bizneseve të gastronomisë.

Për shkak dinamikës së madhe urbane, stresit, zhurmës, ndotjes, mungesës hapësirës së gjelbër çdo ditë po shtohet nevoja për pushim, relaksim, nga turistë vendor, rajonal e ndërkombëtar. Andaj është një potencial i madh për këtë lloji turizmi në komunën tonë.

Krijimi i lehtësirave për marrjen e lejes për atraksione turistike si psh: zip line, platoja shikuese, etj

Dukuritë natyrore – Monumentet e natyrës

Brenda rajonit tonë janë dy fenomene natyrore të veçanta dhe unike në Botë. “Bifurkacioni Nerodimës” dhe trifurkacioni “Suka Dermanit” në Jezerc.

Bifurkacioni është një fenomen natyror unikat, i vetmi në Evropë me rëndësi të madhe hidrologjike, dhe me një potencial të madh turistik. Pozita e Bifurkacionit afër qytetit me një lartësi mbidetare 586 metra ka bërë shpejt të qasshëm dhe të lehtë. Bifurkacioni në vitin 1979 nga kuvendi komunal i kohës e fiton statusin “zonë e mbrojtur”, kurse duke u bazuar në ligjin për Mbrojtjen e Natyrës është në proces për tu shpallur në kategorinë “Monument të Natyrës me Rëndësi të Veçantë”

Objektivat për ta përmirësuar -nxitur turizmin në këtë zonë:

- Rivitalizimin e shtratit të lumenjve sidomos degës së majtë të lumit që krijon lumin Sazlika – dega e majtë e bifurkacionit
- Ruajtja e zonës nga ndërtimet
- Përdorimi i zonës për qëllime edukative, arsimore e shkencore
- Rivitalizimi dhe aktivizimi i mullirit
- Promovimi e marketingu

Trifurkacioni – “Suka Dermanit” është një fenomen i jashtëzakonshëm unikat i cili ne terma shkencor quhet si kyçi hidrografik i Kosovës. Kjo pikë- kodër e ndan ujin në tri pellgje (detra) të ndryshëm:

Pjesën veriore nga këtu mblidhet uji dhe krijimi i lumit Topillës pastaj Shtimjankës –Stnicës-Ibër e në detin e Zi.

Në drejtim të jug-lindjes krijohet lumi Nerodime-Lepenc- e ne detin Egje kurse në drejtim të perëndimit krijohet Toplluha që ju bashkohet Drinit të Bardhë- ku përmes ti derdhet në detin Adriatik.

Objektivat për ta përmirësuar -nxitur turizmin në këtë zonë:

- Shtytje të krijimit të shpalljes së zonës “Monument të Natyrës me Rëndësi të Veçantë” sikur bifurkacioni.
- Potencial i madh të krijimit të një pike identifikuese me karakter shkencor, edukativ e arsimor.
- Shtigje e shënjim të ecjeve të Jezercit
- Ruajtja e zonës nga ndërtimet
- Krijimi i mundësive të kampingjeve etj.

Ekoturizmi - është një turizëm natyror që përfshin eksplorimin e natyrës duke e ruajtur dhe shijuar atë pa rrezikuar ekosistemin. Ekoturizmi mëton që të nxisë aktivizimin ekonomik e social të banorëve vendas duke promovuar e bashkëndejë së bashku me mysafirët.

Definicioni: Udhëtim për të shijuar larmishmërinë e magjishme të botës, jetën natyrore dhe kulturën humane të saj, pa shkaktuar dëmtim të ndonjëres prej tyre. Tickell (1994, p. ix)

Ekoturizmi hynë në grupin e turizmave të qëndrueshëm, që kanë në fokus mbrojtjen e natyrës dhe punësimin e popullsisë vendase.

Ekoturizmi thekson përfitimin ekonomik të banorëve vendas, duke i trajnuar ata për të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe për të punuar si udhërrëfyes për turistët apo shkencëtarët që duan të vizitojnë këto zona të egra natyrore, të ofrojnë produkte tradicionale, akomodim etj.

Ekoturizmi synon të edukoj e vlerësoj të mirat natyrore që ka vendi nga banoret vendas, e ti transmetoj ato tek të mysafirët për ruajtjen e kujdesin për natyrën. Të gjitha këto masa duhet të jenë në harmoni në mes investimeve infrastrukturore, turizmit dhe mjedisit e ekosistemit.

Objektivat për ta përmirësuar -nxitur turizmin në këtë lloj turizmi:

- Inkurajimi i bizneseve lokale për të ofruar shërbime dhe produkte të bazuara në ekoturizëm, sipas parimeve të ndikimit të qëndrueshëm dhe të ulët në mjedis.
- Duhet orientime bujqësore e blegtorale subvencione që synojnë arritjen e këtij qëllimi
- Riaktivizimi i mullinjve me ujë së bashku me bujtina e me restorante tradicionale
- Ferma ku turistët marrin shërbime të akomodimit, ushqimit, shëtitje etj, por mund të aktivizohen edhe në punët shtëpiake të fermës, etj.
- Trajtime të ndryshme profesionale të banorëve e fermerëve
- Vila shtëpi tradicionale e Oda me qera
- Festalet tradicionale autoktone si dita e plisit, e ushqimeve tradicionale etj
- Këto masa do të siguronin të ardhurave direkte për ruajtjen dhe menaxhimin e zonave natyrore dhe të mbrojtura.
- Fshatrat që kanë këto potenciale janë kryesisht fshatrat malore e kodrinore kryesisht rreth maleve perëndimore edhe atyre lindore të komunës sonë.
- Kush janë turistët?
- Popullsia urbane vendore, rajonale, e perëndimore, diaspora jonë, grupet shkollore



Agroturizmi përfshinë çdo operacion ose aktivitet me bazë bujqësore që sjellë vizitorë në një tokë-vend bujqësorë dhe fermë blegtorale.

Qëllimi i agroturizmit është përfshirja e disa kategorizimeve zhvilluese si: shitje direkt te konsumatori (p.sh., stendat e fermave, mbledhja e frutave), edukimi bujqësor (p.sh. shkolla vizitat në një fermë), mikpritja (qëndrimet në fermë gjatë natës, bujtja konsumimi i ushqimit etj), argëtimi (p.sh. si puna në fermë, ecja, çiklizmi, kalërimi etj) Fshatrat tradicionale autentike tradicionale.

Agroturizmi është një fushë që po rritet në popullaritet në Botë pasi prodhuesit po përpiqen të diversifikojnë dhe rrisin fitimet përmes ofrimit edhe të hotelerisë e gastronomisë.

Duke ndërthurur bujqësinë dhe turizmin, agroturizmi ofron burime të reja të ardhurash, por gjithmonë duhet ruajtur harmoninë sepse paraqet probleme në humbjen e vlerës së të natyrshmes. Agroturizmi në komunën tonë mund dhe ka potencial të zhvillohet shumë mirë pasi që vitet e fundit kemi një tendencë të shtimit të agrobizneseve familjare në fshatra të ndryshme të komunës sonë si dhe ferma kafshësh, e shpezë të ndryshme. Nëse krijohet një bashkëpunim duke i mbështetur me politika zhvillimore të ndryshme ato do të kthehen edhe në pika e në atraksione turistike.

Objektivat për ta përmirësuar -nxitur turizmin:

- Identifikimi dhe krijimi i profileve për agrobizneset dhe fermat aktuale
- Programe që nxisin agrobiznese
- Zyra që ofrojnë trajnime dhe ndihmë në krijimin e pan bizneseve për të thithur fonde nga organizatat e ndryshme.
- Inkurajimi i bizneseve lokale për të ofruar shërbime dhe produkte të bazuara në agroturizëm, sipas parimeve të ndikimit të qëndrueshëm dhe të ulët në mjedis.
- Riaktivizimi i mullinjve me ujë së bashku me bujtina e me restorante tradicionale
- Ferma ku turistët marrin shërbime të akomodimit, ushqimit, shëtitje etj, por mund të aktivizohen edhe në punët shtëpiake të fermës, etj.
- Trajnime të ndryshme profesionale të banorëve e fermerëve



Aktivitetet:

- Krijimi dhe funksionalizimi i qendrave informative për promovimin e turizmit lokal
- Përmirësimi i infrastrukturës lokale në zonat turistike
- Restaurimi i hapësirave të trashëgimisë kulturore dhe rimodelimi i tyre për ta promovuar
- Promovimi i kapaciteteve turistike të komunës së Ferizajt
- Vazhdimi i rregullimit të shtratit të lumit Neredime
- Fuqizimi i turizmit rural
- Promovimi i turizmit përmes virtualizimit të Qytetit të Ferizajt
- Wi-fi falas në hapësirat publike



7.5.2 Objektivi Specifik: Trashëgimia Kulturore

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore duke forcuar çdo përpjekje për ta mbrojtur dhe promovuar atë.

Turizmi antropogjen

Zona më e re urbane me rritjen më të shpejtë që po vazhdon edhe sot në Kosovë pa dyshime është Ferizaj. Historia e Ferizajt është e lidhur me transportin, tregtinë e shërbimet që edhe sot vazhdon të jetë atraktive e me një potencial te jashtëzakonshëm.

Një pjesë e madhe e rajonit përreth, por edhe jashtë shtetit destinacion kryesorë e kanë Ferizajn për tregti, shërbime, argëtim rekreacion e gastronomi.

Tregtia – ka lidhje me krijimin e qytetit e hekurudhës. Ajo fillimisht ka qenë e koncentruar në qendër të qytetit. Më vonë ajo ka filluar të shpërndahet në rrugët hyrëse të qytetit. Duke u rritur qyteti është për shkak të lindjes së industrisë edhe banimi, e më këtë rast është rritur edhe tregtia.

Për shkak ofertës së madhe prodhuese, tregtare e shërbyese që ofron qyteti e komuna janë ajo tërheq shumë njerëz nga vise të ndryshme të cilët shpesh herë kalojnë një kohë në Ferizaj, andaj duhet shfrytëzuar këtë potencial për t'ju ofruar sa më shumë oferta rekreative turistike.

Gastronomia – Ushqimi apo restorantet kanë krijuar një reputacion shumë të mirë në qytetin tonë dhe komunën në përgjithësi.

Restorantët mbrenda qytetit si dhe jashtë qytetit po tërheqin një numër të konsiderueshëm të njerëzve nga komunat tjera. Mendoj që duhet standartizim e licensime në sasi dhe kualitet të shërbimeve që niveli i shërbimit e kualitetit të rritet sa më të lartë.

Jeta e natës – Jeta e natës në Ferizaj është shumë e pasur jo vetëm në aspektin rajonal por edhe më gjërë. Qendra e qytetit dhe qendrat tregtare “The Village” dhe “Ring Mall” po krijojnë e po tërheqin klientelë të të gjitha moshave si familjare, për fëmijë e për rininë. Ky potencial i madh i njerëzve duhet ruajtur e tërhequr sa më shumë.

Gjithashtu ofertat e klubeve të natës janë mjaft të pasura, sidomos gjatë kohës së verës. Këto oferta tërheqin klientelë nga pothuajse krejt Kosova e edhe nga Maqedonia.

Objektivat për ta përmirësuar -nxitur turizmin në këtë lami:

- Lidhshmëria në mes bizneseve
- Lehtësirat për pajisje me leje dhe operime tjera
- Trajnime të stafit të lokalëve tregtare, hotelëve restorantëve e klubeve të natës

Turizmi kulturor

Turizmi kulturor ndahet në atë fizik e shpirtërorë.

Turizmi kulturor fizik mund identifikohen disa objekte siç janë: Ndërtesa e Stacionit hekurudhor, Xhamitë, kisha katolike e ortodokse, objektet e vjetra kulturore bibliotekat, teatri, hotel Lybetni etj. Këto objekte duhen të mbrohen me statuse të veçanta si objekte identitare historike të qytetit, gjithashtu duhet ruajtur e restauruar. Përveç objekteve në qytet janë edhe shumë objekte historike e kulturore nëpër fshatrat përreth.

Turizmi kulturor shpirtëror është mjaft tradicional në Ferizaj siç është festivali “Kosovarja këndon”, e grupe tjera të muzikës e artit, por edhe në vitet e fundit janë krijuar një numër i madh i festivaleve kulturore siç janë: java e diasporës, festivali i teatrove, i filmit, i muralëve, java kulturës etj.

Këto festivale duhet financuar promovuar e pasuruar që të sjellim sa më shumë mysafirë në qytetin tonë.

Aktivitetet:

- Restaurimi i hapësirave të trashëgimisë kulturore dhe rimodelimi i tyre për ta promovuar ekonominë kreative
- Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore
- Krijimi i regjistrit elektronik të monumenteve kulturore, historike dhe arkeologjike.

Shfrytëzimi i Kapitalit Ekzistues të Komunës

Me kapital komunal nënkuptojmë resurse natyrore dhe njerëzore sikurse:

- a) Toka që është pronë e Komunës
- b) Godinat që mund të përdorën për qëllime të biznesit
- c) Infrastruktura: rryma, uji, mbeturinat, shkollat, objektet për kujdes shëndetësor, etj
- d) Punëtorët e kualifikuar, ekspertët nga Komuna
- e) Prodhimin e energjisë nga burime të rinovueshme si dielli, era ose uji.

Pronarët e bizneseve do të përfitonin nga përdorimi në ngritje të këtij kapitali, sikurse që do të rritej numri i punëtorëve të punësuar në këto biznese. Në përgjithësi, qasja më e lehtë e kapitalit komunal do të përmirësojë kualitetin e jetës

Rregulloret Komunale për Stimulimin e Bizneseve dhe Ndalimin e Investimeve të gabuara

Tregu i ekonomisë lejon investimet, edhe nëse biznesi nuk ka gjasa për sukses. Komuna mund të ndihmojë në parandalimin e investimeve të gabuara dhe do të ishte mbrojtës së bizneseve ekzistuese. Për shembull, nëse ekziston një numër i madh i pompave të karburanteve, Komuna mund të refuzojë lejen për ndërtim nëse nuk i përmbush kushtet e ndryshme për biznes siç janë rregullat e planifikimit urban, përcaktimi i tokës nga bujqësore në atë për ndërtim, standardet e mbrojtjes së ambientit, etj. Në anën tjetër, aktivitetet që janë të orientuara në prodhimtari do të jetë një prioritet i lartë dhe rregulloret mund të zhvillohen për të stimuluar formimin e bizneseve të reja përderisa i mbrojnë bizneset ekzistuese.



Objektivat prioritare për zhvillimin dhe implementimin e strategjisë

Qëllimet në vijim janë zgjedhur për zhvillim të mëtutjeshëm. Ekipet për veprim janë formuar dhe plan-et provuese të veprimit janë zhvilluar për të përgatitur projekt propozimet.

PROJEKTET PRIORITARE PER ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOMUNËS FERIZAJ					
Prioritet	Arsimi	Infrastruktura	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	Zhvillimi Ekonomik Bujqësor dhe Rural	Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore
1	Digjitalizimi i shkollave	Zhvillimi i transportit urban të integruar, ekologjik dhe gjithëpërfshirës	Zhvillimi i infrastrukturës shëndetësore gjithëpërfshirëse	Përkrahja e bizneseve të reja për grupmosha të reja dhe gratë sipërmarrëse	Zhvillimi i infrastrukturës fizike për turizëm
2	Zhvillimi profesional i mësimeve të arsimit – arsimit të përgjithshëm dhe aftësimi profesional	Funizimi i të gjitha zonave me ujë të pijshëm	Sigurimi i burimeve njerëzore (mjek, infermierë, dhe personel) sipas udhëzuesve	Zgjerimi i hapësirave për zhvillim ekonomik	Krijimi i lehtësirave administrative për investime në turizëm
3	Asistencë sociale në shkollë – asistentë për FNV, psikolog, sociolog etj.	Gjithëpërfshirja në trafik të integruar dhe ekologjik	Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i stafit	Krijimi i lehtësirave për shfrytëzimin e energjisë së ripërtirshme	Digjitalizimi i shërbimeve turistike.
4	Nevoja për asistencë sociale (psikolog, sociolog etj.)	Menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza	Fuqizimi i Edukimit dhe Promovimit Shëndetësor në komunitet	Deri në vitin 2030 të rritet me 50% përdorimi tokës së punueshme bujqësore dhe blegtorale krahasuar me 2023	Wi-fi falas në hapësirën publike
5	Sigurimi i shkollave me energji 100% të ripërtirshme		Të bëhet listimi i pacientëve sipas zonimit për mjekë dhe rregullimi i sigurimeve shëndetësore;	Deri në vitin 2030 të dyfishohet toka bujqësore e ujitur.	Fuqizimi i turizmit rural
6	Zbatimi i kurrikulës së re – sigurimi i cilësisë në shkollë		Implementimi i Udhëzuesve klinik dhe monitorimi i tyre nëpërmjet auditeve nga Koordinatori i Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore	Ruajtja, menaxhimi dhe zhvillimi i tokave bujqësore	Promovimi i turizmit përmes virtualizimit të Qytetit të Ferizajt
7	Siguria në shkollë		Siguria në Institucione Shëndetësore	Lehtësira për bizneset prodhuese- Të rritet numri i bizneseve prodhuese për 30%	Identifikim i të gjitha pikave të veçanta turistike.
8	Gjithëpërfshirja e nxënësve në shkollë			Organizimi i takimeve me biznese nga diaspora	

Tabela – Plani për Veprim për Idetë të Projekteve Prioritare për Zhvillimin Rural dhe të Bujqësisë – Komuna Ferizaj

Emri i aktivitetit	Aplikuar nga	Përkrahur nga	Data e fillimit	Data e përfundimit	Rezultatet e pritura	Komentet
Deri në vitin 2030 të rritet me 50% përdorimi tokës e punueshme bujqësore dhe blegtorale krahasuar me 2023	Drejtoria e Bujqësisë	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Komuna	Janar 2024	Dhjetor 2029	Rritje me 50% të prodhimit Bujqësor dhe Blegtoral	
Deri në vitin 2030 të dyfishohet toka bujqësore e ujitur.	Drejtoria e Bujqësisë	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Drejtoria e Financave dhe fermerët	Varësisht nga aprovimi i bazës ligjore	Për tu diskutuar		Donatorët dhe Komunitat marrin pjesë me 30% në këtë projekt
Vreshtat mbjellja e drurëve të pemëve	Drejtoria e Bujqësisë	Ministria Bujqësia dhe Zhvillimi Rural, Bujqit, Komuna, Ndërmarrjet dhe Shoqëria		Për tu diskutuar		
Pylltaria	Drejtoria e Bujqësisë	Njësitë Pyjore, Agjencioni Pyjor, Komuna OJQ-të		Për tu diskutuar	Përcakton pyllëzimin që nevojitet në Komunë dhe veprimet që duhet marrur	


PLANI I VEPRIMIT 2024-2026 PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2024-2034

Objektivi I përgjithshëm 1: ZHVILLIMI I ARSIMIT									
Objektivi specifik 1.1 Sigurimi i cilësisë dhe Infrastruktura fizike	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbytjes së objektivit		Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026				
	Afati për zbatim	Kostoja totale							
Aktiviteti			Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të bëhet)	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse				Rezultati
1) Ndërtimi dhe përmirësimi i shkollave gjithëpërfshirëse dhe të sigurta. Ndërtimi dhe përmirësimi i objektet arsimore që janë të ndjeshme ndaj fëmijëve, aftësisë së kufizuar dhe gjinisë së ofrimit mjedise të sigurt, jo të dhunshme, përfshirëse dhe efektive për të gjithë. Të gjitha shkollat të kenë përmirësim dhe ashen-sorin për çasje të sigurt për nxënësit me nevojë të veçanta	2025	295,000.00€	Komuna e Ferizajt	Drejtoria e Arsimit	Drejtoria e Arsimit		Perfunduar		Plotësimi i kushteve më të mira infrastrukturore për mbajtjen e procesit asimor

2) Sigurimi i transportit për të gjithë fëmijët në zona rurale që udhëtojnë në këmbë në shkollë.	2024-2026	155,000,000€	Komuna e Fierzajt		Drejtonia e Arsimit	Drejtonia e Arsimit	Pjesërisht	Përfunduar	Plotësimi i nevojave të nxënësve duke i ofruar edhe një siguri të udhëtimit e cila ndikon edhe në kohë optimale
12 Objektiv Specifik: TIK-u dhe mjetet e konkretizimit									

Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i finansimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të cekjet)	Gjendja bazë	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
1) Zgjerimi i bursave të arsimit të lartë për maturantët me rezultate të larta duke synuar të zgjerohet ndjeshëm ofrimin e bursave të disponueshme, për regjistrim në arsimin e lartë, duke përfshirë regjistrim në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, tekniko inxhinierinë, biznes dhe ekonomi si dhe në programe shkencore dhe sociale.	2024-2025	600,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Arsimit	Drejtoria e Arsimit	Pjesërisht	Përfunduar		Plotësimi i nevojave të studenteve duke i ofruar mbështetje financiare për realizimin e nevojave të tyre të cilat paraqiten gjatë udhëtimit të tyre studentor

2) Rritja e fondit për bursa jo vetëm për student të regjistruar bachelori, por edhe për studentët master dhe kandidatët për doktoraturë.	2026	50,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Arsimit	Drejtoria e Arsimit		Përfunduar	Plotësimi i nevojave të studenteve duke i ofruar mbështetje financiare për realizimin e nevojave të tyre të cilat paraqiten gjatë udhëimit të tyre studentor drejt realizimit të enderres së tyre për të fituar titullin bachelor/-master ose doktor shkence
---	------	------------	-------------------	--	---------------------	---------------------	--	------------	--



Objektivi i përgjithshëm 2: ZHVILLIMI I INFRASTRUKTURËS										
Objektivi specifik 2.1 Zhvillimi i transportit të qëndrueshëm	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit			Gjendja bazë	Drejtoria udhëheqëse	Drejtoria mbështetëse	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
	Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i financimit-it (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)							
Aktiviteti										
1)Përmirësimi i infrastrukturës sinjalistike në komunikacion	2024-2026	700,000.00€	Komuna Ferizaj		Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Pjesërisht	Pjesërisht	Përfundon	Plotësimi i nevojave të trafikut ku respektimi i tyre nga ana e shoferëve ndikon në ofrimin me të sigurt të komunikacionit
2)Krijimi i hapësirave të reja të parkingut publik	2024-2025	40,000.00€	Komuna Ferizaj		Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Pjesërisht	Përfundon		Qasje më e lehtë për këmbësorët pasi që në këtë aktivitet lirohen trotuarët e cila ka ndikim impakt në lëvizjeën e lirë

2.2Objekti Specifik: Menaxhimi i integruar i mbeturinave				Gjendja bazë	Drejtoria e udhëheqëse	Drejtoria e mbështetëse	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
	Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i financimit-it (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)							
1) Rritja e vetëdijes për dobritë e menaxhimit dhe rëziklimit të mbeturinave	2025	10,000.00€	Komuna Ferizaj		Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës		Përfundon		Krijimi i një ambienti më të pastërt, vetëdijësi i individit për reciklim, zvogëlimi i sasisë

2) Ofrimi i granteve për inovacion që e promovojnë parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbeturinave, me fokus të veçantë në gjetjen e alternativave ndaj am-balazhit dhe produkteve plas-tike	2025	150,000.00€	Komuna Ferizaj		Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës		Përfundon	Krijimi i një ambienti më të pastërt, vetëdijësimi i individit për reciklim, zvogëlimi i përdorimit të produkteve të plastikës
3) Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit privat dhe komuneve në trajtim, riciklim dhe ripërdorim të fraksioneve të caktuara të mbeturinave.	2025	10,000.00€	Komuna Ferizaj		Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës		Përfundon	Krijimi i një ambienti më të pastërt, vetëdijësimi i individit për reciklim



Objektivi i përgjithshëm 3: ZHVILLIMI I SHENDETESISË DHE MIREQENIES SOCIALE												
Objektivi specifik 3.1 Sigurimi i jetës se shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat	Treguesi (treguesit) për matjen e për mbushjes së objektivit		Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i financim- it ^(nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)	Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetë se	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
1)Rritja e financimit ne infrastrukturen shëndetësore dhe mbështetjen e resurseve shendetësore nepermjet rekrutimit, zhvil- limit, trajnimit dhe mbajtjes së tyre.	2024-2026	1,507,296 .00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Shendetë- sisë dhe e Mireqenies Sociale	Drejtoria e Shendetë- sisë dhe e Mireqenies Sociale	Pjesërisht	Pjesërisht	Përfunduar	Kushte më të mira në insti- tucionet shën- detësore, staf më profesional		

2) Sigurimi i aksessit në shërbimet e kujdesit shëndetësor riprodhues, duke përfshirë planifikimin familjar, informacionin dhe edukimin dhe integrimin e shëndetit riprodhues në strategjitë dhe programet lokale.	2024	2,800.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale	Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale	Përfunduar			Qytetarët më të informuar, vetëdijësim për rëndësinë e shëndetit riprodhues
3) Formimi i Qendrës së thirrjes Urgjente (112) me ndërlidhje të përbashkët të ekipit mjekësor të emergjencës primare, policisë dhe zjarrëfikësve	2025	50,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale	Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale	Përfunduar			Reagim në kohë më optimale në raste të ndryshme emergjente

3.2 Objektivi Specifik: Punësim gjithëpërfshirës	Kostoja totale		Burimi i finansim- it (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)	Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetë se	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati	Aftësim në kryerjen e detyrave të punës në kohë më optimale dhe me më efikasitet të lartë e cila ndikon në produktivitetin në vendin e punës për secilin puntorë
	Afati për zbatim										
1) Mbështetja e trajnimeve në vend të punës ose formave tjera të trajni- meve	2025	5,000. 00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Shendetë- sisë dhe e Mireqenies Sociale	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Përfunduar			

2) Krijimi i këshil- leve komunale për artikulim të nevojave të sektorit privat	2025	5,000.00€	Komuna e Ferizaft		Drejtoria e Shëndetë- sisë dhe e Mirëqenies Sociale	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Tur- izmit		Përfund uar	2025	Informacione rreth nevojave të sektorit privat dhe plotësimi i këtyre nevojave
---	------	-----------	----------------------	--	---	--	--	----------------	------	--

3.3 Objektivi Specifik: Zvogëlimi i hendetkut të shkath- tësive në tregun e punës				Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetë se	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
	Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i financim- it ^(nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)							
1) Mentorimi i të rinjëve dhe grave të papuna për t'iu përmirësuar mundësitë për vetëpunësimplanifi- kimin familjar, informacionin dhe edukimin dhe integrimin e shën- detit riprodhues në strategjitë dhe programet lokale.	2025	5,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Shendetë- sisë dhe e Mireqenies Sociale	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Përfundon		Zvogëlimi i papunësisë dhe avancimi i grave dhe të rinjëve në tregun e punës

2) Krijimi i panairëve të punës me fokus punësimin e grave dhe të rinjëve	2025	5,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Shëndetësisë dhe e Mirëqenies Sociale	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Përfunduar		Zvogëlimi i papunësisë, avancimi në tregun e punës, mundësi komunikimi me biznese të shumta
---	------	-----------	-------------------	--	---	--	--	------------	--	---

Objektivi i përgjithshëm 4: ZHVILLIMI EKONOMIK, BUJQËSOR DHE RURAL												
Objektivi specifik 4.1 Rritja e investimeve në fushat me potencial për zhvillim ekonomik lokal	Treguesi (treguesit) për matjen e përmbushjes së objektivit		Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i finansimit-it (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)	Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetëse	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
1)Ngritja e resurseve njerëzore brenda komunës për t'i promovuar investimet	2025	10,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Përfundon					Resurse më të larta, investime më të mëdha

2) Hartimi i profilit ekonomik dhe materialeve të tjera promovuese të komunës së Ferizajt ku tregohen potencialet për investime	2024	5,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Përfundon		Tërheqje e vizitorëve dhe investitorëve të ndryshëm
3) Ngritja e kapaciteteve komunale për qasje në fond-eve zhvillimore	2025	5,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Përfundon		Njohuri më të mira për fondet zhvillimore

4) Krijimi i parqeve industriale të specializuara me veçori miqësore për mjedisin	2026	100,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Ministria e Industrisë ndërmarrësisë dhe tregtisë		Përfundon	Zhvillim industrial më i avancuar
5) Përkrahja e komuniteteve (minoriteteve) në biznes	2024-2025	30,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Pjesërisht	Përfundon	Zhvillim i bizneseve të ndryshme, gjithëpërfshirja në punë

6) Organizimi i takimeve B2B për bizneset vendore dhe ndërkombëtare	2025-2026	20,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Ministria e industrisë ndërmarrësisë dhe tregtisë		Pjesërisht	Përfundon	Shkëmbimi i përvojave, krijimi i bashkëpunimit dhe partneritetit ndërmjet bizneseve vendore dhe ndërkombëtare
7) Organizimi i takimeve me biznese nga diaspora	2024-2025	30,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Pjesërisht	Përfundon	Shkëmbimi i përvojave, informimi i tyre për mundësitë që ofron komuna jonë, tërheqja e investitorëve

4.2 Objektivi specifik: Përkrahja e ndërmarrësive me fokus në digjitalizim dhe inovacion	Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i financimit (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)	Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetëse	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati	Aftësimi për përdorimin e digjitalizimit dhe rëndësia e digjitalizimit në zhvillimin ekonomik
1) Mbështetja e trajnimeve për përparësitë e digjitalizimit të proceseve dhe dobisë ekonomike qarkore		2025	5,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Përfundon			

2) Ofrimi i granteve për ndërmarrje të reja inovative (ndërmarrjeve në pronësi të grave t'u jepet përparësi)	2025-2026	400,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Pjesërisht	Përfundon		Zvogëlimi i papunësisë të gratë, avancimi i gruas në tregun e punës
3) Ofrimi i shpërblimeve vjetore për ndërmarrjet lokale më inovative	2025-2026	10,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Pjesërisht	Përfundon		Mbështetje dhe kurajo për këto biznese që të vazhdojnë tujtje

4.3 Objektivi specific: Zhvillimi i Industrisë				Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetë se	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati	Aftësimi për përdorimin e digjitalizimit dhe rëndësia e digjitalizimit në zhvillimin ekonomik
	Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i financim- it ^(nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)								
Aktiviteti											
1) Rritja e aksesit të ndërmarrjeve industriale të shkallës së vogël në shërbimet financiare, për përthithje të një kredie ose linjë kredie të përbal- lueshme	2025- 2026	15,000,000€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Pjesërisht	Përfundon			

2) Mbështetja e zhvillimit të teknologjisë vendase dhe diversifikimit industrial nëpërmjet zhvillimit të teknologjisë vendase (p. sh. industria e drurit e etj.)	2025-2026	15,000.0 0€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Pjesërisht	Përfundon		
3) Konsulencë për kompanitë e orientuara në eksport	2025-2026	10,000.0 0€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Pjesërisht	Përfundon		Kompanitë informohen për rëndësinë e eksportit në zhvillimin e kapaciteteve të tyre biznesore

2) Krijimi i mundësisë që të rishikohen Planet Zhvillimore Komunale	2025-2026	15,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Pjesërisht	Përfundon
3) Ferizaj si qytet inteligjent (Smartcity)	2026	30,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Përfundon	

4.5 Objektivi Specifik: Forcimi i partneritetit për zhvillim ekonomik lokal				Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetë se	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
	Aktiviteti	Afati për zbatim	Kostoja totale							
1) Identifikimi i fushave të përbash- këta me potencial zhvillimor ne kuadër te bashkëpunimit ndërkomunal		2025- 2026	10,000.00€	Burimi i finansim- it ^(nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Pjesërisht	Përfundon	

2) Stimulimi i krijimit të shoqatave lokale për përfaqësim të sektorit privat dhe krijimi i mekanizmeve për bashkëpunim sistematik me shoqatat e krijuara	2025-2026	10,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Pjesërisht	Përfundon	
3) Fuqizimi i bashkëpunimit ndërkomunal ndërkombëtar	2025-2026	20,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Pjesërisht	Përfundon	

4.6 Objektivi Specifik: Zhvillimi bujqësor, rural dhe mjedisor				Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetë se	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
	Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i finansim- it ^(nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)							
1) Krijimi i infrastruk- turës rurale, zhvillimin e kërkimit bujqësor dhe shërbimet e ekstensionit, zhvillim- in e teknologjisë dhe bankat e gjeneve të bimëve dhe bleg- torisë me qëllim ritjen e kapacitetit prodhues bujqësor në komunën e Ferizaj	2024- 2025	300,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Pjesërisht	Pjesërisht	Përfundon	

2) Përkrahja me mekanizma bujqësorë	2024-2026	450,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Pjesërisht	Pjesërisht	Pjesërisht	Përfundon	Përmes paisjeve të dhuruara do të ndikojë që bujqëve t'u lehtësohet puna e tyre bujqësore në kohë më optimale dhe rezultati i tyre final do të jetë shumë efektiv
-------------------------------------	-----------	-------------	-------------------	--	--------------------------------------	--------------------------------------	------------	------------	------------	-----------	---

4.7 Objektivi specifik: Rritja e produktivitetit në bujqësi dhe promovimi i turizmit lokal				Gjendja bazë	Drejtorja udhë heqëse	Drejtorja mbështetë se	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
	Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i financimit-it ^(nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)							
1) Trajtime për fermerët për ngritje të aftësive për kultivim më efikas të prodhimeve bujqësore	2024-2025	60,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtorja e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Pjesërisht	Pjesërisht	Përfundon	Rritja e shkallës së profesionalizimit

2) Rritja e sipërfaqeve për kultivimin e kulturave bujqësore në ambiente të mbrojtura-serra	2024-2026	360,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Pjesërisht	Pjesërisht	Përfundon	Rritja e sasive të kulturave bujqësore
3) Përkrahja në ngritjen e kapaciteteve për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore	2025-2026	180,000.00€	Komuna e Ferizajt		Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë	Pjesërisht	Pjesërisht	Përfundon	

Objektivi i përgjithshëm 5: ZHVILLIMI I TURIZMIT DHE TRASHËGIMISË KULTURORE												
Objektivi specifik 5.1 Turizmi natyror	Treguesi (treguesit) për matjen e për mbushjes së objek- tivit		Afati për zbatim	Kostoja totale	Burimi i financim- it (nëse financohet nga Komuna duhet të harmonizohet me KASH, nëse financohet nga donatorë duhet të ceket)	Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetë se	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
1)Promovimi i kapaciteteve turistike të komunës së Ferizajt	2024- 2025	40,000. 00€	Komuna e Ferizajt			Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Pjesërisht	Përfundon			Tërheqja e vizitorëve dhe investitorëve

Objektivi specifik 5.1 Turizmi natyror	Treguesi (treguesit) për matjen e për mbushjes së objek- tivit		Gjendja bazë	Drejtoria udhë heqëse	Drejtoria mbështetë se	Caku 2024	Caku 2025	Caku 2026	Rezultati
	Afati për zbatim	Kostoja totale							
Aktiviteti									
1) Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	2025-2026	10,000. 00€	Komuna e Ferizajt	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit		Pjesërisht	Përfundon	
2) Krijimi i regjistrit elektronik të monumenteve kulturore, historike dhe arkeologjike	2024- 2025	10,000. 00€	Komuna e Ferizajt	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	Pjesërisht	Përfundon		Tërheqja e vizitorëve dhe investitorëve

8. Zbatimi, monitorimi, raportimi dhe vlerësimi

Hartimi i dokumentit strategjik dhe miratimi i tij nga institucionet lokale nuk paraqet fundin e procesit të planifikimit strategjik, por fillimin e zbatimit të tij, ose menaxhimit strategjik. Gjatë procesit të menaxhimit strategjik, shpesh ndryshojnë faktorët që përcaktojnë prioritetet dhe masat strategjike, ndaj ndodh që ato një herë të miratohen e pastaj të rishikohen. Për këto arsye, procesi i zbatimit të strategjisë duhet të monitorohet dhe rishikohet vazhdimisht. Monitorimi i zbatimit të strategjisë është një proces që ofron mundësinë e kontrollit, nëse aktivitetet e ndërmarra në proces zbatimi janë brenda afateve të përcaktuara, si dhe reagimin në kohë ndaj vonesave të mundshme gjatë zbatimit të aktiviteteve të planifikuara për shkak të vështirësive, problemeve, mungesës së burimeve apo problemeve të tjera. Ky proces përfshin krahasimin e informacionit të mbledhur gjatë zbatimit me tregues të paracaktuar. Zbatimi i suksesshëm i strategjive, përveç procesit të monitorimit, nënkupton edhe një proces vlerësimi, i cili është i rëndësishëm në matjen e rëndësisë, ndikimit dhe efekteve të aktiviteteve të ndërmarra. Kjo Strategji nuk do të ketë shumë mundësi për sukses nëse të gjithë (shërbimi administrativ i Komunës së Ferizajt, këshilltarët e Kuvendit Komunal, kompanitë publike, qytetarët dhe të gjithë ata që jetojnë në komunën tonë) nuk e pranojnë domosdoshmërinë e ndryshimeve që kanë një karakter transformues. Ndryshimet transformuese të mëdha dhe radikale kërkojnë kohë. Nëse krijohet një ekip drejtues me mbështetjen e nevojshme, mund të presim rezultate serioze që nga fillimi i zbatimit të Strategjisë.

Për zbatimin e Strategjisë përgjegjës janë:

- Kryetari i komunës;
- Përgjegjësit e Drejtorive të Komunës për pjesët përkatëse të Planit Strategjik në fushën e tyre të punës;
- Trupi koordinues për zbatimin e Strategjisë Zhvillimore, i cili do të përbëhet nga ekspertët kompetentë për fusha të veçanta të zhvillimit.

Me qëllim të promovimit të Strategjisë Zhvillimore, Kryetari i Komunës së Ferizajt dhe Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm do të nxjerrin udhëzime dhe procedura me të cilat do të prezantohen para publikut, të cilat do të kontribuojnë në zbatimin e Planit Strategjik. Në këtë kontekst, është e nevojshme të formohen ekipe ekspertësh për fusha të veçanta, të përfshihen të gjitha subjektet e jetës shoqërore, organizatat joqeveritare dhe shoqatat e tjera të qytetarëve. Zbatimi i çdo lloji ndryshimi transformues nënkupton veprimin e një numri të madh akterësh. Për të monitoruar dhe kontrolluar zbatimin e Strategjisë, do të zbatohen format e mëposhtme të kontrollit:

- Kontrolli permanent,
- Kontrolli i ndryshimeve nga administrata vendore dhe në subjektet e tjera pjesëmarrëse në zbatim.

Gjatë zhvillimit të mekanizmave të kontrollit duhet të përcaktohen format dhe llojet e tyre të qarta, si dhe nivelet e përgjegjësisë për zbatimin e Strategjisë. Është e nevojshme të sigurohet mbledhja dhe përzgjedhja e njëkohshme e informacionit, përpunimi i tij, identifikimi dhe veçanërisht përzgjedhja e faktorëve kryesorë që janë dominues për zbatimin e suksesshëm ose për krahasimin e propozimeve për aktivitete korrigjuese.

Në procesin e zbatimit, duhet të përcaktohet qartë një afat i arsyeshëm, veçanërisht në fushën e investimeve, për të shmangur pasojat negative. Kontrolli do të bëhet nga zbatuesit, dhe kryetari i komunës do të vlerësojë zbatimin çdo gjashtë muaj dhe për këtë do t'i raportojë Kuvendit të Komunës një herë në vit. Niveli më i lartë i kontrollit pritet nga qytetarët në role të ndryshme brenda komunitetit lokal. Për këtë qëllim të paktën një herë në vit do të bëhet një anketë me qytetarët ku do të merren parasysh rezultatet gjatë rishikimit të aktiviteteve dhe qëllimeve të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik. Fusha më e ndjeshme e veprimit transformues do të zhvillohet në fushën e pranimi të kulturës së ndryshimit. Në fund të kësaj periudhe planifikimi, duhet të jetë e qartë nëse ne kemi adoptuar një kulturë ndryshimi.

Zbatimi do të kërkojë minimizimin e të gjitha llojeve të ndarjeve. Çdo qytetar në Ferizaj duhet ta pranojë këtë Plan Strategjik si të tijin dhe të forcojë identitetin dhe përkatësinë e tij ndaj komunitetit tonë përmes ndërveprimit të ndërsjellë. Për të mbështetur zbatimin e Strategjisë zhvillimore, është e nevojshme përgatitja e një plani për prezantimin mediatik të Planit Strategjik dhe rëndësinë e tij në zhvillimin

e përgjithshëm të komunës së Ferizajt. Në fazën e miratimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik, është e nevojshme që përmes mjeteve të informimit publik dhe formave të tjera të prezantimit të mundësohet pjesëmarrja e qytetarëve në ndryshimet, por edhe në konfirmimin e projekteve të planifikuara. Në fazën e zbatimit, publiku duhet të informohet vazhdimisht për mënyrën e zbatimit. Në të njëjtën kohë, plani strategjik i zhvillimit duhet të përkthehet në anglisht dhe të prezantohet në faqen e internetit të komunës, me qëllim që të gjitha palët e interesuara të marrin pjesë aktive në hartimin përfundimtar të dokumentit.

Qytetarët e Komunës së Ferizajt duhet të informohen për çdo program dhe projekt të realizuar nga Strategjia Zhvillimore, si dhe për vështirësitë e mundshme gjatë realizmit. Në mënyrë që Strategjia Zhvillimore të zbatohet sa më me sukses, duhet gjetur mënyra për të motivuar qytetarët në procesin e realizimit të këtij dokumenti, para së gjithash përmes programeve të popullarizimit që nënkuptojnë ndryshime të dukshme në krijimin e një mjedisi jetese cilësor, të sigurt dhe stimulues.

Për të përshpejtuar zbatimin e këtij plani dhe prezantimin e tij mediatik, është e nevojshme:

- Të raportohet mbi ngjarjet aktuale dhe të nënvizohen shembujt pozitiv,
- Të promovoj nevojën për mobilizimin e të gjithë qytetarëve në arritjen e vizionit, synimeve, planeve dhe projekteve të përcaktuara në këtë dokument.



